

20131844457

LIGJ PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

I. DISPOZITA THEMELORE

Neni 1

Lënda e Ligjit

Me këtë Ligji rregullohen të drejtat, obligimet dhe përgjegjësia e radiodifuzerëve, dhënësve të shërbimeve audiovizuele mediatike me kërkesë dhe operatorëve të rrjeteve elektronike komunikuese publike të cilat i emetojnë ose rriemetojnë serviset programore të radiodifuzerëve.

Neni 2

Qëllimet e Ligjit

Qëllimi i këtij ligji është në Republikën e Maqedonisë veçanërisht të sigurohet:

- zhvillimi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele,
- zhvillimi i produksionit të pavarur,
- nxitja, përparimi dhe mbrojtja e identitetit kulturor, gjuhës dhe traditës së bashkësive në Republikën e Maqedonisë, respektimi i dallimeve kulturore dhe religjioze, nxitja e kulturës së dialogut publik ndërmjet qytetarëve me qëllim që të përforcohet mirëkuptimi dhe toleranca e ndërsjellë për përparimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive të ndryshme,
- nxitja e krijimtarisë, zhvillimit arsimor dhe shkencor,
- mbrojtja e interesave të shfrytëzuesve posaçërisht të personave të mitur,
- zhvillimi i profesionalizmit mediatik,
- servis radiodifuziv publik transparent, i pavarur, efikas dhe llogaridhënës,
- trup rregullator transparent, i pavarur, efikas dhe llogaridhënës në sferën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele,
- zhvillimi tekniko-teknologjik i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele, konvergjencë me komunikimet elektronike dhe shërbimet e shoqërisë informatike,
- nxitja dhe zhvillimi i konkurrencës në shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele dhe rriemtimin e serviseve programore nëpërmjet rrjeteve elektronike komunikuese publike dhe
- zhvillimi i ekonomisë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 3

Definicione

Shprehje të caktuara sipas këtij ligji e kanë këtë kuptim:

1. Shërbimi mediatik audio ose audiovizuel është:

a) Shërbimi të cilin e siguron dhënësi i shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel dhe i cili përfshin çfarëdo forme të aktivitetet ekonomik qëllimi primar i të cilit është sigurimi i programeve audio ose audiovizuele që të informohet, argëtohet dhe/ose arsimohet publiku më i gjerë nëpërmjet rrjeteve elektronike komunikuese dhe

b) Komunikimi audio ose audiovizuel komercial.

Shërbime të cilat nuk paraqesin shërbime audio ose audiovizuele mediatike janë:

a) shërbime që para së gjithash, janë joekonomike dhe që nuk janë në konkurrencë me emetim të radios apo të televizionit, siç janë faqet e internetit private dhe shërbimet që përbëhen nga sigurimi apo shpërndarja e përmbajtjes audiovizuele e krijuar nga shfrytëzues privat për ndarjen dhe këmbimin në kuadër të bashkësive me interes,

b) shërbimi i transmetimit, përkatësisht shpërndarjes së programeve për të cilat përgjegjësinë redaktuese e kanë persona të tretë,

v) çfarëdo forme e komunikimit privat, siç është posta elektronike e dërguar te një numër i kufizuar i pranuesve,

g) shërbime qëllimi primar i të cilave nuk është sigurimi i programeve, përkatësisht ku çdo përmbajtje audiovizuale është vetëm e rastësishme për shërbimin dhe nuk është qëllimi i saj primar siç janë:

- faqe të internetit që përmbajnë elemente audiovizuale vetëm në mënyrë ndihmëse, siç janë elemente të animuara grafike, spote të shkurtra reklamuese ose informata të lidhura me ndonjë prodhim ose shërbim i cili nuk është audiovizuel,

- lojërat e fatit që përfshijnë depozitë me para, duke përfshirë edhe lotaritë, bastin dhe forma tjera të shërbimeve për bixhoz,

- lojëra onlajn,

- kërkues,

- versione elektronike të gazetave dhe magazinave dhe

- shërbime të pavarura të bazuara tekstuale;

2. Program audiovizuel është tërësia nga fotografitë lëvizëse me apo pa zë, që paraqet element të veçantë në kuadër të radhitjes kronologjike të programeve (skemë programore) ose nga katalogu me programe të përcaktuar nga dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë. Programe audiovizuale janë tërësi të projektuara me funksion argëtues, arsimor ose me funksion informativ. Shembull për programe audiovizuale janë filmat artistikë, ngjarjet sportive, serialet komike, emisionet dokumentare, programet për fëmijë, dramet televizive e të tjera;

3. Audio ose radio programi është përmbajtja muzikore dhe/ose gojore që paraqet element të veçantë në kuadër të radhitjes kronologjike të programeve (skemë programore). Audio programe janë tërësi të projektuara nga lloji argëtues, arsimor ose informativ;

4. Shërbim mediatik audiovizuel me kërkesë është shërbimi jolinear mediatik të cilin e siguron dhënësi i shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë dhe me të cilin sigurohet shikimi i programeve në momentin e zgjedhur nga shfrytëzuesi dhe me kërkesë të tij personale në bazë të katalogut të programeve të përcaktuara nga dhënësi i shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë;

5. Komunikime audio ose audiovizuale komerciale janë përmbajtje të zëshme ose fotografi me apo pa zë që janë bërë:

- për promovimin e drejtpërdrejtë ose indirekt të prodhimeve, shërbimeve ose imazhit të personave fizikë ose juridikë që kryejnë aktivitet ekonomik ose

- për popullarizimin e ndonjë ideje ose aktiviteti ose për arritjen e efektit tjetër.

Ata e shoqërojnë ose janë përfshirë në programin për kompensim me para ose për kompensim tjetër për qëllime vetëpromovuese të porositësit. Forma të komunikimeve audio ose audiovizuale komerciale mes tjerash janë reklamimi, teleshopingu, sponsorimi dhe plasimi i prodhimeve;

6. Dhënësi i shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel është personi fizik ose juridik i cili kryen veprimtari të sigurimit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel dhe ka përgjegjësi redaktuese për zgjedhjen e përmbajtjes audio ose audiovizuale dhe e përcakton mënyrën në të cilën ato janë organizuar. Dhënësi i shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel sipas këtij ligji është radiodifuzeri ose dhënësi i shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë.

Personi i cili kryen vetëm transmetimin, përkatësisht shpërndarjen e programeve audio dhe/ose audiovizuale për të cilat përgjegjësinë redaktuese e kanë persona të tretë, nuk konsiderohet si dhënësi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuel;

7. Shërbime plotësuese janë shërbimet audiovizuale mediatike të sigurimit të përmbajtjeve të cilat i dërgojnë përkatësisht i plotësojnë programet audiovizuale të cilat emetohen nëpërmjet rrjeteve elektronike komunikuese. Shembull për shërbime të tilla mes tjerash janë titllat, udhëzuesi programor elektronik (EPG) dhe ngjashëm;

8. Emetim është dorëzimi burimor i programeve në formë analoge ose digjitale, të dedikuara për pranim nga publiku që shtrihen përmes emetuesit terestrial, rrjetit elektronik komunikues publik ose satelitet;

9. Vepra evropiane audiovizuele

1) vepra evropiane audiovizuele sipas këtij ligji janë:

- veprat që rrjedhin nga shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian,

- vepra që rrjedhin nga shtete të treta evropiane të cilat janë nënshkruese të Konventës evropiane për televizion tejkufitar të Këshillit të Evropës dhe të cilët i plotësojnë kushtet nga pika 3) të këtij neni dhe

- vepra të prodhuara në koproduksion në kuadër të marrëveshjeve të cilat kanë të bëjnë me sektorin audiovizuel të lidhura ndërmjet Bashkimit Evropian dhe shteteve të treta dhe të cilat i plotësojnë kushtet e definuara në secilën prej atyre marrëveshjeve;

2) dispozitat nga pika 1 alinetë 2 dhe 3 të këtij neni, do të zbatohen kushtimisht për veprat të cilat vijnë nga shtetet-anëtare të Bashkimit Evropian, e nuk janë lëndë të masave diskriminuese në shtete të treta.

3) veprat nga pika 1 alinetë 1 dhe 2 të këtij neni, janë ato të cilat janë prodhuar kryesisht nga autorë dhe punëtorë me vendbanim në një apo më shumë shtete nga pika 1 alinetë 1 dhe 2 nëse i plotësojnë njërin nga kushtet në vijim:

- të prodhohen prej një ose më shumë producentëve të themeluar në një apo më shumë prej këtyre shteteve,

- prodhimi i veprave është mbikëqyrur dhe faktikisht është kontrolluar prej një apo më shumë producentëve të themeluar në një apo më shumë prej këtyre shteteve ose

- pjesëmarrja e koproducentëve nga ato shtete të mbisundojë në lidhje me shpenzimet e përgjithshme për koproduksion, ndërsa koproduksionin të mos e kontrollojë një apo më shumë producentë të themeluar jashtë nga këto shtete dhe

4) vepra që nuk janë evropiane, sipas pikës 1 të këtij neni, por janë prodhuar në kuadër të marrëveshjeve bilaterale të koproduksionit të nënshkruara ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe shteteve të treta, do të konsiderohen vepra evropiane me kusht që koproducentët nga Bashkimi Evropian të kenë pjesëmarrje shumicë në shpenzimet e përgjithshme të produksionit dhe produksioni të mos kontrollohet prej një apo më shumë producentëve të themeluar jashtë territorit të shteteve - anëtare të Bashkimit Evropian.

10. Vepra maqedonase audio ose audiovizuele janë veprat e prodhuara burimore nga shtetas të Republikës së Maqedonisë në gjuhën maqedonase si dhe vepra audio ose audiovizuele, janë veprat e prodhuara burimore nga shtetas të Republikës së Maqedonisë në gjuhët e bashkësive etnike që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, si dhe veprat e trashëgimisë kulturore në Republikën e Maqedonisë;

11. Producent i pavarur është personi fizik ose juridik i cili ofron produksion të veprave audio ose audiovizuele, me kusht që:

- të mos ketë pjesëmarrje në kapitalin e radiodifuzerit më shumë se 25% dhe

- radiodifuzeri të mos ketë pjesëmarrje në kapitalin e producentit;

12. Servisi programor ose kanali programor është tërësi e programeve dhe elementeve tjera të një shërbimi të vetëm mediatik audio ose audiovizuel që e siguron radiodifuzeri konkret dhe që është dedikuar për pranim nga publiku;

13. Program me prodhim personal është programi i radios ose i televizionit të krijuar me iniciativë dhe në organizimin e vetë radiodifuzerit. Si program me prodhim personal konsiderohet edhe programi që krijohet me porosi të radiodifuzerit (produksion i porositur), si dhe programi i prodhuar në koproduksion. Në programin me prodhim personal nuk konsiderohet reklamimi, teleshpingu dhe shpalljet tjera të paguara;

14. Komunikime të fshehta audio ose audiovizuele komerciale është prezantimi me fjalë, zë ose fotografi të mallrave, shërbimeve, emrit, shenjës mbrojtëse ose aktivitete të prodhuesit të

mallrave ose dhënësit të shërbimeve në programe, kur prezantimi i tillë, nga dhënësi i shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel është dedikuar të shërbejë si reklamë dhe mund ta sjellë publikun në huti në lidhje me natyrën e tij. Prezantimi i tillë konsiderohet se është kryer me qëllim posaçërisht nëse është bërë për kompensim me para ose kompensim të ngjashëm;

15. Plasim i prodhimit është çdo formë e komunikimit audio ose audiovizuel komercial që përbëhet nga përfshirja ose sugjerimi i prodhimit, shërbimit ose shenjës mbrojtëse në ndonjë program, kështu që ato janë inkorporuara në veprimin e tij, për kompensim me para ose lloj tjetër të kompensimit;

16. Radioemetim është shërbimi linear audio mediatik të cilin e siguron radiodifuzeri me qëllim që të mundësojë dëgjim të njëkohshëm të audio programeve në bazë të radhitjes së përcaktuar paraprakisht kronologjike të programeve (skemë programe);

17. Radiodifuzer është dhënësi i shërbimeve audio ose audiovizuele mediatike për radioemetim ose emetim televiziv;

18. Riemetim i serviseve programore është shërbimi elektronik komunikues publik të cilin e siguron operatori i rrjetit elektronik komunikues publik dhe paraqet pranimin dhe bartjen e njëkohshme të programeve të radios ose televizive në tërësi dhe pa kurrfarë modifikimi në përmbajtjen e tyre programore, që radiodifuzerët i emetojnë për pranim nga publiku;

19. Reklamim është çdo formë e shpalljes, të emetuar, përkatësisht të publikuar për kompensim me para ose lloj tjetër të kompensimit ose për qëllime vetëpromovuese të personit fizik ose juridik në lidhje me:

- tregti, biznes, zeje ose profesion me qëllim që të promovohet oferta e prodhimeve dhe shërbimeve, duke përfshirë pronë të patundshme, të drejta dhe obligime në këmbim për pagesë ose

- popullarizimin e ndonjë ideje ose aktiviteti ose për arritjen e efektit tjetër;

20. Sponsorim është secili kontribut nga personi juridik ose fizik i cili nuk është përfshirë në sigurimin e shërbimeve audio dhe audiovizuele mediatike ose në produksionin e veprave audio ose audiovizuele, për shkak të financimit të shërbimeve audio ose audiovizuele mediatike ose të programeve, me qëllim që ta promovojë emrin e vet, shenjën mbrojtëse, imazhin, aktivitetet ose prodhimet;

21. Emetim televiziv është shërbimi linear mediatik audiovizuel të cilin e siguron radiodifuzeri me qëllim që të mundësojë shikim të njëkohshëm të programeve audiovizuele në bazë të radhitjes së përcaktuar paraprakisht kronologjike të programeve (skemë programe). Emetimi televiziv posaçërisht përfshin emetimin televiziv digjital, transmetimin e drejtpërdrejtë (live streaming), emetimin nëpërmjet ueb (webcasting) ose sigurimin e shërbimit mediatik të përafërt me video sipas kërkesës;

22. Servis programor televiziv ose i radios nga formati i përgjithshëm është servisi programor me programe kryesisht nga lloji informativ, arsimor, kulturor dhe argëtues;

23. Servis programor televiziv ose i radios nga formati i specializuar është servisi programor me së paku 70% programe nga lloji i njëjtë (sportive, muzikore, kulturore, arsimore, informative ose tjetër);

24. Teleshopingu është emetimi i ofertave të drejtpërdrejta te publiku i prodhimeve ose shërbimeve, duke përfshirë pronë të patundshme si dhe të drejta dhe obligime në shkëmbim për pagesë. Ofertë e drejtpërdrejtë është secila ofertë e cila përveç informatave për furnizuesin, karakteristikat dhe/ose çmimin e prodhimit ose shërbimit, përmban edhe ndonjë nga elementet në vijim: adresën postare ose elektronike, ueb faqen dhe/ose numrin e telefonit nëpërmjet të cilave qysh gjatë emetimit mund të realizohet blerja. Forma të teleshopingut janë spotet teleshoping dhe dritaret teleshoping;

25. Dritare teleshoping është emetimi i pandërprerë i teleshopingut me kohëzgjatje prej së paku 15 minutash;

26. Përgjegjësia redaktuese në shërbimin mediatik audio ose audiovizuel do të thotë kontroll vendimmarrës mbi zgjedhjen e programeve dhe mbi organizimin e tyre në radhitje kronologjike të programeve (skemë programore), në rast të emetimit televiziv ose të radios (shërbime lineare), ose në katalogun e programeve, në rast të shërbimeve audiovizuele mediatike me kërkesë (shërbime jolineare) dhe

27. Anëtarët e familjes janë bashkëshorti dhe shoku jashtëmartesorë, prindërit, fëmijët, vëllezërit dhe motrat, adoptuesit dhe fëmijët e adoptuar si dhe personat që jetojnë në ekonomi familjare të përbashkët.

II. ORGANI KOMPETENT

Neni 4

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

(1) Organ kompetent për punët që janë lëndë e këtij ligji është Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia).

(2) Agjencia është trup i pavarur dhe i mëvetësishëm rregullator jofitimprurës me status të personit juridik me autorizime publike.

(3) Republika e Maqedonisë është themelues i Agjencisë. Prona dhe mjetet për punën e Agjencisë i shfrytëzon dhe me ato menaxhon Agjencia.

(4) Selia e Agjencisë është në Shkup.

(5) Agjencia ka vulë.

(6) Vula i Agjencisë ka formë të rrumbullakët. Në mesin e vulës është stema e Republikës së Maqedonisë, ndërsa rreth tij është mbishkrimi: “Republika e Maqedonisë-Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele”.

(7) Puna e Agjencisë financohet nga mjetet e realizuara nga të hyrat nga kompensimet e parapara me këtë ligj, nga mjetet nga taksa e arkëtuar radiodifuzive në pajtim me këtë ligj, si dhe nga hua dhe ndihmë tjetër financiare dhe teknike.

Neni 5

Parime në punën e Agjencisë

(1) Agjencia në punën e vet kujdeset për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.

(2) Agjencia në punën e vet është e pavarur nga organ tjetër shtetëror ose person tjetër dhe duhet të jetë e paanshme ndaj tyre.

(3) Agjencia i kryen punët në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij, Ligjin për media, Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ligje dhe dokumente tjera strategjike të Republikës së Maqedonisë si dhe me marrëveshjen ndërkombëtare nga sfera e medieve dhe shërbimeve audiovizuele mediatike që i ka lidhur ose të cilat i ka pranuar Republika e Maqedonisë.

Neni 6

Kompetencat e Agjencisë

(1) Agjencia në pajtim me këtë ligj:

- kujdeset për sigurimin e publicitetit në punën e radiodifuzerëve,
- kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele, e inkurajon dhe mbështet ekzistimin e shërbimeve të llojllojshme, të pavarura dhe të mëvetësishme mediatike audio dhe audiovizuele,

- ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është bërë shkelja e dispozitave të këtij ligji ose të rregullave të miratuara në bazë të tij dhe kushtet dhe obligimet nga lejet,
 - kujdeset për sigurimin e mbrojtjes së personave të mitur, i miraton aktet të cilat dalin nga ky ligj,
 - kujdeset për mbrojtjen e interesave të qytetarëve në sferën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele,
 - përcakton ekzistimin e koncentrimit të palejuar mediatik;
 - vendos për ndarjen, heqjen ose vazhdimin e lejeve për emetim televiziv ose në radio,
 - ndërmerr masa për kufizimin e përkohshëm të transmetimit dhe pranimit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele nga shtete tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me nenin 45 të këtij ligji,
 - miraton listë të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë,
 - nxit profesionalizmin mediatik,
 - kryen mbikëqyrje në pajtim me nenet 28, 29 dhe 30 të këtij ligji,
 - i mban regjistrat e përcaktuar me këtë ligj,
 - zbaton hulumtime dhe analiza lidhur me çështje të caktuara nga sfera e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele
 - kryen matje të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë së programeve, përkatësisht serviseve programore të radiodifuzerëve nga Republika e Maqedonisë dhe
 - kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj.
- (2) Mënyrën e matjes së shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë së programeve, përkatësisht serviseve programore të radiodifuzerëve nga Republika e Maqedonisë e përcakton Agjencia.

Neni 7

Rregullore për punën e Agjencisë

- (1) Puna e Agjencisë më afërsisht rregullohet me Rregullore për punën e Agjencisë.
- (2) Rregullorja për punën e Agjencisë posaçërisht përmban dispozita për:
 - shenjën mbrojtëse dhe përpunimin dhe përdorimin e vulave të Agjencisë,
 - mënyrën dhe procedurën për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit të Agjencisë,
 - procedurën për emërimin dhe shkarkimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit të Agjencisë,
 - procedurën për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të Agjencisë,
 - procedurën për miratimin e akteve nënligjore dhe akteve tjera të cilat dalin nga ky ligj,
 - mënyrën dhe procedurën për ndarjen, heqjen ose vazhdimin e lejes për emetim televiziv ose në radio,
 - mënyrën dhe procedurën e mbajtjes së regjistrave të përcaktuar me këtë ligj dhe
 - dispozita tjera me rëndësi për punën e Agjencisë.
- (3) Rregullorja për punën e Agjencisë është publikisht e arritshme dhe e njëjta publikohet në ueb faqen e Agjencisë në afat prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të saj.

Neni 8

Raportimi për punën e Agjencisë

- (1) Agjencia për punën e vet jep raport para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë me dorëzimin e Raportit për punën e vet.
- (2) Raportin nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia publikisht e shpall në ueb faqen e vet dhe të njëjtin e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në shqyrtim më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës.
- (3) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, përmban:

a) raport vjetor për punën e Agjencisë për vitin paraprak dhe

b) program vjetor për punë të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

(4) Raporti vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak nga paragrafi (3) pika a) e këtij neni posaçërisht përmban:

- raport për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në Programin vjetor për punë të Agjencisë, për vitin paraprak, në të cilin duhet të paraqitet realizimi i Planit vjetor për mbikëqyrje programore,

- raport financiar për realizimin e Planit financiar për vitin paraprak dhe Llogari vjetore, me të dhëna për të ardhurat e realizuara, shpenzimet, kërkesat dhe detyrimet për vitin paraprak të grupuara sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të Agjencisë dhe

- raport të revizorit nga revizori ndërkombëtar i autorizuar i pavarur dhe raport të revizorit nga Enti Shtetëror për Revizion, nëse është bërë revizion nga ai, si dhe qëndrim të Agjencisë në lidhje me rezultatet nga revizioni i kryer.

(5) Me programin vjetor për punë të Agjencisë për vitin e ardhshëm nga paragrafi (3) pika b) e këtij neni janë përcaktuar detyrat dhe qëllimet të cilat Agjencia duhet t'i përmbush vitin e ardhshëm, në pajtim me këtë ligji dhe ai posaçërisht duhet të përmbajë:

- program të aktiviteteve të planifikuara dhe

- plan financiar për vitin e ardhshëm, që përmban të dhëna për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, të ardhurat e planifikuara dhe shpenzimet e Agjencisë për vitin e ardhshëm të grupuara sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të Agjencisë, si dhe investimet e parapara kapitale të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

(6) Mjetet e përcaktuara nga plani financiar i Agjencisë nga viti paraprak barten në planin financiar të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

Neni 9

Transparenca në punën e Agjencisë

(1) Agjencia detyrohet të zbatojë hulumtime publike dhe analiza në aspekt të zhvillimit dhe gjendjeve në treg të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele.

(2) Agjencia detyrohet së paku një herë në tre muaj gjatë vitit të organizojë takime publike me qëllim që t'u mundësoj të gjithë palëve të interesuara, t'i shprehin qëndrimet dhe mendimet e tyre në lidhje me zhvillimin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele në Republikën e Maqedonisë e posaçërisht për:

- gjendjet në tregun për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në Republikën e Maqedonisë dhe

- realizimin e aktiviteteve dhe plotësimin e qëllimeve nga Programi vjetor për punën e Agjencisë.

(3) Qëndrimet dhe mendimet e marra nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe qëndrimi i Agjencisë në lidhje me to, në afat prej shtatë ditëve nga dita e mbajtjes së takimit publik shpallen në ueb faqen e Agjencisë.

(4) Agjencia me akt nënligjor më afërsisht i rregullon:

- procedurën dhe mënyrën e pranimit të propozimeve nga palët e interesuara,

- mënyrën dhe vendin e shpalljes së konkurseve, kandidatët e paraqitur dhe informata tjera të lidhura me procedurën për ndarjen e lejeve dhe

- të dhëna dhe informatat që Agjencia do t'i shpallë, si dhe mënyrën e qasjes në të njëjtat, në pajtim me ligjin.

Neni 10
Ndikimi i publikut

(1) Agjencia para se ta miratojë ose ndryshojë aktin nënligjor në kompetencë të vet, si dhe para se ta miratojë Programin vjetor për punë për vitin e ardhëm, në ueb faqen e vet publikisht do ta shpall aktin e propozuar nënligjor, përkatësisht Programin vjetor për punë për vitin e ardhshëm, me qëllim që të sigurojë debat publik, përkatësisht t'u mundësoj të gjithë palëve të interesuara t'i shprehin mendimet e veta, pikëpamjet dhe qëndrimet në lidhje me aktin e propozuar nënligjor ose Programin e propozuar vjetor për punë për vitin e ardhshëm.

(2) Afati i kohëzgjatjes së debatit publik nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk guxon të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e shpalljes së akteve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Pas skadimit të afatit nga paragrafi (2) i këtij neni, e para miratimit të aktit nënligjor, Agjencia ka për obligim publikisht t'i shpallë në ueb faqen e vet mendimet dhe komentet e marra, si dhe qëndrimin e Agjencisë në lidhje me to.

Neni 11
Organet e Agjencisë

Organet e Agjencisë janë Këshilli dhe drejtori.

Neni 12
Këshilli

(1) Këshilli përbëhet prej shtatë anëtarëve.

(2) Anëtarët e Këshillit duhet ta paraqesin llojllojshmërinë e shoqërisë maqedonase me përfaqësim të drejtë të të dyja gjinive.

(3) Anëtarët e Këshillit nëse miratojnë vendim në kompetencë të tyre me të cilën do t'i cenojnë interesat e Agjencisë, përgjigjen në mënyrë të pakufizuar dhe solidare për dëmin e krijuar me vendimin e tillë. Nuk do të konsiderohet i përgjegjshëm ai anëtar i Këshillit i cili ka sugjeruar se vendimi i propozuar është në kundërshtim me këtë ligj dhe e ka kundërshtuar miratimin e vendimit, në mënyrë që e ka veçuar mendimin e vet në procesverbalin e mbledhjes dhe ka votuar "kundër" vendimit.

(4) Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë për:

- kompensim mujor në lartësi deri në 4 rroga mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave të shpallura nga Enti Shtetëror i Statistikës, në pajtim me Rregulloren për punë të Agjencisë,

- kompensim për shpenzime të rrugës të atyre anëtarëve të Këshillit të cilët jetojnë jashtë Shkupit kur janë të pranishëm në mbledhjet e Këshillit dhe

- kompensim për shpenzime të rrugës, vendosje dhe mëditje për udhëtim zyrtar në pajtim me Ligjin për rroga dhe kompensime tjera për persona të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë.

(5) Mjetet për kompensimin mujor dhe shpenzimet tjera të anëtarëve të Këshillit sigurohen nga mjetet e Agjencisë të përcaktuara me planin financiar.

(6) Puna e Këshillit më afërsisht rregullohet me Rregulloren për punë të Agjencisë në pajtim me këtë ligj.

(7) Këshilli punon me kuorum prej së paku pesë anëtarëve, ndërsa vendimet dhe aktet tjera i miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

(8) Këshilli nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin, në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren për punë të Agjencisë.

Neni 13
Mbledhjet e Këshillit

(1) Mbledhjet e Këshillit i konvokon kryetari i Këshillit me iniciativë të vet, e në rast të mungesës së tij ose pengesës me iniciativë të zëvendëskryetarit të Këshillit. Kryetari i Këshillit është i detyruar që të konvokojë mbledhje të Këshillit me propozim me shkrim të tre anëtarëve të Këshillit, ose me propozim me shkrim të drejtorit të Agjencisë, më së voni në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të propozimit.

(2) Kryetari i Këshillit kryeson me mbledhjet e Këshillit, dhe e përfaqëson Këshillin, e në rast të mungesës së tij ose pengesës obligimet i realizon zëvendëskryetari i Këshillit.

(3) Vendimet dhe aktet tjera të Këshillit i nënshkruan kryetari i Këshillit, ose në rast të pengesës së tij, zëvendëskryetari i Këshillit, më së voni në afat prej tri ditëve nga dita e miratimit të tyre.

(4) Në mbledhjet e Këshillit është i pranishëm edhe drejtori i Agjencisë, pa të drejtë vote, ndërsa mund të jenë të pranishëm edhe persona tjerë të punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë, si dhe persona tjerë të jashtëm në pajtim me Rregulloren për punë të Këshillit.

(5) Nëse anëtari i Këshillit konsideron se ka interes privat direkt ose indirekt në lidhje me miratimin e vendimeve në kompetencë të Këshillit, anëtari i Këshillit është i detyruar për këtë ta njoftojë Këshillin. Në këtë rast Këshilli vepron në pajtim me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave.

(6) Agjencia në ueb faqen e vet i publikon: rendin e ditës nga mbledhjet e Këshillit më së voni një ditë para ditës së mbajtjes së tyre, ndërsa procesverbalet e miratuara nga mbledhjet e Këshillit me prononcimin dhe votimin e anëtarëve të Këshillit, kronikat nga mbledhjet, si dhe vendimet e miratuara dhe aktet tjera, në afat prej shtatë ditëve nga dita e mbajtjes së mbledhjes.

(7) Materialet për mbledhjet e Këshillit i përgatitë shërbimi profesional i Agjencisë dhe të njëjtat dorëzohen te të gjithë anëtarët e Këshillit në mënyrën dhe afatin e përcaktuar në Rregulloren për punë të Agjencisë.

(8) Këshilli detyrohet të mbajë së paku një mbledhje në muaj.

Neni 14
Emërimi i anëtarëve të Këshillit

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i emëron anëtarët e Këshillit me propozim të propozuesve të autorizuar.

(2) Propozues të autorizuar të anëtarëve të Këshillit janë:

- Shoqata shumicë e gazetarëve propozon një anëtar të Këshillit,
- Konferenca interuniversitare propozon një anëtar të Këshillit,
- Dhoma e Avokatëve e Republikës së Maqedonisë propozon një anëtar të Këshillit,
- Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë propozon një anëtar të Këshillit,
- Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë propozon dy anëtarë të Këshillit dhe
- Bashkësia e Njërive të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë propozon dy anëtarë të Këshillit.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë u dërgon thirrje publike propozuesve të autorizuar për dorëzim të propozimit të kandidatit për anëtarë të Këshillit, më së voni gjashtë muaj para skadimit të mandatit të anëtarit të Këshillit.

(4) Propozuesit e autorizuar nga paragrafi (2) alinetë 1, 2, 3 dhe 4 e përcaktojnë propozimin pas konkursit të publikuar paraprakisht.

(5) Propozuesit e autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni, propozimet e përcaktuara për anëtarë të Këshillit i dorëzon te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej dy muajve nga

dita e dërgimit të thirrjes publike nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe në afatin e njëjtë janë të obliguar publikisht t'i shpallin në së paku dy gazeta ditore prej të cilave njëra gazetë ditore është në gjuhën e bashkësisë e cila nuk është shumicë, e që e flasin së paku 20% nga qytetarët në Republikës së Maqedonisë. Në bazë të propozimeve të dorëzuara nga propozuesit e autorizuar Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, në afat prej 15 ditësh përpilon propozim të kandidatëve për anëtarë të Këshillit.

(6) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni një muaj para kalimit të mandatit të anëtarit të Këshillit, duhet të emërojë anëtar të ri të Këshillit.

(7) Kryetari i Këshillit është i obliguar që ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për kalimin e mandatit të anëtarit të Këshillit jo më vonë se gjashtë muaj para kalimit të të njëjtit.

(8) Kandidati i propozuar për anëtar të Këshillit i prezanton pikëpamjet e tij për plotësimin e qëllimeve të këtij ligji para trupit punues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, kompetent për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

(9) Gjatë përcaktimit të propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë mban llogari për përfaqësimin adekuat dhe të drejtë të qytetarëve të të gjitha bashkësive që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

(10) Gjatë përcaktimit të propozimeve, propozuesit e autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni, duhet ta kenë parasysh dispozitën nga neni 12 paragrafi (2) i këtij ligji dhe duhet të mbajnë llogari për kushtet për emërimin në pajtim me nenin 16 paragrafi (2) të këtij ligji.

(11) Ministria kompetente e Shoqërisë informatike dhe Administratës e përcakton shoqatën shumicë të gazetarëve nga paragrafi (2) alineja 1 të këtij neni, me ç'rast duke marrë parasysh numrin e anëtarëve të shoqatave të gazetarëve në bazë të fletëpranimeve të vërtetuara me pagesë të anëtarësisë për çdo anëtar të shoqatës përkatëse. Regjistrin e anëtarëve të evidentuar dhe vërtetimet për pagesën e anëtarësisë për vitin rrjedhës shoqatat e gazetarëve e dorëzojnë te Ministria kompetente e Shoqërisë informatike dhe Administratës. Ministria kompetente e Shoqërisë informatike dhe Administratës, veçanërisht do të ketë kujdes për rastet e anëtarësimi të dyfishtë, me ç'rast si anëtar valid i shoqatës së caktuar të gazetarëve do të konsiderohet ai me pagesë të anëtarësisë nga data më e re.

Neni 15

Mandati i anëtarëve të Këshillit

(1) Anëtarët e Këshillit emërohen në kohëzgjatje prej shtatë vitesh.

(2) Anëtarët e Këshillit nuk kanë të drejtë të riemërimit.

(3) Në rast kur anëtari i Këshillit do të paraqesë dorëheqje ose mandati i ndërpritet para kalimit të kohës për të cilin është emëruar, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do të emërojë anëtar të ri të Këshillit për pjesën e mbetur nga mandati me propozim të propozuesit të autorizuar nga neni 14 i këtij ligji.

(4) Këshilli mund të punojë nëse janë emëruar së paku pesë anëtarë të Këshillit.

Neni 16

Kushtet për emërim

(1) Anëtarë të Këshillit mund të jenë persona shtetas të Republikës së Maqedonisë me arsim të lartë, së paku pesë vite përvojë pune në profesion dhe të cilët në publik janë shquar në sferën e komunikologjisë, gazetarisë, komunikimeve elektronike, informatikës, kulturës, ekonomisë, drejtësisë ose sferë tjetër të ngjashme që është me rëndësi për realizimin e kompetencave të Këshillit.

(2) Anëtar i Këshillit nuk mund të emërohet:

- deputeti, anëtari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, personi i cili është emëruar nga Kuvendi ose Qeveria e Republikës së Maqedonisë, personi i cili udhëheq me njësi të vetëqeverisjes lokale, drejtori ose anëtari i këshillit drejtues ose mbikëqyrës i ndërmarrjes publike,

- persona të cilët i kryejnë detyrat në organet e partisë politike ose të bashkësisë fetare,

- personi i cili është pronar i pjesëmarrjeve ose aksioneve, anëtari i organit të menaxhimit ose personi i cili në mënyrë direkte ose indirekte ka interes në personin juridik i cili merret me shërbime mediatike audio ose audiovizuele ose në shoqëri e cila kryen veprimtari të ngjashme (reklamim, komunikime elektrike, prodhim dhe shitje të mallit teknik audio dhe audiovizuel dhe ngjashëm) e që kanë të bëjnë me shërbime mediatike audio/audiovizuele dhe operatorë dhe/ose dhënës të rrjeteve publike elektronike komunikuese dhe shërbimeve,

- personi anëtarët e familjes e të cilit kanë pjesëmarrje ose aksione ose janë anëtarë të organeve të menaxhimit në radifuzerë ose

- personi i cili me vendim të plotfuqishëm është dënuar me dënim me burg më gjatë se gjashtë muaj ose nëse i është shqiptuar masa ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, më gjatë se gjashtë muaj derisa dënimi, përkatësisht masa të mos shlyhet nga regjistri përkatës në pajtim me ligjin.

(3) Anëtarë të Këshillit mund të emërohen persona të punësuar në persona tjerë juridikë, përveç në persona tjerë juridikë të cilët mund të jenë në konflikt interesash në pajtim me këtë ligj.

(4) Anëtarët e Këshillit nuk guxojnë nga radiodifuzerët, dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë edhe nga operatorët e rrjeteve publike elektronike komunikuese të cilët emetojnë, përkatësisht rriemetojnë përmbajtje programore, të pranojnë dhurata, të pranojnë shërbime, as të hynë në marrëdhënie të cilat do të çonin në konflikt të interesave.

Neni 17

Ndërprerja e mandatit të anëtarit të Këshillit

(1) Anëtarit të Këshillit i ndërpritet mandati sipas fuqisë së ligji para kalimit të kohës për të cilën është emëruar në rastet në vijim:

- me kërkesë të tij,

- me pranim të funksioneve ose punës që janë inkompatibile me funksionin anëtar i Këshillit në pajtim me këtë ligj,

- nëse në mënyrë të plotfuqishme është dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje më gjatë se gjashtë muaj ose i është shqiptuar masë e sigurisë ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj,

- nëse nuk ka mundësi ta kryejë detyrën më shumë se gjashtë muaj në vazhdimësi,

- është krijuar ndonjë nga pengesat për anëtarësim në Këshill të parapara në nenin 16 të këtij ligji,

- mungon pa arsye prej tri mbledhjeve të njëpasnjëshme të Këshillit ose prej pesë mbledhjeve gjatë një viti në pajtim me Rregulloren për punë të Agjencisë ose

- nëse konstatohet se anëtari i Këshillit në procedurë për emërim të tij ka dhënë të dhëna të pavërteta ose ka lëshuar të paraqesë disa informata të cilat janë të rëndësishme për emërimin e tij.

(2) Për plotësimin e kushteve për ndërprerje të mandatit të anëtarit të Këshillit para kalimit të kohës për të cilën është emëruar, të parapara në paragrafin (1) të këtij neni kryetari, përkatësisht zëvendëskryetari i Këshillit detyrohet ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat prej pesë ditësh pune nga dita e plotësimit të kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni. Në këtë rast zbatohet procedura e përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji.

Neni 18

Kompetencat e Këshillit

Këshilli i ka kompetencat në vijim:

- miraton vendim për shpalljes e konkursit publik për ndarjen e lejeve për emetim televiziv ose në radio,
- miraton vendim për ndarje, heqje ose vazhdim të lejes për emetim televiziv ose në radio,
- miraton vendim me të cilin lejohet, përkatësisht ndalohet ndryshimi në strukturën pronësore të radiodifuzerit,
- miraton vendim me të cilin anulohet vendimi me të cilën është lejuar ndryshimi në strukturën pronësore të radiodifuzerit,
- miraton vendim për ngritjen e procedurës për përcaktim të ekzistimit të koncentrimit të palejuar mediatik, me detyrë zyrtare,
- miraton vendim me të cilin konstatohet ekzistimi i koncentrimit të palejuar mediatik,
- e informon organin kompetent për të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta kur dyshon se është kryer cenim i tyre,
- i miraton aktet nënligjore të cilat dalin nga ky ligj,
- i miraton aktet e përgjithshme për punë të Agjencisë,
- e miraton Rregulloren për punë të Agjencisë,
- e miraton llogarinë përfundimtare të Agjencisë,
- e miraton raportin vjetor për punë për vitin paraprak dhe Programin vjetor për punë për vitin e ardhshëm të Agjencisë të cilët janë pjesë përbërëse e Raportit për punë të Agjencisë nga neni 8 i këtij ligji,
- e miraton planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore dhe Metodologjinë për kryerjen e mbikëqyrjes programore,
- vendos për ndërmarrje të masave për kufizim të përkohshëm të transmetimit dhe pranimit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nga shtete tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë,
- miraton vendim për përcaktimin e listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun në Republikën e Maqedonisë,
- e miraton Kodeksin për sjellje të anëtarëve të Këshillit dhe të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë,
- i zgjedh dhe shkarkon drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e Agjencisë në pajtim me këtë ligj dhe me procedurë të përcaktuar në Rregulloren për Punë të Agjencisë,
- i jep leje për marrjen e vendimeve drejtorit të Agjencisë për disponim me pronën, si dhe për punësim dhe lëshim nga puna të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë,
- e ndjek zbatimin e programit vjetor për punë të Agjencisë përmes raporteve tremujore të dorëzuara nga drejtori i Agjencisë dhe
- kryen edhe punë tjera përcaktuara me këtë ligj.

Neni 19

Drejtori i Agjencisë

(1) Këshilli e zgjedh drejtorin e Agjencisë nëpërmjet konkursit publik. Kandidati duhet të jetë me arsim të lartë dhe me përvojë pune mbi pesë vjet në fushën e komunikologjisë, gazetarisë, komunikimeve elektronike, informatikës, kulturës, ekonomisë ose drejtësisë.

(2) Këshilli detyrohet që ta zgjedhë drejtorin e Agjencisë jo më vonë se 30 ditë para skadimit të mandatit të paraardhësit të tij.

(3) Drejtori, bashkëshorti i tij ose shoku jashtëmartesor, si dhe farefisi i afërm i tij në vijë të drejtë deri në brezin e dytë, nuk mund të kenë pjesë në aksione, drejtpërdrejtë apo tërthorazi në organizata që kryejnë aktivitete që drejtpërdrejt janë në kompetencë të Agjencisë.

(4) Drejtori është i angazhuar profesionalisht në Agjenci me orar të plotë të punës.

(5) Këshilli e zgjedh edhe zëvendës drejtorin e Agjencisë nëpërmjet konkursit publik me mandat të njëjtë si mandati i drejtorit të Agjencisë.

(6) Zëvendës drejtori i Agjencisë e zëvendëson drejtorin e Agjencisë në rastin kur mungon apo për shkak të sëmundjes apo shkaqe tjera nuk ka mundësi ta kryejë funksionin e tij, në tërë kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në udhëheqje.

(7) Zëvendës drejtori i Agjencisë në bashkëpunim me drejtorin e Agjencisë kryen punë të kompetencës së drejtorit të Agjencisë që ai do t'ia ngarkojë.

(8) Dispozitat e paragrafëve (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, vlejnë edhe për zëvendës drejtorin e Agjencisë.

Neni 20

Kompetenca e drejtorit

(1) Drejtori e organizon dhe udhëheq me punën e Agjencisë, është përgjegjës për punën e ligjshme të Agjencisë dhe i ka kompetencat në vijim:

- e përfaqëson dhe prezanton Agjencinë,
- nënshkruan marrëveshje në emër të Agjencisë,
- i propozon aktet e përgjithshme për punë të Agjencisë,
- e propozon Rregulloren për punë të Agjencisë, raportin vjetor për punë dhe programin vjetor për punën e Agjencisë të cilat janë pjesë përbërëse e raportit për punën e Agjencisë nga neni 8 i këtij ligji,
- e propozon planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore dhe Metodologjinë për kryerjen e mbikëqyrjes programore,
- miraton aktvendime për çështje në kompetencë të Agjencisë,
- lëshon vërtetime për regjistrim të përcaktuara me këtë ligj,
- ndërmer masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të këtij ligji ose të rregullave të miratuara në bazë të tij ose kushtet dhe obligimet nga lejet,
- propozon masa për kufizim të përkohshëm për transmetim dhe pranim të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale nga shtete tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë,
- i propozon vendimet në kompetencë të Këshillit,
- i propozon aktet nënligjore që janë në kompetencë të Këshillit,
- propozon listë të ngjarjeve me rëndësi të madhe për publikun në Republikën e Maqedonisë,
- u jep autorizime personave tjerë në suaza të kompetencave të veta,
- vendos për punësime dhe sistemim të të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë dhe

- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe Rregulloren për punë të Agjencisë.

(2) Drejtori detyrohet që Këshillit t'i dorëzojë raporte tremujore për realizimin e Programit vjetor për punën e Agjencisë, si dhe raporte tremujore për masat e ndërmarra në pajtim me këtë ligj në rastet kur është bërë shkelja e dispozitave të këtij ligji ose e rregullave të miratuara në bazë të tij dhe kushtet dhe obligimet nga leja.

(3) Mandati i drejtorit është shtatë vjet.

(4) Nëse mandati i drejtorit ka përfunduar, e procedura për zgjedhje të drejtorit nuk ka përfunduar, drejtori vazhdon ta kryejë funksionin derisa nuk bëhet zgjedhja e drejtorit, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Neni 21

Shkarkimi i drejtorit

- (1) Drejtori mund të shkarkohet nga Këshilli vetëm në rastet në vijim:
- a) me kërkesë të tij;
 - b) në rast të pengesës për kryerjen e funksionit për shkak të sëmundjes më gjatë se gjashtë muaj;
 - v) pranim të funksionit ose punës që janë inkompatibile me funksionin e tij si drejtor;
 - g) nëse është i dënuar për vepër penale për të cilën i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj ose i është shqiptuar masë sigurie ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj;
 - d) shkelje e dispozitave të këtij ligji ose e rregullave të miratuara në bazë të tij që mund të përcaktohet nga Raporti për punën e Agjencisë ose
 - gj) keqpërdorim të funksionit sipas raportit të revizorit nga neni 8 i këtij ligji.
- (2) Drejtori kundër të cilit rrjedh procedura për shkarkim, i mundësohet mbrojtje para Këshillit.
- (3) Vendimi për shkarkimin e drejtorit përveç tjerash duhet t'i përmbajë shkaqet për shkarkimin e tij të arsyetuara në mënyrë të detajuar dhe i njëjti publikohet në ueb faqen e Agjencisë në afat prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të tij.
- (4) Nëse drejtori është shkarkuar, e procedura për zgjedhjen e drejtorit nuk ka përfunduar, funksionin e drejtorit do ta kryejë zëvendësdrejtori i Agjencisë për periudhë jo më të gjatë se tre muaj.

Neni 22

Organizimi dhe punësimi në Agjenci

- (1) Punët profesionale, normative-juridike, administrative, administrative-mbikëqyrëse, materiale-financiare, të kontabilitetit, informatike dhe punët tjera të Agjencisë i kryen shërbimi profesional organizimi i brendshëm i të cilit, fushëveprimi i punës dhe kushtet për punësim më afërsisht rregullohen me aktet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.
- (2) Dispozitat nga Ligji për nëpunës shtetërorë nuk zbatohen te të punësuarit në Agjenci.
- (3) Në përbërje të shërbimit profesional të Agjencisë, detyrimisht ekziston njësi organizative për kryerjen e mbikëqyrjes programore (monitorim) të programeve që emetohen nga radiodifuzerët, dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë dhe pako programore të operatorëve të rrjeteve publike komunikuese elektronike që rriemetojnë servise programore nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia, lejet dhe vërtetimet e lëshuara për regjistrim, në pajtim me Planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore dhe Metodologjinë për kryerjen e mbikëqyrjes programore që e përcakton Agjencia me akt nënligjor.
- (4) Shërbimi profesional i kryen punët në kompetencë të vet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke i respektuar procedurat e përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij.
- (5) I punësuarit në shërbimin profesional është i detyruar që të refuzojë urdhëresë që të veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, rregullat e miratuara në bazë të tij, si dhe aktet tjera të Agjencisë madje edhe kur urdhëresa e këtyllë vjen nga eprori dhe për këtë ta njoftojë drejtorin, kryetarin dhe anëtarët tjerë të Këshillit.
- (6) Sjellja e të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë gjatë kryerjes së kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, rregullat e miratuara në bazë të tij dhe aktet tjera të

Agjencisë më afërsisht rregullohen me Kodeks për sjelljen e të punësuarve në shërbimin profesional që e miraton Agjencia dhe e publikon në ueb faqen e vet.

Neni 23

Masat në rast të shkeljes së rregullave

(1) Nëse konstatohet mosrespektim i dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të tij, si dhe e kushteve dhe obligimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet tjera të Agjencisë, kundër botuesit të mediumit, dhënësit të shërbimeve audiovizuele me kërkesë ose operatorit të rrjeteve komunikuese elektronike publike të cilat kryejnë riemetim të servisit programor, drejtori i Agjencisë mund t'i ndërmarrë masat në vijim:

- do të miratojë aktvendim me të cilin do t'i bëjë vërejtje,
- do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në rast kur edhe krahas aktvendimit të miratuar për vërejtje vazhdon me kryerjen e shkeljes së njëjtë për të cilën i është bërë vërejtje, gjatë vitit,
- do të dorëzojë propozim te Këshilli për heqjen e lejes ose
- do të miratojë aktvendim për shlyerje nga regjistri në pajtim me këtë ligj.

(2) Masat e ndërmarra nga paragrafi (1) i këtij neni, me arsyetim të detajuar, Agjencia i publikon në ueb faqen e vet në afat prej tri ditësh nga masa e ndërmarrë.

Neni 24

E drejta e mbrojtjes gjyqësore

(1) Vendimet dhe aktvendimet e miratuara në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, lejeve, vërtetimeve të lëshuara për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve tjera të Agjencisë janë përfundimtare.

(2) Kundër vendimeve dhe aktvendimeve nga paragrafi (1) i këtij neni mund të parashtrahet padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

(3) Padia për ngritjen e kontestit administrativ parashtrahet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit ose aktvendimit.

Neni 25

Bashkëpunimi

(1) Agjencia për punën e vet duhet t'i ketë parasysh direktivat e Bashkimit Evropian, aktet e Këshillit të Evropës, konventat ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë, si dhe përvojën e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

(2) Agjencia detyrohet të bashkëpunojë, japë mendime, propozime dhe të këmbëjë të dhëna me ministrinë kompetente për punët nga sfera e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele, Agjencinë për Komunikime Elektronike, Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, trupin kompetent për mbrojtjen e të drejtave autoriale dhe të drejtave të përafërta dhe trupat tjerë shtetërorë, organet e administratës shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, entet publike dhe institucionet nga Republika e Maqedonisë. Gjatë këmbimit të të dhënave, Agjencia detyrohet që ta sigurojë besueshmërinë e të njëjtave, në pajtim me ligj.

(3) Agjencia detyrohet të bashkëpunojë dhe të këmbëjë informata me Inspektoratin Shtetëror të Tregut, trupin kompetent për mbrojtjen e të drejtave autoriale dhe të drejtave të përafërta dhe organet tjera kompetente dhe trupat me qëllim që të sigurohet mbrojtje juridike e shërbimeve të cilat bazohen në ose përfshijnë qasje të kushtëzuar, si dhe në parandalimin e mundësisë për

përdorim të veglave të palejuara të cilat mundësojnë qasje të shërbimet me qasje të kushtëzuar në pajtim me ligj.

(4) Agjencia në pajtim me kompetencat e saj, e në drejtim të zbatimit të dispozitave të këtij ligji, bashkëpunon me trupat rregullatorë nga shtete tjera dhe institucione dhe trupa ndërkombëtarë.

Neni 26

Inkluzioni social dhe profesionalizmi mediatik

(1) Agjencia ndërmerr aktivitete që t'i nxitë dhënësit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale, që shërbimet e tyre gradualisht t'i bëjnë të arritshme për personat me dëgjim apo të parit të dëmtuar.

(2) Agjencia ndërmerr aktivitete për nxitjen e profesionalizmit mediatik në Republikës së Maqedonisë.

(3) Gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni Agjencia bashkëpunon me organizata joqeveritare, shoqata civile, institucione arsimore dhe palë tjera të interesuara dhe të njëjtat i publikon në ueb faqen e vet.

(4) Aktivitetet e ndërmarra nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, janë pjesë e Raportit vjetor për punë për vitin paraprak të Agjencisë.

III. MBIKËQYRJA

Neni 27

Llojet e mbikëqyrjes

(1) Agjencia kryen mbikëqyrje programore, administrative dhe profesionale.

(2) Mbikëqyrja programore dhe administrative mund të jetë:

- mbikëqyrje e rregullt,
- mbikëqyrje e jashtëzakonshme dhe
- mbikëqyrje kontrolluese.

(3) Mbikëqyrja e rregullt kryhet në bazë të Programit vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore, përkatësisht administrative, e kur bëhet fjalë për mbikëqyrje programore edhe në pajtim me Metodologjinë për kryerjen e mbikëqyrjes programore të miratuara nga Agjencia.

(4) Mbikëqyrja e jashtëzakonshme kryhet në bazë të iniciativës së parashtruar nga organe shtetërore, persona juridikë ose fizikë, si dhe në rast të dyshimit me detyrë zyrtare të Agjencisë.

(5) Mbikëqyrja kontrolluese kryhet pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin e veçantë të miratuar nga Agjencia me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrjes:

- ka vepruar sipas aktit në tërësi,
- ka vepruar pjesërisht sipas aktit ose
- nuk ka vepruar sipas aktit.

Neni 28

Mbikëqyrja e programit

(1) Mbikëqyrja programore (monitorimi) kryhet mbi programet e radiodifuzerëve, dhe dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe mbi pakot programore të cilat i riemetojnë operatorët në rrjetet komunikuese elektronike publike në aspekt të respektimit të dispozitave të këtij ligji, vërtetimeve të lëshuara për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve tjera të miratuara nga Agjencia.

(2) Mbikëqyrjen programore nga paragrafi (1) i këtij neni e kryejnë të punësuarit nga njësia organizative, e cila për atë qëllim është formuar në shërbimin profesional të Agjencisë. Për çdo mbikëqyrje të kryer programore përpilohet raport me shkrim i cili dorëzohet te drejtori i Agjencisë në afat prej tri ditësh nga dita e mbikëqyrjes së kryer programore.

(3) Nëse me mbikëqyrjen programore është konstatuar shkelje ose cenim, raporti me shkrim përmban edhe propozim-masë në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Neni 29

Mbikëqyrja administrative

(1) Mbikëqyrja administrative kryhet mbi punën e emetuesve të medieve në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara me Ligjin për media, këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij. Mbikëqyrja administrative e punës së botuesit të mediumit të shtypur dhe të publikimeve elektronike ekskluzivisht ka të bëjë vetëm në aspekt të harmonizimit të punës së tyre me obligimet e përcaktuara në nenet 6, 7, 8, 10, 14 dhe 15 të Ligjit për media.

(2) Mbikëqyrjen administrative nga paragrafi (1) i këtij neni, e kryejnë të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë në pajtim me aktin për sistematizim të punëve dhe detyrave në shërbimin profesional të Agjencisë.

(3) Për çdo mbikëqyrje të kryer administrative përpilohet raport me shkrim i cili dorëzohet te drejtori i Agjencisë në afat prej tri ditësh nga dita e mbikëqyrjes së kryer administrative.

(4) Nëse me mbikëqyrjen administrative është konstatuar shkelje ose cenim, raporti me shkrim përmban edhe propozim-masë në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër.

Neni 30

Kompetenca për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale

(1) Mbikëqyrja profesionale kryhet mbi radiodifuzerë nga persona të punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë të autorizuar për atë nga drejtori i Agjencisë (në tekstin e mëtutjeshëm: personi i autorizuar), vetëm për përcaktimin e përmbushjes së kushteve teknikave, hapësinore dhe kadrovike në pajtim me kërkesën për marrjen e lejes për emetim televiziv ose në radio.

(2) Mbikëqyrja profesionale nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhet vetëm në afat prej 30 ditësh nga skadimi i ditës së tridhjetë nga dita e fillimit me kryerjen e veprimtarisë së përcaktuar në lejen për emetim televiziv dhe në radio, si dhe gjatë ndryshimit të lokacionit të lokaleve në të cilat prodhohet programi (studio) ose gjatë zgjerimit me lokale të reja të studios.

Neni 31

Personi i autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale

(1) Si person i autorizuar mund të emërohet i punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë i cili ka arsim të lartë, me së paku tri vjet përvojë pune në profesion.

(2) Agjencia personit të autorizuar i lëshon legjitimacion zyrtar që i shërben për dëshmim të cilësisë së tij zyrtare dhe të cilin është i detyruar ta tregojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(3) Forma dhe përmbajtja e legjitimacionit zyrtar nga paragrafi (2) i këtij neni, dhe mënyra e lëshimit dhe heqjes përcaktohet me akt nënligjor.

Neni 32

Procedura për mbikëqyrje profesionale

(1) Agjencia është e detyruar që ta njoftojë me shkrim radiodifuzerin për fillimin e mbikëqyrjes profesionale e cila nuk mund të kryhet në afat më të shkurtër se shtatë ditë nga dita

e dorëzimit të njoftimit me shkrim. Në njoftimin me shkrim Agjencia është e detyruar të japë arsyetim për shkaqet për kryerje të mbikëqyrjes profesionale.

(2) Për mbikëqyrjen e kryer profesionale personi i autorizuar përpilon procesverbal të cilin ia jep radiodifuzerit për nënshkrim, e në rast se radiodifuzeri refuzon ta nënshkruajë procesverbalin, personi i autorizuar në procesverbal do t'i shënojë shkaqet për refuzimin.

(3) Kur për shkak të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes profesionale, natyrës së saj dhe rrethanave nuk është e mundur të përpilohet procesverbal gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale, procesverbali përpilohet në lokalet zyrtare të Agjencisë në afat prej tri ditësh nga dita e mbikëqyrjes së kryer profesionale me arsyetim për shkaqet për atë.

(4) Procesverbali duhet të përmbajë pasqyrë të gjendjes së konstatuar faktike gjatë mbikëqyrjes si dhe vërejtjet e konstatuara, deklarata dhe fakte tjera relevante dhe rrethana.

(5) Formularin për formën dhe elementet e detyrueshme nga procesverbali për mbikëqyrjen e kryer e përcakton me akt Agjencia.

(6) Personi i autorizuar është i detyruar që menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale procesverbalin nga paragrafi (2) i këtij neni, ta dorëzojë te drejtori i Agjencisë.

(7) Nëse me procesverbalin është konstatuar shkelje ose cenim, personi i autorizuar është i detyruar që me të të dorëzojë edhe propozim-masë në pajtim me këtë ligj.

Neni 33

Të drejtat dhe detyrimet e radiodifuzerit si subjekt i mbikëqyrjes profesionale

(1) Radiodifuzeri është i detyruar që personit të autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale t'i mundësojë kryerje të papenguar të mbikëqyrjes profesionale.

(2) Për kryerjen e papenguar të mbikëqyrjes profesionale përgjigjet subjekti i mbikëqyrjes profesionale dhe personi përgjegjës në radiodifuzerin.

(3) Radiodifuzeri është i detyruar që personit të autorizuar për mbikëqyrje profesionale t'i mundësojë:

- në afatin e caktuar hyrje në lokal in ku gjenden mjetet dhe sendet për sigurim të shërbimeve mediatike dhe

- t'ia japë për inspektim dhe me kërkesë të personit të autorizuar t'i japë informata, të dhëna dhe dokumente ose cilatdo mjete tjera të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale.

(4) Radiodifuzeri është i detyruar që me kërkesë me shkrim të personit të autorizuar, në afatin e përcaktuar me kërkesën, e i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë, personit të autorizuar t'i dorëzojë ose përgatitë të dhëna të sakta dhe të plota, raporte, materiale ose dokumente tjera të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale.

(5) Nëse personit të autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes profesionale nuk i mundësohet hyrje në lokal in banesore, personi i autorizuar mund atë ta bëjë me urdhëresë të lëshuar nga gjykata kompetente.

(6) Radiodifuzeri ka të drejtë që të japë deklarata në procesverbal dhe vërejtje lidhur me mbikëqyrjen profesionale me arsyetim për shkaqet për to.

IV. MBROJTJA E PLURALIZMIT DHE LLOJLLOJSHMËRISË SË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Neni 34

Ndalimi për bashkëpronar të fshehtë

Radiodifuzeri nuk mund të ketë bashkëpronar të fshehtë, përkatësisht bashkëpronari i fshehtë nuk mund të marrë pjesë me investim monetar ose jomonetar në radiodifuzer.

Neni 35

Pjesëmarrja e personit të huaj fizik ose juridik

(1) Personi i huaj fizik ose juridik mund të themelojë ose të marrë pjesë në pronësinë e radiodifuzerit të vendit në kushte të njëjta të përcaktuara me këtë ligj që vlejnë për personat e vendit fizikë ose juridikë.

(2) Personi i vendit juridik themelues të të cilit janë edhe persona të huaj të regjistruar në vende në të cilat në pajtim me rregullat e atyre vendeve nuk është e lejuar ose nuk është e mundshme të përcaktohet origjina e kapitalit themelues, nuk mund të kryejë veprimtari radiodifuzive, në pajtim me këtë ligj, e as të fitojë pjesëmarrje në pronësi të radiodifuzerit.

(3) Nëse në mënyrë plotësuese konstatohet se një nga themeluesit e radiodifuzerit është person juridik nga paragrafi (2) i këtij neni, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat nga neni 43 i këtij Ligji.

Neni 36

Persona të lidhur

(1) Persona të lidhur, sipas këtij ligji, janë personat që janë reciprokisht të lidhur përmes menaxhimit, kapitalit ose në mënyrë tjetër dhe kur ato për shkak të lidhshmërisë së tillë bashkërisht mund ta krijojnë politikën afariste, përkatësisht të veprojnë në mënyrë të koordinuar për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, ose kur një person ka mundësi të orientojë ose në masë të konsiderueshme të ndikojë mbi person tjetër gjatë vendosjes për financimin, punën afariste ose gjatë vendosjes për konceptin programor të radiodifuzerit.

(2) Si persona të lidhur nga paragrafi (1) i këtij neni veçanërisht konsiderohen:

- anëtarët e familjes,
- anëtarët e familjes së bashkëshortit ose shokut jashtëmartesor,
- personat që si posedues të pjesëmarrjes së përgjithshme në pronësinë, të aksioneve ose të drejtave tjera në personin tjetër, marrin pjesë në menaxhimin e atij personi me së paku 25% të të drejtave votuese,
- personat të cilët një person i njëjtë ka pjesëmarrje të përgjithshme, aksione ose të drejta tjera, në bazë të të cilave merr pjesë në menaxhimin në çdonjërin prej atyre personave me së paku 25% të të drejtave votuese,
- shoqëritë e lidhura sipas Ligjit për shoqëri tregtare,
- personat të cilët me marketing ose marrëveshje tjetër, në periudhë tremujore ose më të gjatë në një vit realizojnë më shumë se 30% të të hyrave nga reklamimi, teleshoppingu dhe sponsorimi dhe
- personat që janë anëtarë të këshillit drejtues ose mbikëqyrës të radiodifuzerit dhe personat që konsiderohen si të lidhur me anëtarët e këshillit drejtues ose mbikëqyrës në mënyrë të përcaktuar me këtë nen.

Neni 37

Kufizime për marrjen e pronësisë

(1) Personi fizik ose juridik i cili është bashkëpronar shumicë ose aksionar shumicë në radiodifuzerin i cili ka leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel shtetëror, si dhe personi i lidhur me bashkëpronar ose aksionar në radiodifuzer i cili ka leje për sigurim të emetimit televiziv në nivel shtetëror mund të jetë bashkëpronar ose aksionar, përkatësisht të marrë pjesë vetëm edhe në një radiodifuzer i cili ka leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel shtetëror, por jo më shumë se 50% të kryegjësë themelore të atij radiodifuzerit ose 50% të së drejtës së vendosjes.

(2) Personi fizik ose juridik i cili është bashkëpronarë shumicë ose aksionar shumicë në radiodifuzer i cili ka leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel shtetëror, si dhe personi i lidhur me bashkëpronar ose aksionar në radiodifuzer i cili ka leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel shtetëror mund të jetë bashkëpronar shumicë ose aksionar shumicë më së shumti edhe në një radiodifuzer i cili ka leje për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive për emetim televiziv në nivel rajonal me ç'rast zonat në nivel rajonal janë jofqinjësore më së shumti edhe në dy radiodifuzerë që kanë leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel lokal, me ç'rast zonat në nivel lokal janë jofqinjësore.

(3) Personi fizik ose juridik i cili është bashkëpronar shumicë ose aksionar shumicë në radiodifuzer i cili ka leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel rajonal, si dhe personi i lidhur me bashkëpronar ose aksionar në radiodifuzer i cili ka leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel rajonal mund të jetë bashkëpronar shumicë ose aksionar shumicë më së shumti edhe në dy radiodifuzerë që kanë leje për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive për emetim televiziv në nivel rajonal me ç'rast zonat në nivel rajonal janë jofqinjësore më së shumti edhe në dy radiodifuzerë që kanë leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel lokal, me ç'rast zonat në nivel lokal janë jofqinjësore.

(4) Personi fizik ose juridik i cili është bashkëpronar shumicë ose aksionar shumicë në radiodifuzer i cili ka leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel lokal si dhe personi i lidhur me bashkëpronar ose aksionar në radiodifuzer i cili ka leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel lokal mund të jetë bashkëpronar shumicë ose aksionar shumicë më së shumti edhe në dy radiodifuzerë që kanë leje për sigurimin e emetimit televiziv në nivel lokal, me ç'rast zonat në nivel lokal janë jofqinjësore.

(5) Personi fizik ose juridik i cili është bashkëpronar shumicë ose aksionar shumicë në radiodifuzer, si dhe personi i lidhur me partner ose aksionar në radiodifuzer nuk mund të themelojë, as të jetë bashkëpronar ose aksionar, përkatësisht të marrë pjesë në pronësi të emetuesit të medias së shtypit i cili boton gazetë ditore, agjencisë së lajmeve, shoqërisë për reklamë dhe propagandë, shoqërisë për hulumtim të tregut dhe mendimit publik, shoqërisë për distribuimin e veprave audiovizuale, shoqërisë për produksion filmik ose operatorit të rrjeteve komunikuese elektronike i cili siguron riemetim ose emetim të programeve radiotelevizive.

(6) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni në mënyrë përkatëse zbatohen edhe te personi fizik ose juridik i cili është bashkëpronar shumicë ose aksionar shumicë në radiodifuzer i cili ka leje për sigurim të emetimit në radio.

Neni 38

Ndalim i veçantë për marrjen e pronësisë

Partitë politike, organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, bartësit e funksioneve publike dhe anëtarët e familjes së tyre nuk mund të kryejnë veprimtari radiodifuzive as të jenë themelues, bashkëthemelues ose të fitojnë pjesëmarrje në pronësinë e radiodifuzerëve.

Neni 39

Koncentrimi i palejuar mediatik

(1) Koncentrim i palejuar mediatik, sipas këtij ligji ekziston kur personat fizikë ose juridikë që janë themelues të radiodifuzerëve, si dhe personat fizikë bartës të funksioneve të menaxhimit në radiodifuzerë paraqiten njëkohësisht si:

- persona të lidhur në kuptim të dispozitave të këtij ligji,
- themelues të radiodifuzerëve tjerë në kundërshtim me dispozitat nga neni 37 paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij ligji,

- themelues të emetuesit të medias së shtypit i cili boton gazetë ditore që shpërndahet në zonën në të cilën emitohet programi televiziv dhe/ose i radios,

- themelues të agjencisë së lajmeve dhe

- themelues të shoqërisë për reklamë dhe propagandë, shoqërisë për hulumtim të tregut dhe mendimit publik, shoqërisë për shpërndarjen e veprave audiovizuale, shoqërisë për produksion filmik ose operatorit të rrjeteve komunikuese elektronike që siguron riemetim ose emetim të programeve radiotelevizive.

(2) Koncentrimi i palejuar mediatik, sipas këtij ligji, ekziston kur radiodifuzeri:

- merr pjesë në kapitalin themelues të radiodifuzerit tjetër në kundërshtim me dispozitat nga neni 37 i këtij ligji,

- merr pjesë në kapitalin themelues të emetuesit të medias së shtypit i cili boton gazetë ditore ose të agjencisë së lajmeve,

- merr pjesë në kapitalin themelues të shoqërisë për reklamë dhe propagandë,

- merr pjesë në kapitalin themelues të shoqërisë për hulumtim të tregut dhe mendimit publik,

- merr pjesë në kapitalin themelues të shoqërisë për distribuim të veprave audiovizuale ose në shoqëri për produksion filmik,

- merr pjesë në kapitalin themelues të operatorit të rrjeteve komunikuese elektronike që siguron riemetim ose emetim të programeve radiotelevizive, njëkohësisht emeton program televiziv dhe të radios përveç për subjektin që kryen servis radiodifuziv publik,

- emeton program televiziv ose të radios dhe boton gazetë ditore që distribuohet në zonën në të cilën emitohet programi televiziv ose i radios dhe

- emeton program televiziv ose të radios dhe merret me veprimtari të agjencisë së lajmeve, shoqërisë për reklamë dhe propagandë, shoqërisë për hulumtim të tregut dhe mendimit publik, shoqërisë për shpërndarjen e veprave audiovizuale, shoqërisë për produksion filmik ose me veprimtari të operatorit të rrjeteve komunikuese elektronike që siguron riemetim ose emetim të programeve televizive ose të radios.

Neni 40

Përcaktimi i koncentrimit të palejuar mediatik

(1) Ekzistimi i koncentrimit të palejuar mediatik në pajtim me këtë ligj dhe ekzistimi i cenimit të ndalimit nga nenet 34, 35 paragrafi (2) ose neni 38 të këtij ligji i përcakton Agjencia.

(2) Në procedurën për përcaktimin e ekzistimit të koncentrimit të palejuar mediatik dhe të ekzistimit të cenimit të ndalimit nga nenet 34, 35 paragrafi (2) ose neni 38 të këtij ligji, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Neni 41

Njoftimi paraprak gjatë ndryshimit të strukturës pronësore

(1) Para realizimit të çfarëdo ndryshimi të strukturës pronësore, radiodifuzeri është i detyruar ta njoftojë Agjencinë.

(2) Radiodifuzeri nuk guxon ta realizojë ndryshimin e strukturës pronësore para se i njëjti të miratohet nga Agjencia, përkatësisht para përfundimit të plotfuqishëm të kontestit administrativ nga paragrafi (9) i këtij neni.

(3) Agjencia është e detyruar që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, të analizojë nëse me ndryshimet e propozuara të strukturës pronësore do të krijohet koncentrim i palejuar mediatik sipas këtij ligji, përkatësisht të analizojë nëse ndryshimet e propozuara të strukturës pronësore janë në kundërshtim me ndalimin nga nenet 34,

35 paragrafi (2) ose neni 38 të këtij ligji. Me këtë rast, Agjencia është e detyruar të bashkëpunojë dhe këmbëjë informata me organe dhe trupa shtetërore, në pajtim me këtë ligj.

(4) Agjencia për shkaqe të arsyeshme mund ta vazhdojë afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, vetëm njëherë por jo më shumë se 30 ditë për çfarë me shkrim do ta informojë radiodifuzerin në afat jo më të vogël se tri ditë para skadimit të afatit nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Për analizë të njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, radiodifuzeri është i detyruar që me kërkesë me shkrim Agjencisë t'i dorëzojë të dhëna me rëndësi për vendimmarrjen.

(6) Nëse në afatet e përcaktuara në pajtim me paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, përcaktohet se me ndryshimet e propozuara të strukturës pronësore nuk do të krijohet koncentrim i palejuar mediatik sipas këtij ligji, përkatësisht se të ato nuk janë në kundërshtim me ndalimin nga nenet 34, 35 paragrafi (2) ose neni 38 të këtij ligji, Agjencia në afatet e përcaktuara në pajtim me paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni do të miratojë vendim me të cilin do ta lejojë realizimin e ndryshimit në strukturën pronësore.

(7) Nëse në afatet e përcaktuara në pajtim me paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, konstatohet se me ndryshimet e propozuara të strukturës pronësore do të krijohet koncentrim i palejuar mediatik sipas këtij ligji, përkatësisht se ato janë në kundërshtim me ndalimin nga nenet 34, 35 paragrafi (2) ose neni 38 të këtij ligji, Agjencia do të miratojë vendim në afatet e përcaktuara në pajtim me paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, me të cilin do ta ndalojë realizimin e ndryshimit në strukturën pronësore.

(8) Vendimi nga paragrafi (7) i këtij neni detyrimisht i përmban shkaqet për të cilat Agjencia e ndalon realizimin e ndryshimit në strukturën pronësore.

(9) Nëse Agjencia nuk miraton vendim në afatet e përcaktuara në pajtim me paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, konsiderohet se realizimi i ndryshimit në strukturën pronësore është miratuar.

(10) Afatet e përcaktuara në pajtim me paragrafin (3) dhe (4) të këtij neni fillojnë të rrjedhin nga dita kur radiodifuzeri në Agjenci, i ka dorëzuar të gjitha të dhënat e përcaktuara me aktin nga paragrafi (11) i këtij neni.

(11) Agjencia me akt të veçantë i përcakton formën dhe përmbajtjen e njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe dokumentacionin e nevojshëm i cili parashtrohet bashkë me njoftimin.

Neni 42

Anulimi i vendimit me të cilin lejohet realizimi i ndryshimit në strukturën pronësore

(1) Agjencia me vendim do ta anulojë vendimin me të cilin ka lejuar realizim të ndryshimit në strukturën pronësore, nëse ai vendim është miratuar në bazë të të dhënave të pasakta dhe/ose të paplota për të cilat është përgjegjës radiodifuzeri ose të njëjtat janë marrë nëpërmjet mashtrimit, e kanë pasur ndikim vendimmarrës mbi miratimin e vendimit.

(2) Me vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia:

- e anulon vendimin me të cilin ka lejuar realizim të ndryshimit në strukturën pronësore,
- konstaton se me ndryshimet e propozuara të strukturës pronësore do të krijohet koncentrim i palejuar mediatik, përkatësisht se të njëjtat janë në kundërshtim me ndalimin nga nenet 34, 35 paragrafi (2) ose neni 38 të këtij ligji dhe
- radiodifuzerit i urdhëron që në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë dhe më i gjatë se 90 ditë nga dita e pranimit të vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, ta harmonizojë strukturën e tij pronësore me dispozitat e këtij ligji.

(3) Agjencia mund të miratojë vendim në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, pa u kufizuar me këtë rast me afatet e përcaktuara në nenin 41 të këtij ligji.

(4) Nëse radiodifuzeri nuk vepron në pajtim me vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia do ta heqë lejen për emetim televiziv ose të radios në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 43

Ngritja e procedurës për përcaktimin e koncentrimit të palejuar mediatik me detyrë zyrtare

(1) Nëse Agjencia në bazë të njohurive personale ose në bazë të të dhënave të marra nga personat e interesuar ka njohuri për ekzistimin eventual të koncentrimit të palejuar mediatik, përkatësisht për ekzistimin e cenimit të ndalimit nga nenet 34, 35 paragrafi (2) ose nenit 38 të këtij ligji do t'i analizojë njohuritë e tilla me detyrë zyrtare pa prolongim.

(2) Gjatë analizimit të njohurive nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia do të kërkojë nga radiodifuzeri, në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë dhe as më i gjatë se 45 ditë që t'i dorëzojë të gjitha të dhënat me rëndësi për vendimmarrjen e Agjencisë.

(3) Nëse gjatë analizimit të njohurive nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia me vendim do të konstatojë ekzistim të koncentrimit të palejuar mediatik, përkatësisht cenim të ndalimit nga nenet 34, 35 paragrafi (2) ose nenit 38 të këtij ligji, dhe do t'i urdhërohet radiodifuzerit që në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë dhe as më i gjatë se 90 ditë ta harmonizojë strukturën e tij pronësore me dispozitat e këtij ligji.

(4) Nëse radiodifuzeri nuk vepron në pajtim me vendimin nga paragrafi (3) i këtij neni, Agjencia do ta heqë lejen për emetim televiziv ose të radios në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me këtë ligj.

V. SIGURIMI I EMETIMIT TELEVIZIV OSE TË RADIOS DHE SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZUELE ME KËRKESË

V.1. Dispozita të përgjithshme

Neni 44

Liria e pranimit dhe riemetimit

Garantohet liria e pranimit dhe riemetimi i shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetet tjera evropiane nënshkruese të Konventës evropiane për televizionin tejkufitar të Këshillit të Evropës në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 45

Kufizimi i pranimit dhe riemetimit të shërbimeve mediatike audio/audiovizuele nga shtetet tjera

(1) Me përjashtim të dispozitës nga neni 44 të këtij ligji, Agjencia mund të marrë masa përkatëse me të cilat përkohësisht do ta kufizojë lirinë e pranimit, përkatësisht të riemetimit të shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele nga shtetet tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë, nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(2) Masat nga paragrafi (1) i këtij neni në lidhje me servisin programor të radiodifuzerëve do të merren, nëse:

- serviset programore të radiodifuzerëve nga shtetet tjera në mënyrë evidente, seriozisht dhe rëndë i shkelin dispozitat e nenit 48 dhe nenit 50 të këtij ligji dhe nxisin urrejtje racore, gjinore, fetare ose nacionale dhe mosdurim,

- nëse gjatë 12 muajve paraprakë radiodifuzeri i ka shkelur dispozitat nga paragrafi (2) alineja 1 e këtij neni së paku dy herë,

- Këshilli me shkrim e ka njoftuar radiodifuzerin dhe Komisionin Evropian për shkeljen dhe për masat që planifikon t'i ndërmarrë nëse shkelja e tillë ndodh përsëri dhe

- konsultimet me shtetin nga i cili radiodifuzeri emeton dhe Komisioni Evropian nuk ka rezultuar me shkarkim kontraktues në afat prej 15 ditësh nga dita e njoftimit me shkrim, e shkelja vazhdon.

(3) Masat nga paragrafi (1) i këtij neni do të ndërmerren në lidhje me shërbimet mediatike audiovizuale me kërkesë nëse përmbushen kushtet në vijim:

- masa është e nevojshme veçanërisht për mbrojtjen, hulumtimin, zbulimin dhe përndjekjen e veprave penale, duke përfshirë edhe mbrojtjen e të miturve dhe luftën kundër nxitjes së urrejtjes në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit, si dhe për shkeljen e dinjitetit njerëzor të individëve, mbrojtjen e shëndetit publik, sigurinë publike, duke përfshirë edhe garantimin e sigurisë nacionale dhe mbrojtjes, si dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke i përfshirë edhe investitorët,

- masa ndërmerret kundër shërbimeve mediatike me kërkesë që i vënë në pikëpyetje qëllimet nga paragrafi (3) alineja 1 e këtij neni ose të cilat paraqesin rrezik serioz dhe të madh se ato qëllime do të vihen në pikëpyetje,

- masa është proporcionale me qëllimet nga paragrafi (3) alineja 1 e këtij neni,

- Agjencia para ndërmarrjes së masës, duke mos i vënë në pikëpyetje procedurat gjyqësore, duke përfshirë edhe procedurat paraprake dhe aktivitetet e ndërmarra në kuadër të hetimit kriminalistik, ka kërkuar nga shtetet anëtare në kompetencë të të cilave është dhënësi i shërbimeve mediatike të marrë masa të cilat ai shteti anëtar nuk i ka ndërmarrë ose ato nuk kanë qenë adekuate dhe

- Agjencia e ka njoftuar Komisionin Evropian dhe shtetin anëtar, si dhe shtetin kontraktues të Konventës evropiane për televizion tejkufitar në kompetencë të të cilit është dhënësi i shërbimeve mediatike për qëllimin e ndërmarrjes së masave.

(4) Në raste të caktuara urgjente Agjencia mund të shmanget nga kushtet e theksuara në paragrafin (3) alinetë 4 dhe 5 të këtij neni dhe në ato raste është e detyruar që në afat sa më të shkurtër ta njoftojë Komisionin Evropian dhe shtetin anëtar në kompetencë të të cilit është dhënësi i shërbimeve mediatike për masat e marra, ose shtetin nënshkrues të Konventës Evropiane për televizion tejkufitar të Këshillit të Evropës, duke i theksuar shkaqet për të cilat konsideron se bëhet fjalë për rast urgjent.

(5) Agjencia menjëherë do ta ndërpresë zbatimin e masave nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse Komisioni Evropian konstaton se ato nuk janë në pajtim me rregullat e Komisionit Evropian.

Neni 46

Juridiksioni

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen te të gjithë dhënësit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale që janë nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Nën juridiksion të Republikës së Maqedonisë janë ata dhënës të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale që janë themeluar në Republikën e Maqedonisë në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni ose ata për të cilat zbatohet paragrafi (4) i këtij neni.

(3) Dhënësi i shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale konsiderohet se është themeluar në Republikën e Maqedonisë, nëse:

- selia e dhënësit të shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale gjendet në Republikën e Maqedonisë dhe vendimet redaktuese në lidhje me shërbimet mediatike audio ose audiovizuale miratohen në Republikën e Maqedonisë,

- selia e dhënësit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale gjendet në Republikën e Maqedonisë, ndërsa vendimet redaktuese për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale miratohen në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian dhe një pjesë e konsiderueshme e fuqisë

punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me shërbimet mediatike audio ose audiovizuele është në Republikën e Maqedonisë,

- vendimet redaktuese për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele miratohen në Republikën e Maqedonisë, ndërsa selia e dhënësit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele gjendet në shtetin anëtar të Bashkimit Evropian, por një pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me shërbimet mediatike audio ose audiovizuele është në Republikën e Maqedonisë,

- selia e dhënësit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele gjendet në Republikën e Maqedonisë, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me shërbimet mediatike audio ose audiovizuele është edhe në Republikën e Maqedonisë edhe në shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian,

- pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me sigurimin e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele nuk është në asnjë prej shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, por dhënësi i shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele e ka filluar veprimtarinë e tij në Republikën e Maqedonisë dhe ka lidhje stabile dhe efektive me ekonominë e Republikës së Maqedonisë dhe

- selia e dhënësit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele gjendet në Republikën e Maqedonisë, ndërsa vendimet redaktuese miratohen në shtet i cili nuk është anëtar i Bashkimit Evropian, ose anasjelltas, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e fuqisë punëtore e angazhuar në aktivitetet lidhur me sigurimin e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele gjendet në Republikën e Maqedonisë.

(4) Nën juridiksion të Republikës së Maqedonisë janë edhe dhënësit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele për të cilët nuk janë të zbatueshme dispozitat nga paragrafi (3) të këtij neni në rastet në vijim:

- shfrytëzojnë lidhje satelitore të lokalizuar në Republikën e Maqedonisë dhe
- nuk shfrytëzojnë lidhje satelitore të lokalizuar në Republikën e Maqedonisë, por shfrytëzojnë kapacitete satelitore që i përkasin Republikës së Maqedonisë.

Neni 47

Evidenca e programit të emituar

(1) Radiodifuzerët janë të detyruar që të mbajnë evidencë ditore të programit të emituar dhe ta incizojnë sinjalin dalës të programit të vet, ndërsa incizimet nga programi i përgjithshëm t'i ruajnë së paku 60 ditë pas emetimit.

(2) Dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë janë të detyruar që programet që kanë qenë pjesë përbërëse e katalogut të pandryshuara t'i ruajnë së paku 30 ditë pas datës kur kanë pushuar së qeni të kapshme për shfrytëzuesit.

(3) Me kërkesë të Agjencisë, dhënësit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni janë të detyruar që t'i dorëzojnë incizim autentik dhe integral nga programet më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(4) Në rast të ngritjes së kontestit gjyqësor, dhënësit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni janë të detyruar t'i ruajnë materialet e incizuara deri në përfundimin e kontestit.

(5) Mënyrën e mbajtjes së evidencës ditore nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe cilësinë e incizimeve të programit të përgjithshëm e përcakton Agjencia.

(6) Radiodifuzerët obligohen që për të mirat e kinotekës dhe të mirat e fonotekës që paraqesin trashëgimi kulturore, të mbajnë evidencë të veçantë sipas Ligjit për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

Neni 48

Ndalime të veçanta

Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele nuk guxojnë të mbajnë programe me të cilat rrezikohet siguria nacionale, nxitet rrënimi i dhunshëm i rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thirret në agresion ushtarak ose në konflikt të armatosur, nxitet ose përhapet diskriminimi, mosdurimi, ose urrejtja në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit.

Neni 49

Obligime për vepra kinematografike

Dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizuele nuk guxojnë të publikojnë, përkatësisht të transmetojnë vepra kinematografike jashtë periudhës së përcaktuar në marrëveshjet me poseduesit e të drejtave.

Neni 50

Mbrojtja e personave të mitur

(1) Dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizuele nuk guxojnë të emetojnë programe që mund seriozisht ta dëmtojnë zhvillimin fizik, psikik ose moral të personave të mitur, veçanërisht programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të panevojshme.

(2) Dhunë të panevojshme paraqet përhapja e porosive tekstuale, verbale ose vizuele me të cilat në termine të programit që janë të kapshme për të miturit, glorifikohen forma fizike, verbale ose psikologjike të sadizmit ose forma të ngjashme të dhunës që është qëllim në vete dhe në asnjë mënyrë nuk mund të arsyetohet as nëpërmjet kontekstit të zhanrit, as nëpërmjet motiveve të veprimit dramatik të programit të transmetuar.

(3) Ndalimi nga paragrafi (1) i këtij neni ka të bëjë edhe me programe tjera të cilat me siguri do të mund ta dëmtonin zhvillimin fizik, psikik ose moral të personave të mitur, përveç kur është siguruar me emetimin ose reprizimin e tyre në periudhë të caktuar kohore dhe/ose me zbatimin e masës së caktuar teknike, personat e mitur në periudhën e emetimit ose reprizimit në mënyrën e zakonshme nuk do t'i dëgjojnë ose t'i shikojnë ato programe. Kur programe të këtilla emetohen ose reprizohen në formë të pakoduar, dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuele është i detyruar që para emetimit të tyre të sigurojë paralajmërim akustik paraprak dhe mundësi që të njihen me ndihmë të shenjave vizuele gjatë kohëzgjatjes së tyre.

(4) Agjencia do t'i përcaktojë masat teknike, periudhat e emetimit, paralajmërimin akustik, shenjat vizuele dhe mënyrën e veprimit të dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuele në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(5) Operatorët e rrjeteve publike komunikuese elektronike mund të emetojnë ose riemetojnë servise programore me pornografi vetëm në formë të koduar. Ndalohet emetimi ose riemetimi i pornografisë fëmijërore.

Neni 51

Informata të arritshme për shfrytëzuesit

(1) Dhënësit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele duhet shfrytëzuesve të tyre t'u mundësojnë qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku në të dhënat në vijim:

- emrin e dhënësit të shërbimit mediatik audio dhe audiovizuel, përkatësisht titullin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar identifikuese personal (avizo, logo dhe ngjashëm),
- adresën e selisë së dhënësit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel,

- të dhëna për kontakt me dhënësin e shërbimit mediatik audio ose audiovizuel (numrin e telefonit, adresën e postës elektronike dhe/ose ueb faqen, personin për kontakt për vendosje të kontaktit në mënyrë të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikase) dhe

- nëse është e mundur edhe të dhënat për trupin kompetent rregullator.

(2) Shenjat për identifikim doemos duhet të jenë të theksuara në kontinuitet në të gjitha programet, përkatësisht të emetohen së paku një herë gjatë një ore reale të programit të radios.

(3) Dhënësit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele mund t'i përdorin vetëm shenjat e tyre për identifikim.

(4) Dhënësit e shërbimeve mediatike audio audiovizuele janë të obliguar që për çdo ndryshim të shenjave të tyre për identifikim të parashtrajnë ekzemplar të tyre në Agjencinë.

Neni 52

Obligime gjatë sigurimit të kuizeve ose formave tjera të ndryshme të pjesëmarrjes shpërblyese

Dhënësi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele gjatë emetimit të kuizeve ose formave tjera të ndryshme të pjesëmarrjes shpërblyese të dëgjuesve ose shikuesve detyrohet që të sigurojë publikim të padyshimtë të rregullave për ato përmbajtje dhe për shpërblimin e premtuar publik, në mënyrë të përcaktuar nga Agjencia.

Neni 53

Komunikimi komercial audiovizuel

(1) Komunikimi komercial audiovizuel doemos duhet të jetë menjëherë i identifikueshëm si i tillë.

(2) Nuk lejohen komunikime komerciale audiovizuele të fshehta.

(3) Komunikimi komercial audiovizuel nuk guxon të shfrytëzojë teknika të nënvetëdijes.

(4) Komunikimet komerciale audiovizuele nuk guxojnë:

- ta vendosin në pikëpyetje respektimin e dinjitetit të njeriut,
- të përfshijnë ose të promovojnë çfarëdo qoftë diskriminimi në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë etnike, nacionalitetit, fesë ose bindjes, invaliditet, moshës ose orientimit seksual,
- të stimulojnë sjellje që është e dëmshme për shëndetin ose sigurinë dhe
- të stimulojnë sjellje që në masë të konsiderueshme e rrezikon mjedisin jetësor.

(5) Ndalohen komunikimet komerciale audiovizuele me të cilat në mënyrë të rremë do të paraqitet natyra, karakteristikat, cilësia ose prejardhja gjeografike e prodhimeve, shërbimeve ose veprimtarive komerciale.

(6) Për autenticitetin dhe saktësinë e pohimeve dhe të dhënave në komunikimet komerciale audiovizuele përgjegjës është porositësi i tyre, kurse për harmonizimin e tyre me ligj redaktori përgjegjës në dhënësin e shërbimit mediatik audiovizuel.

(7) Nuk lejohet çfarëdo qoftë forme e komunikimit komercial audiovizuel që promovon drogë, cigare ose produkte tjera të duhanit, si dhe alkool dhe pije alkoolike, përveç verës dhe birrës.

(8) Komunikimet komerciale audiovizuele për verë dhe birrë nuk guxojnë:

- konkretisht të dedikohen për të miturit, e veçanërisht nuk guxojnë të paraqesin të mitur se si i konsumojnë,
- ta lidhin konsumimin e tyre me aftësinë e përmirësuar fizike ose me vozitje,
- të krijojnë përshtypje se konsumimi i tyre kontribuon për sukses shoqëror ose seksual,
- të pohojnë se vera dhe birra kanë cilësi terapeutike ose se janë stimulans, sedativ ose mjet për zgjidhje të konflikteve personale,
- të stimulojnë konsumimin pa masë të tyre ose ta paraqesin abstinencën ose maturinë në dritë negative dhe

- të theksojnë se përqindja e lartë e alkoolit është cilësi pozitive e pijeve alkoolike.

(9) Nuk lejohen komunikime komerciale audiovizuale të cilat promovojnë produkte mjekësore dhe trajtime mjekësore, të cilat janë të arritshme vetëm me recetë.

(10) Komunikimet komerciale audiovizuale për produkte mjekësore dhe trajtime mjekësore që jepen pa recetë të mjekut nuk guxojnë të stimulojnë përdorimin e tyre joracional, duke i prezantuar ato në mënyrë objektive dhe pa i glorifikuar cilësitë e tyre, në pajtim me udhëzimet për shfrytëzimin e tyre.

(11) Nuk lejohen komunikime komerciale audiovizuale për armë, mjete për qitje dhe mjete piroteknike dhe firma të cilat i shesin ato.

(12) Servisit publik radiodifuziv nuk i lejohen komunikime komerciale audiovizuale për parti politike, koalicione dhe përfaqësues të tyre, kandidatë të pavarur dhe bartës të funksioneve politike.

(13) Komunikimet komerciale audiovizuale nuk guxojnë t'u shkaktojnë dëm fizik ose moral personave të mitur.

(14) Komunikimet komerciale audiovizuale që u dedikohen personave të mitur ose në të cilat ato marrin pjesë, nuk guxojnë:

- drejtpërdrejt t'i nxisin personat e mitur ta blejnë ose të huazojnë produkt ose shërbim duke e shfrytëzuar papërvojën e tyre ose naivitetin e tyre,

- drejtpërdrejt t'i inkurajojnë personat e mitur të kërkojnë nga prindërit ose personat tjerë që t'ua blejnë produktet ose shërbimet e reklamuar,

- ta shfrytëzojnë besimin e veçantë që personat e mitur e kanë në prindërit, arsimtarët ose personat tjerë dhe

- t'i paraqesin personat e mitur në situata të rrezikshme.

(15) Komunikimet komerciale audiovizuale që janë pjesë përbërëse ose i shoqërojnë emisionet për fëmijë, e që kanë të bëjnë me ushqim dhe pije të cilat përmbajnë materie ushqyese dhe substanca me efekt ushqyes apo fiziologjik, konkretisht nga lloji i yndyrave, acide të ngopura yndyrore, kripë/natrium dhe sheqerna, konsumi tejmase i të cilave në ushqimin e përgjithshëm nuk rekomandohet, nuk guxojnë:

- të përmbajnë informata të pasakta ose mashtruese për vlerën ushqimore të produktit,

- të sugjerojnë se ushqim ose pije e caktuar është zëvendësim për pemë dhe/ose perime dhe

- të inkurajojnë shprehi të pashëndetshme për ushqim ose pije siç janë konsumimi pa masë, i tepruar ose i pakontrolluar.

(16) Komunikimet komerciale audiovizuale detyrimisht emetohen në gjuhën maqedonase, me përkthim në maqedonisht ose në gjuhën e bashkësisë etnike përkatëse.

(17) Komunikimet komerciale audiovizuale duhet:

- të jenë pajtim me rregullat ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me konkurrencën jolojale dhe

- të jenë të vërteta dhe të ndershme, të mos e mashtrojnë publikun dhe të mos jenë në kundërshtim me interesat e konsumatorëve.

(18) Komunikimet komerciale audiovizuale nuk guxojnë të ndikojnë mbi pavarësinë redaktuese të dhënësve të shërbimeve audiovizuale.

(19) Dispozitat e këtij neni, në mënyrë përkatëse aplikohen edhe në komunikimet komerciale audio.

(20) Dhënësit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale mund të përcaktojnë kodeks të sjelljes në lidhje me emetimin e kumtimeve komerciale audiovizuale joadekuate, që i shoqërojnë ose janë të përfshira në programe fëmijërore, e që kanë të bëjnë me ushqim ose pije që përmbajnë materie ushqyese dhe materie me efekt ushqyes ose psikologjik, veçanërisht yndyra, acide transyndyrore, kripë/natrium dhe sheqerna, konsumi i tepruar i të cilave nuk rekomandohet në ushqimin normal.

Neni 54
Sponsorimi

(1) Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele të sponsoruara ose programet nuk guxojnë që drejtpërdrejt të stimulojnë blerje ose huazim të mallrave ose shërbimeve, sidomos nëpërmjet rekomandimit të tyre të veçantë promovues.

(2) Në shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele të sponsoruara ose programet duhet të jetë përcaktohen qartë se bëhet fjalë për program të sponsoruar. Sponsorit duhet të identifikohet qartë me emrin, logon dhe/ose çfarëdo shenje tjetër të sponsorit, siç është përmendja e produkteve të tij ose shërbimeve ose shenjën e tij karakteristike, në mënyrë përkatëse, në fillim, gjatë kohëzgjatjes dhe/ose në fund të programit.

(3) Në shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele ose programet e sponsoruara, përmbajtja e tyre, e në rast të radiodifuzionit edhe orari i tyre nuk guxon, në asnjë rast të pësojë ndikim që do të ketë efekt mbi përgjegjësinë dhe pavarësinë redaktuese të dhënësit të shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele.

(4) Rregullat për sponsorim rregullohen me akt nënligjor që e miraton Agjencia.

(5) Nuk lejohet sponsorimi i lajmeve, programeve aktuale-informative për ngjarjet rrjedhëse dhe të programeve fetare.

(6) Shërbimet mediatike audio dhe audiovizuele ose programet nuk guxojnë të sponsorohen nga persona juridikë ose fizikë veprimtaria kryesore e të cilëve është prodhimtaria ose shitja e cigareve dhe produkteve tjera të duhanit.

(7) Nuk lejohet sponsorimi i shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele ose programeve nga persona fizikë ose juridikë veprimtaria kryesore e të cilëve është prodhimtaria ose shitja e produkteve ose dhënia e shërbimeve, e reklamimi i të cilave është i ndaluar në pajtim me këtë ligj.

(8) Si shmangie nga paragrafi (7) i këtij neni, personat fizikë dhe juridikë aktivitetet e të cilëve përfshijnë prodhimtari ose shitje të produkteve mjekësore dhe/ose trajtimeve mjekësore mund të sponsorojnë shërbime mediatike audio dhe audiovizuele. Në këtë rast mund të promovohet vetëm emri i tyre ose imazhi, por jo edhe produkte konkrete mjekësore ose trajtime mjekësore të arritshme ekskluzivisht me recetë të mjekut.

(9) Nuk lejohet identifikimi i sponsorit gjatë programeve dokumentare dhe të programeve për fëmijë.

Neni 55
Plasimi i produkteve

(1) Plasimi i produkteve është i ndaluar.

(2) Si shmangie nga paragrafi (1) i këtij neni, plasimi i produkteve është i lejuar në llojet e programeve në vijim:

- vepra kinematografike, filma dhe seriale të bëra për shërbime mediatike audiovizuele, programe sportive dhe programe të lehta argëtuese ose

- në raste kur për këtë nuk paguhet, përkatësisht kur falas sigurohen mallra ose shërbime siç janë rekuizita produksioni ose shpërblime me qëllim të inkuadrimit të tyre në program.

(3) Shmangia nga paragrafi (2) alineja 1 nuk vlen për programe për fëmijë.

(4) Programet që përmbajnë plasim të produkteve, përmbajtja e tyre, e në rast të emetimit televiziv edhe orari i tyre nuk guxon, në asnjë rast të pësojë ndikim që do të ketë efekt mbi përgjegjësinë dhe pavarësinë redaktuese të dhënësit të shërbimeve mediatike audiovizuele.

(5) Në programet që përmbajnë plasim të produkteve duhet qartë të shënohet se bëhet fjalë për program në të cilin ka plasim të produkteve. Këto programe doemos duhet të shënohen në

mënyrë përkatëse në fillim dhe në fund të programit dhe gjatë vazhdimit të programit pas çdo pauze për reklamim, me qëllim që të shmanget hutia te shikuesit.

(6) Programet që përmbajnë plasim të produkteve nuk guxojnë drejtpërdrejt të stimulojnë blerje ose huazim të mallrave ose shërbimeve, veçanërisht nëpërmjet rekomandimit të tyre të veçantë promovues.

(7) Në programet që përmbajnë plasim të produkteve nuk guxon t'i jepet rëndësi e tepruar (theksim ose dedikim) produktit për të cilin bëhet fjalë.

(8) Nuk lejohet plasim i cigareve dhe produkteve tjera nga duhani dhe plasimi i produkteve të personave fizikë ose juridikë veprimtaria kryesore e të cilëve është prodhimtaria ose shitja e cigareve dhe produkteve tjera nga duhani.

(9) Nuk lejohet plasimi i produkteve mjekësore dhe trajtimeve mjekësore që lëshohen vetëm me recetë të mjekut.

(10) Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohet plasimi i produkteve do të aplikohen për programe që do të prodhohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

V.2. Sigurimi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë (shërbime mediatike audiovizuele dhe audio jolineare)

Neni 56

Sigurimi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë

(1) Dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë detyrohet para se të fillojë me sigurimin e llojit të caktuar të shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë të parashtrorë fletëparaqitje për evidentim në regjistrin e dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë që mbahet në Agjencinë, për çfarë Agjencia i lëshon vërtetim për regjistrim.

(2) Fletëparaqitja parashtrorë në formular të përpiluar nga Agjencia dhe e njëjta publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

(3) Fletëparaqitja veçanërisht duhet të përmbajë:

- emrin e shërbimit dhe identifikimin e tij,
- firmën, selinë dhe numrin tatimor të dhënësit të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës të dhënësit të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë,
- llojin e shërbimit dhe përshkrim të shkurtër të tij dhe
- datën e fillimit me sigurim të shërbimit.

(4) Me fletëparaqitjen nga paragrafi (3) i këtij neni parashtrorë certifikatë nga Regjistri Qendror dhe përshkrim teknik me karakteristika të hollësishme teknike për mënyrën në të cilën do të sigurohet shërbimi.

(5) Nëse fletëparaqitja nuk është e kompletuar në pajtim me paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, Agjencia në formë me shkrim do ta njoftojë parashtruesin e fletëparaqitjes që të njëjtën ta plotësojë dhe ta parashtrorë në afat prej 10 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit.

(6) Agjencia nuk guxon të refuzojë ta evidentojë dhënësin e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë në regjistrin e dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, përkatësisht ta japë vërtetimin nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse fletëparaqitja i përmban të gjitha të dhënat nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni.

(7) Agjencia detyrohet që vërtetimin nga paragrafi (1) i këtij neni ta lëshojë në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e pranimit të fletëparaqitjes, përkatësisht nga dita e skadimit të afatit plotësues nga paragrafi (5) të këtij neni, nëse fletëparaqitja i përmban të gjitha të dhënat nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni.

(8) Nëse Agjencia nuk vepron në pajtim me paragrafin (7) të këtij neni, konsiderohet se vërtetimi për regjistrim është lëshuar.

(9) Dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë detyrohet ta njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave të theksuara në fletëparaqitjen në afat prej 30 ditëve nga dita e ndryshimit të krijuar. Agjencia detyrohet ta futë ndryshimin e të dhënave në regjistrin e dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të njoftimit.

Neni 57

Regjistri i dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë

(1) Agjencia mban regjistër të dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, i cili veçanërisht duhet të përmbajë:

- firmën dhe selinë, si dhe emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës të dhënësit të shërbimeve audiovizuele me kërkesë,

- mënyrën në të cilën sigurohet shërbimi,

- zonën në të cilën kryhet veprimtaria,

- llojin e shërbimit dhe përshkrim të shkurtë të tij dhe

- datën e fillimit me sigurim të shërbimit, si dhe çdo ndryshim të kryer gjatë sigurimit të shërbimit.

(2) Agjencia i publikon në ueb faqen e vet të dhënat nga regjistri nga paragrafi (1) i këtij neni, duke pasur parasysh mbrojtjen e të dhënave personale.

(3) Formën dhe përmbajtjen e regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton Agjencia.

Neni 58

Shlyerje nga regjistri i dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë

(1) Agjencia do ta shlyejë dhënësin e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nga regjistri nga neni 57 i këtij ligji, nëse:

- dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë në formë me shkrim e njofton Agjencinë se ka pushuar ta kryejë veprimtarinë,

- dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë pushon ta kryejë veprimtarinë në periudhë më të gjatë se një vit,

- dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, nuk i plotëson më kushtet teknike për transmetim të programeve audiovizuele,

- dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë nuk fillon ta kryejë veprimtarinë në afat prej tre muajsh nga data e fillimit të sigurimit të shërbimit të theksuar në fletëparaqitjen nga neni 56 paragrafi (3) i këtij ligji,

- dhënësit të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë me vendim të plotfuqishëm gjyqësor i ndalohe kryerja e veprimtarisë dhe

- dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë ka pushuar të ekzistojë.

Neni 59

Kompensimi për sigurim të shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë

Për sigurim të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, paguhet kompensim vjetor për mbikëqyrje në llogarinë e Agjencisë në pajtim me nenin 142 të këtij ligji

Neni 60

Promovimi i prodhimitarisë dhe qasja në veprat evropiane

(1) Dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, atëherë kur kjo është e realizueshme dhe me mjete përkatëse, duhet ta promovojnë prodhimtarinë dhe qasjen në veprat evropiane. Promovimi i këtillë mund të ketë të bëjë, mes tjerash, me:

- kontributin financiar për prodhimtari dhe fitim të të drejtave për vepra evropiane ose
- përfaqësimin dhe/ose vendosjen e veprave evropiane në katalogun me programe.

(2) Me kërkesë të Agjencisë dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë janë të obliguar që në afatin e caktuar në kërkesën, Agjencisë t'i parashtrojnë dokumente në lidhje me implementimin e dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni.

V. 3. Sigurimi i emetimit televiziv ose të radios (shërbime mediatike lineare)

V. 3.1. Dispozita të përgjithshme

Neni 61

Parime

Radiodifuzerët gjatë kryerjes së veprimtarisë duhet t'i respektojnë parimet, si vijojnë:

- kultivimin dhe zhvillimin e vlerave humane dhe morale të njeriut dhe mbrojtjen e privatësisë dhe dinjitetit të personalitetit,
- barazinë e lirive dhe të drejtave pavarësisht gjinisë, racës, origjinës nacionale, etnike dhe sociale, bindjes politike dhe fetare, gjendjes pronësore dhe shoqërore të njeriut dhe qytetarit,
- nxitjen e frymës së tolerancës, respektimit të ndërsjellë dhe mirëkuptimit ndërmjet individëve me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore,
- mbrojtjen e identitetit të viktimave të dhunës,
- respektimin e prezumpcionit të pafajësisë,
- nxitjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ndjenjën e publikut për drejtësi dhe për mbrojtje të lirive demokratike,
- transparencën e programeve për shprehjen e kulturave të ndryshme që janë pjesë përbërëse e shoqërisë;
- ruajtjen dhe kultivimin e identitetit nacional, kulturës gjuhësore dhe krijimtarisë vendore,
- paraqitjen e ngjarjeve në mënyrë objektive dhe të paanshme me trajtim të njëjtë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme dhe mundësimin e formimit të lirë të mendimit të publikut për ngjarje të caktuara dhe çështje,
- respektimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta,
- respektimin e fshehtësisë së burimit të informatës,
- garantimin e të drejtës së përgjigjes dhe korrigjimit dhe
- mëvetësinë, pavarësinë dhe përgjegjësinë e redaktorëve, gazetarëve dhe autorëve tjerë gjatë krijimit të programeve dhe krijimit të politikës redaktuese.

Neni 62

Kushtet për sigurim të emetimit televiziv ose të radios

(1) Veprimtarinë sigurim të emetimit televiziv dhe të radios e kryen radiodifuzeri i cili është i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, ka seli dhe redaksi në Republikën e Maqedonisë dhe ka leje për emetim televiziv ose të radios.

(2) Radiodifuzeri mund të fillojë me sigurimin e emetimit televiziv dhe të radios pas marrjes së lejes për emetim televiziv ose të radios.

(3) Leja nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të lëshohet për zonën e tërë territorit të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht për nivel shtetëror, për zonën e rajonit të caktuar, përkatësisht për nivel rajonal apo për zonën e vendbanimit të caktuar me rrethin më të afërt, përkatësisht për nivel lokal, në pajtim me aktin nënligjor të miratuar nga Agjencia. Pronari i lejes e fiton të drejtën që ta emetojë serivisin programor të radios apo televiziv në zonën, përkatësisht nivelin për të cilin e ka marrë lejen.

(4) Si zona në nivel rajonal për të cilat lëshohet leja për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, konsiderohen zonat e shpërndarjes të përkufizuara në Planin Gjeneva 06, i cili është pjesë e Konferencës radiokomunikese rajonale për planifikimin e shërbimit radiodifuziv digjital në pjesët e Rajoneve 1 dhe 3, në shtrirjet e e radiofrekuencës 174-230 MHz dhe 470-862 MHz (RRC-06) në të cilën ka aderuar Republika e Maqedonisë, përveç zonës së shpërndarjes D1 - Cërn Vërv e cila përbëhet nga dy rajone të emetimit Shkup dhe Veles, përkatësisht zona e nivelit rajonal Shkup dhe zona e nivelit rajonal Veles. Zona e nivelit rajonal Shkup i përmban: Qytetin e Shkupit dhe komunat Çuçer Sandevë, Haraçinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopištë. Zona e nivelit rajonal Veles i përmban komunat: Veles, Çashkë, Sveti Nikollë, Llozovë, Gradsko, Rosoman, Negotinë dhe pjesë të komunës së Kavadarcit.

(5) Gjatë sigurimit të emetimit televiziv ose të radios, përmes resursit të kufizuar, siç janë radiofrekuencat apo kapaciteti transmetues i multipleksit terestrial digjital në nivel shtetëror apo rajonal, radiodifuzeri detyrohet të sigurojë mbulim me sinjal të së paku 80% të popullsisë në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht të popullsisë në rajonin përkatës.

(6) Për sigurimin e emetimit televiziv ose të radios krahas kushteve dhe obligimeve të përcaktuara në këtë ligj, radiodifuzeri duhet të plotësojë kushte të posaçme minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike varësisht nga formati i programit, të përcaktuara me aktin nënligjor të miratuar nga Agjencia.

Neni 63

Mënyra e emetimit

(1) Emetimi i serivisit programor televiziv, mund të kryhet përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital, rrjetit komunikues elektronik publik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar apo përmes satelitit.

(2) Emetimi i serivisit programor të radios, mund të kryhet përmes radiofrekuencave, kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital, rrjetit komunikues elektronik publik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar apo përmes satelitit.

Neni 64

Përdorimi i gjuhës

(1) Radiodifuzerët detyrohen ta emetojnë programin në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, kurse në rastet kur programi dedikohet për bashkësi që nuk është shumicë, në gjuhën dhe alfabetin e asaj bashkësie.

(2) Nëse serviset programore që riemtohen përmes rrjeteve komunikuese elektronike publike titullohen në gjuhë të ndryshme nga gjuha në të cilën në mënyrë origjinale janë prodhuar, doemos duhet të titullohen në gjuhën maqedonase, ose në gjuhën e bashkësisë që nuk është shumicë ndërsa e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë përveç teleshopingut dhe reklamave.

(3) Programet në gjuhë të huaja apo pjesë prej tyre që emetohen në programet e radiodifuzerëve duhet të përkthehen në gjuhën maqedonase, përkatësisht në gjuhën e bashkësisë që nuk është shumicë.

(4) Dispozitat nga paragrafi (3) i këtij neni, nuk kanë të bëjnë me transmetimet e ngjarjeve muzikore dhe skenike, me programe arsimore për mësimin e gjuhëve të huaja, si dhe me pjesë të programeve të dedikuara për të huaj.

(5) Pjesët e programeve që nuk përkthehen paralajmërohen në gjuhën maqedonase, përkatësisht në gjuhën e bashkësisë që nuk është shumicë.

Neni 65

Llojet e radiodifuzerëve

(1) Radiodifuzer mund të jetë shoqëri radiodifuzive tregtare, ndërmarrje radiodifuzive publike apo institucioni radiodifuziv joprofitabil.

(2) Shoqëri radiodifuzive tregtare mund të themelojnë personat juridikë dhe fizikë në kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(3) Ndërmarrje radiodifuzive publike themelohet për tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe kryen funksion të servisit radiodifuziv publik.

(4) Institucion radiodifuziv joprofitabil mund të themelohet vetëm për emetim të radios edhe atë vetëm nga institucione dhe shoqatat arsimore, kulturore dhe institucione tjera dhe shoqata civile dhe fondacione me qëllim që të përmbushen nevojat dhe interesat e grupeve qëllimore specifike.

(5) Më tepër subjekte nga paragrafi (4) i këtij neni, mund të marrin leje për emetim të programit në një radiofrekuencë sipas parimit të ndarjes së kohës për emetim (tajmshering).

(6) Me përjashtim të paragrafit (4) të këtij neni, universiteti si institucion i arsimit të lartë mund të themelojë radio si njësi të posaçme të brendshme organizative (radio studentore) pa cilësi të personit juridik.

(7) Te radiodifuzerët që sigurojnë emetim televiziv ekskluzivisht të dedikuar për reklamim dhe teleshoping, si dhe për vetëpromovim, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 66

Regjistri i radiodifuzerëve

(1) Agjencia mban regjistër të radiodifuzerëve në Republikën e Maqedonisë, i cili sidomos duhet të përmbajë:

- firmën dhe selinë, si dhe emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës të radiodifuzerit,
- emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës,
- adresën e redaksisë dhe adresën e redaktorit përgjegjës,
- mënyrën e emetimit të servisit programor (radiofrekuencën, multipleksin terestrial digjital, satelitin apo rrjetin komunikues elektronik publik),
- nivelin e shikueshmërisë/dëgjueshmërisë (shtetëror, rajonal apo lokal),
- rajonin(-et) në të cilin do të kryhet veprimtaria,
- zonën e servisit dhe lokacionin e mjeteve teknike për emetim, nëse bëhet fjalë për emetim analog terestrial të radios,
- shenjën për identifikim dhe
- konceptin programor.

(2) Agjencia i publikon në ueb faqen e saj të dhënat e regjistrimit nga paragrafi (1) i këtij neni, duke i pasur parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(3) Formën dhe përmbajtjen e regjistrimit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton Agjencia.

Neni 67

Koncepti programor i radiodifuzerit

(1) Formati i servisit programor të radiodifuzerit (i përgjithshëm apo i specializuar) dhe drejtimet thelbësore themelore për punën e radiodifuzerit përcaktohen me koncept programor.

(2) Koncepti programor i radiodifuzerit duhet të përmbajë edhe strukturë programore me të cilën përcaktohet:

- klasifikimi i programeve në grupe të veçanta sipas llojit të tyre, si dhe përpjesëtimi i paraparë procentual kuantitativ ndërmjet grupeve dhe

- përfaqësimi i paraparë i programit i prodhuar nga vetë radiodifuzeri (in-house production) dhe produksioni i veprave audio/ audiovizuale maqedonase.

(3) Koncepti programor për emetim televiziv duhet të përmbajë edhe sasi fillestare të veprave evropiane dhe veprave nga producentë të pavarur.

(4) Për emetim televiziv në nivel rajonal apo nivel lokal, si dhe për institucion radiodifuziv joprosfitabil nuk vlen dispozita nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Formularin e konceptit programor nga paragrafi (1) i këtij neni, e përpilon Agjencia dhe e publikon në ueb faqen e saj.

(6) Radiodifuzeri detyrohet të zbatojë së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është lëshuar leja gjatë një jave.

(7) Për ndryshimin apo plotësimin e konceptit programor në bazë të të cilit radiodifuzeri e ka marrë lejen për emetim televiziv apo të radios, më tepër se 20%, radiodifuzeri doemos duhet të marrë pëlqim paraprak nga Agjencia. Kërkesa për marrjen e pëlqimit dorëzohet në formular të përpiluar nga Agjencia dhe të publikuar në ueb faqen e saj.

(8) Koncepti programor në bazë të të cilit radiodifuzeri e ka marrë lejen për emetim televiziv apo të radios, si dhe ndryshimet apo plotësimet e tij publikohen në ueb faqen e Agjencisë.

(9) Koncepti programor në bazë të të cilit radiodifuzeri e ka marrë lejen për emetim televiziv apo të radios është pjesë përbërëse e marrëveshjes për punë e cila lidhet ndërmjet radiodifuzerit dhe redaktorëve, përkatësisht gazetarëve.

(10) Redaktori përgjegjës është përgjegjës për zbatimin e konceptit programor të radiodifuzerit.

(11) Agjencia më hollësisht do t'i përcaktojë formatet e serviseve programore për radiodifuzerët televizivë apo të radios.

(12) Koncepti programor nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohet te Agjencia në procedurë të ndarjes së lejes për emetim televiziv apo të radios.

(13) Dispozitat e këtij neni nuk kanë të bëjnë me servisin radiodifuziv publik.

V.3.2. Mënyra dhe procedura e lëshimit të Lejes për emetim televiziv ose të radios

Neni 68

Leja për emetim televiziv ose të radios

Lejen për emetim televiziv apo të radios e ndan Agjencia për nivel të caktuar të shikueshmërisë apo dëgjueshmërisë (shtetëror, rajonal apo lokal), kurse poseduesi i lejes e merr të drejtën që ta emetojë servisin programor të televizionit apo të radios në zonën për të cilën e ka marrë lejen.

Neni 69

Mënyra e ndarjes së lejes

(1) Për servisn programor të radios terestriale që emetohet përmes resursit të kufizuar siç janë radiofrekuencat apo kapaciteti transmetues i multipleksit terestrial digjital, lejen për emetim të radios e ndan Agjencia nëpërmjet konkursit publik.

(2) Për servisn programor të televizionit terestrial nëse emetohet përmes resursit të kufizuar mund të emetohet vetëm përmes kapacitetit transmetues të multipleksit terestrial digjital, për të cilën lejen për emetim televiziv e jep Agjencia nëpërmjet konkursit publik.

(3) Për servisn programor të radios apo televizionit që emetohet përmes rrjetit komunikues elektronik publik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar apo përmes satelitit, Agjencia pa konkurs publik jep leje për emetim televiziv apo të radios.

(4) Procedura për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios është transparente dhe udhëhiqet në mënyrë që siguron trajtim të njëjtë, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.

(5) Agjencia në bashkëpunim me Agjencinë për Komunikime Elektronike, ministrinë kompetente, servisn radiodifuziv publik dhe Ndërmarrjen Publike Radiodifuzioni i Maqedonisë, e me pëlqim të marrë paraprakisht nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton Plan për dedikim dhe shpërndarje të kapaciteteve të multipleksit terestrial digjital të operatorit të rrjetit komunikues elektronik publik i cili ka obligim për emetim të serviseve programore të radiodifuzerëve. Përcaktimi i dedikimit dhe shpërndarjes së kapaciteteve bëhet duke e pasur parasysh plotësimin e qëllimeve të përcaktuara në nenin (2) të këtij ligji.

(6) Plani nga paragrafi (5) i këtij neni, përveç tjerash duhet të përmbajë:

- numrin e serviseve programore televizive (definicion i lartë/standard),
- numrin e serviseve programore të radios,
- kapacitetet e parapara për shërbime shtesë, informata dhe të dhëna tjera shoqëruese dhe
- kapacitetet e parapara për kalim në emetim të televizionit në definicion të lartë apo teknologji tjera të reja.

(7) Plani nga paragrafi (5) i këtij neni, publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

(8) Ndryshimi i Planit nga paragrafi (5) i këtij neni, nuk guxon t'i zvogëlojë parametrat për cilësinë e emetimit të serviseve programore të radiodifuzerëve të cilat në moment emetohen.

Neni 70

Dhënia e lejes për emetim televiziv apo të radios nëpërmjet konkursit publik

(1) Agjencia do të miratojë vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios, me detyrë zyrtare apo me pranimin e kërkesës me shkrim nga pala e interesuar, në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, Planin për dedikim dhe shpërndarje të kapaciteteve të multipleksit terestrial digjital, si dhe në pajtim me studimin nga paragrafi (3) i këtij neni.

(2) Nëse në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave apo Planin për dedikim dhe shpërndarje të kapaciteteve të multipleksit terestrial digjital përcaktohet se nuk kanë radiofrekuenca të lira apo kapacitete, Agjencia në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, do të miratojë vendim me të cilin atë do ta refuzojë.

(3) Vendimi nga paragrafi (2) i këtij neni, është përfundimtar, e kundër tij mund të parashtrohet padi para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij.

(4) Nëse në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave apo Plani për dedikim dhe shpërndarje të kapaciteteve të multipleksit terestrial digjital përcaktohet se ka radiofrekuenca të lira ose kapacitete, Agjencia do të hartojë studim me të cilin do ta përcaktojë

arsyeshmërinë për shpallje të konkursit publik, e veçanërisht nga aspekti i plotësimit të qëllimit të këtij ligji, si dhe nga aspekti i nevojave të publikut. Që t'i përcaktojë nevojat e publikut për emetim televiziv apo të radios në zonën përkatëse të servisit si dhe për llojin, përkatësisht formatin e serviseve programore për të cilat duhet të shpallet konkursi, Agjencia mund të zbatojë hulumtim publik.

(5) Nëse Studimi nga paragrafi (4) i këtij neni, hartohet për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios me kërkesë me shkrim nga pala e interesuar, Agjencia detyrohet që atë ta hartojë në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të kërkesës dhe ta publikojë në ueb faqen e vet.

(6) Nëse në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave apo Planin për dedikim dhe shpërndarje të kapaciteteve të multipleksit terestrial digjital përcaktohet se ka radiofrekuenca të lira ose kapacitete dhe nëse me studimin nga paragrafi (4) i këtij neni përcaktohet se ka arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik, Agjencia në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit të studimit do të miratojë vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios.

(7) Nëse me studimin nga paragrafi (4) i këtij neni, përcaktohet se nuk ka arsyeshmëri për shpalljen e konkursit publik, Agjencia në afat prej tetë ditësh nga dita e publikimit të studimit do të miratojë vendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni.

(8) Vendimi nga paragrafi (7) i këtij neni është përfundimtar, e kundër tij mund të parashtrahet padi para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij.

(9) Vendimi për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios përmban arsyetim sidomos për shkaqet për shpalljen e konkursit publik dhe publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" në ueb faqen e Agjencisë, si dhe në dy gazeta ditore prej të cilave një gazetë ditore është në gjuhën e bashkësisë që nuk është shumicë, e që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

(10) Të drejtë për pjesëmarrje në konkursin publik ka personi fizik dhe juridik vendor dhe i huaj.

(11) Personi juridik vendor, themeluesit e të cilit janë edhe personat e huaj të regjistruar në vendet në të cilat në pajtim me rregullat e atyre vendeve nuk lejohet apo nuk është e mundur të përcaktohet origjina e kapitalit themelues, nuk mund të marrë pjesë në konkursin publik.

(12) Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve për konkursin rrjedh nga dita e parë e ardhshme nga dita e botimit të vendimit nga paragrafi (9) i këtij neni në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 71

Përmbajtja e vendimit për shpalljen e konkursit publik

Vendimi për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios përmban:

- veprimtarinë (e radios apo televizionit) për të cilën shpallet konkursi,
- llojin e servisit programor, përkatësisht formatin e përcaktuar në pajtim me studimin nga neni 70 i këtij ligji,
- nivelin e shikueshmërisë/dëgjueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal),
- rajonin(-et) në të cilin do të kryhet veprimtaria,
- radiofrekuencën (-at) apo kapacitetin në multipleksin terestrial digjital,
- numrin e lejeve për emetim televiziv apo të radios,
- kushtet që duhet të plotësohen në pajtim me aktin për kushte minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike nga neni 62 paragrafi (3) i këtij ligji, si dhe karakteristikat dhe parametrat teknikë të caktuara nga Agjencia për Komunikime Elektronike në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike dhe rregullat e miratuara në bazë të tij,

- kriteret për vlerësim dhe mënyrën e ndarjes së pikëve në pajtim me nenin 74 të këtij ligji,
- kohëzgjatjen e lejes në pajtim me nenin 79 të këtij ligji,
- vendin dhe kohën kur mund të ngrihet dokumentacioni i konkursit dhe
- lartësinë dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për dokumentacionin,
- lartësinë dhe mënyrën e pagesës së kompensimeve të përcaktuara me këtë ligj,
- lartësinë dhe mënyrën e pagesës së kompensimeve për shfrytëzimin e radiofrekuencës apo më tepër radiofrekuencave nëse janë pjesë e një lejeje, përkatësisht lartësinë dhe mënyrën e pagesës për emetim përmes kanalit të lirë të multipleksit,
- dokumentacionin që duhet të parashtrohet së bashku me fletëparaqitjen në pajtim me nenin 73 paragrafi (3) të këtij ligji,
- mënyrën për parashtrimin e fletëparaqitjeve dhe afatin e fundit për parashtrimin e fletëparaqitjeve, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë e më i gjatë se 90 ditë nga dita e botimit të Vendimit për shpalljen e konkursit publik në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë",
- adresën, vendin, datën dhe kohën e hapjes publike të fletëparaqitjeve, personin për kontakt nga i cili kandidatët mund të marrin informata shtesë,
- afatin në të cilin do të miratohet vendimi për dhënien e lejes i cili nuk mund të jetë më gjatë se 30 ditë nga dita e hapjes publike të fletëparaqitjeve dhe
- afatin i cili nuk mund të jetë më i gjatë se shtatë ditë në të cilin kandidatët do të njoftohen për vendimin e miratuar për dhënien e lejes, e i cili duhet të përmbajë arsyetim të hollësishëm me theksimin e shkaqeve për miratimin e vendimit.

Neni 72

Dokumentacioni i konkursit

Agjencia detyrohet në dokumentacionin e konkursit hollësisht t'i arsyetojë dhe saktësojë në mënyrë plotësuese të gjitha dispozitat e vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios.

Neni 73

Fletëparaqitja për pjesëmarrje në konkurs publik

(1) Kandidatët në konkurs parashtrojnë fletëparaqitje në formular të posaçëm, formën dhe përmbajtjen e të cilës e përcakton Agjencia dhe i njëjti sidomos duhet të përmbajë:

- emrin dhe mbiemrin, adresën, faksin, e-mailin dhe aktin për shtetësi të kandidatit apo firmën dhe selinë e personit juridik nëse kandidati është person juridik,
- natyrën dhe vëllimin e pjesëmarrjes që do ta ketë kandidati në strukturën pronësore të radiodifuzerit dhe pjesëmarrjen e tij në strukturën pronësore në radiodifuzerët tjerë, nëse e ka,
- emrin ose titullin, numrin amë ose tatimor të personave tjerë fizikë apo juridikë që do të marrin pjesë në strukturën pronësore të radiodifuzerit dhe pjesëmarrjen e tyre në radiodifuzerët tjerë, nëse i ka,
- të dhëna për personat tjerë juridikë dhe fizikë që do të mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në politikën redaktuese të radiodifuzerit, nga aspekti i personave të lidhur sipas këtij ligji,
- selinë ku do të jetë radiodifuzeri si dhe selinë ku do të miratohen vendimet redaktuese dhe afatin e fillimit me kryerjen e veprimtarisë.

(2) Formulari nga paragrafi (1) i këtij neni, publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

(3) Me fletëparaqitjen nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet dokumentacioni si vijon:

- koncepti programor i ofruar,
- dëshmi për regjistrim të personit juridik,

- dëshmi për strukturën pronësore të personit juridik,
- kushtet e ofruara teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në pajtim me aktin nga neni 62 paragrafi (6) të këtij ligji dhe planin afarist (projekt teknik me përshkrimin e pajisjes ekzistuese dhe të planifikuar të studios, veçanërisht në segmentin e produksionit dhe të dhënave për strukturën ekzistuese dhe të planifikuar kadrovike),
- dëshmi se kandidati nuk është në falimentim dhe/apo në proces të likuidimit të lëshuar nga organi kompetent i shtetit domicil apo deklaratë e kandidatit se nuk është në falimentim dhe/ose në proces të likuidimit të verifikuar në noter,
- dokument përkatës si dëshmi se kandidatit nuk i është shqiptuar masë e sigurisë-ndalim për kryerje të veprimtarisë nga regjistri apo evidenca, apo deklaratë e kandidatit se nuk i është shqiptuar masë e sigurisë - ndalim për kryerje të veprimtarisë të verifikuar në noter,
- raport për bilancin e gjendjes dhe të dhëna nga bilanci i suksesit të vërtetuara nga Regjistri Qendror për dy vitet e fundit, përkatësisht për personin e huaj juridik, raport të revizorit të lëshuar nga institucioni i huaj me renome i regjistruar për kryerjen e revizionit dhe i cili duhet të përmbajë të dhëna për punën e përgjithshme ekonomike të siguruesit të huaj në dy vitet e fundit,
- dokumente që e garantojnë financimin e planit afarist, përkatësisht të veprimtarisë,
- deklaratë të verifikuar në noter se do t'i respektojë karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar në vendimin për shpalljen e konkursit publik, e të caktuara nga Agjencia për Komunikime Elektronike në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike dhe rregullat e miratuara në bazë të tij,
- deklaratë të verifikuar në noter se do t'i respektojë kushtet e ofruara teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike, si dhe obligimet në planin e ofruar afarist,
- deklaratë të verifikuar në noter se nuk i shkel dispozitat e Kapitullit IV të këtij ligji,
- deklaratë të verifikuar në noter se i pranon kushtet e theksuara në dokumentacionin e konkursit,
- deklaratë të verifikuar në noter se nuk ekziston konflikt interesash në pajtim me Ligjin për parandalim të konfliktit të interesave dhe
- të dhëna dhe dokumente tjera që parashtruesi i konsideron të dobishme gjatë vendosjes për dhënien e lejes.

Neni 74

Kriteret për vlerësim

- (1) Agjencia i vlerëson fletëparaqitjet në bazë të kriterëve, si vijojnë:
- përfaqësimi i paraparë i programit të prodhuar nga vetë radiodifuzeri (in-house production) dhe produksioni i veprave audio ose audiovizuele maqedonase.
 - cilësia, llojllojshmëria e zhanreve dhe tematike e përmbajtjeve, me çfarë do të jepet kontribut për llojllojshmëri më të madh dhe pluralizëm në tregun maqedonas,
 - përfaqësimi i programeve me të cilat nxitet zhvillimi dhe ruajtja e kulturës nacionale,
 - përfaqësimi i paraparë i programeve nga producentët e pavarur dhe veprave audiovizuele evropiane,
 - kushtet teknike për prodhim të programeve,
 - kushtet hapësinore për kryerje të veprimtarisë,
 - numri dhe struktura e të punësuarve të nevojshëm për kryerje të veprimtarisë,
 - aftësia financiare për realizimin e veprimtarisë për kohën për të cilën jepet leja dhe garancitë e ofruara,
 - afati i ofruar i fillimit me kryerjen e veprimtarisë dhe
 - koha e ofruar e emetimit ditor.

(2) Nëse leja ka të bëjë me emetimin televiziv apo të radios në nivel rajonal dhe lokal, përveç kriterëve nga paragrafi (1) i këtij neni, kriter shtesë është përfaqësimi i ofruar i programeve që do

të trajtojnë ngjarje, informata dhe përmbajtje tjera me rëndësi për zonën në të cilën do të emetohet programi.

(3) Agjencia në vendimin për shpalljen e konkursit publik për dhënie të lejes për emetim televiziv apo të radios nga neni 71 i këtij ligji, e përcakton mënyrën e ndarjes së pikëve të kriterëve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, me ç'rast kriterëve nga paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 3 duhet t'u jepen pjesa më e madhe e numrit të përgjithshëm të pikëve.

Neni 75

Vendimi për dhënien e lejes

(1) Konkursi publik për dhënie të lejes për emetim televiziv apo të radios është i suksesshëm nëse pranohet së paku një fletëparaqitje e cila i plotëson kushtet e përcaktuara në konkurs.

(2) Para miratimit të vendimit për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios, Agjencia mund të këmbëjë informata me kandidatët për sqarim të pjesëve të caktuara nga oferta e tyre në mënyrën e përcaktuar në Rregulloren për punë të Agjencisë.

(3) Vendimi për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios me arsyetim të hollësishëm shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

(4) Vendimi nga paragrafi (3) i këtij neni, sidomos duhet të përmbajë:

- arsyetim për shkaqet për zgjedhjen e kandidatit,
- të dhëna për kandidatin më të volitshëm të zgjedhur,
- veprimtarinë (radio/televizion),
- nivelin e shikueshmërisë/dëgjueshmërisë (shtetëror, rajonal apo lokal),
- zonën (-at) në të cilën do të kryhet veprimtaria,
- mënyrën e emetimit të servisit programor (radiofrekuencën, kapacitetin e multipleksit terestrial digjital),
- periudhën e vlefshmërisë së lejes,
- mënyrën e përlllogaritjes dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për leje,
- formatin e servisit programor,
- afatin e fillimit me kryerjen e veprimtarisë dhe
- pasojat për mosrespektimin e afatit për fillimin me kryerjen e veprimtarisë dhe
- udhëzimin për mjetin juridik.

(5) Vendimi nga paragrafi (3) i këtij neni mund të përmbajë edhe të dhëna tjera në pajtim me dokumentacionin e konkursit publik, ofertën e parashtruar si dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të tij.

(6) Vendimin nga paragrafi (3) i këtij neni, Agjencia detyrohet t'ua dorëzojë të gjithë pjesëmarrësve në konkurs në afat prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të tij.

(7) Vendimi nga paragrafi (3) i këtij neni është përfundimtar, kurse pjesëmarrësit në konkurs që nuk janë të kënaqur nga vendimi kanë të drejtë që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij të parashtrorjnë padi te gjykata kompetente. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Neni 76

Dhënia e lejes pa shpallje të konkursit publik

(1) Për dhënien e lejes për emetim televiziv apo të radios përmes rrjetit komunikues elektronik publik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar apo përmes satelitit, nuk shpallet konkurs publik dhe leja jepet me kërkesë të palës së interesuar në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me këtë ligj.

(2) Lejen nga paragrafi (1) i këtij neni e jep Agjencia.

(3) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni, sidomos, duhet të përmbajë:

- emrin dhe mbiemrin, adresën, faksin, e-mailin dhe aktin për shtetësi të kërkuesit apo firmën dhe selinë e personit juridik nëse kërkuesi është person juridik,

- natyrën dhe vëllimin e pjesëmarrjes që do ta ketë kërkuesi në strukturën pronësore të radiodifuzerit dhe pjesëmarrjen e tij në strukturën pronësore në radiodifuzerët tjerë nëse e ka,

- emrin apo titullin dhe numrin amë apo tatimor të personave tjerë fizikë apo juridikë që do të marrin pjesë në strukturën pronësore të radiodifuzerit dhe pjesëmarrjen e tyre në radiodifuzerët tjerë, nëse i ka,

- të dhëna për personat tjerë juridikë dhe fizikë që do të mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në politiken redaktuese të radiodifuzerit, nga aspekti i personave të lidhur sipas këtij ligji,

- selinë ku do të jetë radiodifuzeri si dhe selinë ku do të miratohen vendimet redaktuese,

- veprimtarinë (radio / televizion),

- nivelin, përkatësisht zonën e shikueshmërisë, përkatësisht dëgjueshmërisë në të cilën do të kryhet veprimtaria,

- mjetin teknik për emetim (rrjet komunikues elektronik publik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar apo satelit dhe

- afatin e fillimit me kryerjen e veprimtarisë.

(4) Me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet edhe paramarrëveshje për emetim të servisit programor, të verifikuar në noter, e lidhur me operatorin e rrjetit komunikues elektronik publik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar apo me operatorin e satelitit, si dhe dokumentacioni i caktuar në nenin 73 paragrafi (3) i këtij ligji.

(5) Formularin e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, e harton Agjencia dhe ai publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

(6) Nëse kërkesa nuk i përmban të dhënat nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, Agjencia në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës do ta njoftojë për këtë kërkuesin dhe do ta detyrojë që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit ta kompletojë kërkesën.

(7) Agjencia do ta miratojë vendimin për dhënien e lejes nga paragrafi (1) të këtij neni në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të kërkesës së rregullt, nëse përcakton se kërkuesi i plotëson kushtet dhe obligimet e përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij dhe nëse kërkuesit nuk i është hequr leja për emetim televiziv apo të radios në pesë vitet e fundit.

(8) Para se ta miratojë vendimin nga paragrafi (7) i këtij neni, Agjencia mund të kërkojë nga kërkuesi sqarim të pjesëve të caktuara nga kërkesa dhe dokumentacioni nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, në mënyrën e përcaktuar në Rregulloren për punë të Agjencisë.

(9) Agjencia, vendimin për ndarjen e lejes do ta publikojë në ueb faqen e vet.

Neni 77

Dhënia e lejes për emetim televiziv apo të radios

(1) Pas pranimit të vendimit për ndarjen e lejes për emetim televiziv ose të radios nga nenet 75 ose 76 të këtij ligji, kandidati i zgjedhur më i volitshëm, përkatësisht kërkuesi për ndarjen e lejes pa shpallje të konkursit publik duhet të regjistrohet në regjistrin përkatës si shoqëri tregtare radiodifuzive ose institucion radiodifuziv joprofitabil.

(2) Agjencia do ta japë lejen për emetim televiziv ose të radios në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të regjistrimit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Agjencia për Komunikime Elektronike në bazë të lejes për emetim të radios me shfrytëzimin e radiofrekuencave jep pëlqim për shfrytëzimin e radiofrekuencave në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike.

(4) Agjencia detyrohet që në afat prej 5 ditësh nga dita e lëshimit të lejes për emetim përmes kapacitetit transmetues të multipleksit digjital terestrial, ose përmes rrjetit komunikues publik elektronik, me shkrim ta njoftojë operatorin përmes të cilit do të emetohet servisi programor.

(5) Operatori i multipleksit digjital terestrial, do të lidh marrëveshje me radiodifuzerin i cili nga Agjencia ka marrë leje për emetim televiziv ose të radios, për emetim të servisit të tij programor, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (4) i këtij neni, në pajtim me dispozitat e Ligjit për komunikime elektronike të cilat kanë të bëjnë me emetimin përmes sistemit digjital terestrial.

(6) Operatori i rrjetit komunikues elektronik publik i cili nuk i cili nuk shfrytëzon resurs të kufizuar, do të lidh marrëveshje me rediodifuzerin i cili nga Agjencia ka marrë leje për emetim televiziv apo të radios, për emetim të servisit të tij programor në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (4) i këtij neni, duke i respektuar parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit. Radiodifuzerët janë të obliguar që marrëveshjet e lidhura t'i dorëzojnë në Agjenci në afat prej 15 ditësh nga dita e lidhjes së tyre.

(7) Nëse palët nga paragrafët (5) dhe (6) të këtij neni, nuk arrijnë marrëveshje në afatin e përcaktuar, Agjencia për Komunikime Elektronike me kërkesë të njëres prej palëve ngrit procedurë për zgjidhjen e kontestit në pajtim me dispozitat e Ligjit për komunikime elektronike.

Neni 78

Përmbajtja e lejes për emetim televiziv ose të radios

(1) Leja për emetim televiziv ose të radios nga neni 77 paragrafi (2) i këtij ligji përmban:

- të dhëna për bartësin e lejes,
- mënyrën e emetimit të servisit programor (radiofrekuenca, multipleks digjital terestrial, satelit ose rrjet elektronik komunikues publik),
- nivelin e shikueshmërisë/dëgjueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal),
- zonën (-at) në të cilën do të kryhet veprimtaria, të dhëna të hollësishme për strukturën pronësore në pajtim me këtë ligj,
- shenjën e identifikimit,
- konceptin programor,
- datën e fillimit me kryerjen e veprimtarisë të përcaktuar në fletëparaqitjen e kandidatit përkatësisht në kërkesën për marrjen e lejes,
- periudhën e vlefshmërisë së lejes dhe
- mënyrën e përlllogaritjes dhe mënyrën e pagimit të kompensimeve.

(2) Në lejen për emetim televiziv ose të radios në nenin 77 paragrafi (2) të këtij ligji duhet të theksohet se poseduesi i lejes detyrohet të punojë në pajtim me këtë ligj, rregullat e miratuara në bazë të tij si dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në leje.

Neni 79

Kohëzgjatja e lejes për emetim televiziv ose të radios

(1) Leja për emetim televiziv ose të radios të shoqërive tregtare radiodifuzive dhe të institucioneve joprofitabile radiodifuzive u ndahet për periudhë kohore prej nëntë vjetëve me mundësi për vazhdimin e të njëjtës.

(2) Leja për emetim televiziv ose të radios mund të vazhdohet me kërkesë të bartësit për kohë prej nëntë vitesh. Kërkesa dorëzohet në Agjenci në afat jo më të gjatë se gjashtë muaj para skadimit të vlefshmërisë së lejes dhe e njëjta vazhdohet me vendim të Këshillit në afat jo më të gjatë se 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

(3) Gjatë shqyrtimit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia duhet ta ketë parasysh kontributin e radiodifuzerit për llojllojshmëri më të madhe dhe pluralizëm në tregun maqedonas.

(4) Leja për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive nuk mund t'i bartet personit tjetër.

(5) Kundër vendimit të Këshillit me të cilin refuzohet kërkesa për vazhdimin e lejes, poseduesi ka të drejtë që të paraqesë padi në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Neni 80

Kompensimi për lejen për emetim televiziv ose të radios

(1) Për lejen për emetim televiziv ose të radios, radiodifuzerët me përfshirje të servisit publik radiodifuziv paguajnë kompensim vjetor në llogari të Agjencisë në pajtim me këtë ligj.

(2) Lartësia e kompensimit për lejen përcaktohet në bazë të formulës si vijon: $((N \times BPV / 200.000) \times Rt \times Kp) + A$, ku:

N - është numri i përgjithshëm i popullsisë në zonën e paraparë me lejen, e paraqitur si pikë, sipas të dhënave të fundit nga Enti Shtetëror i Statistikës;

BPV - është prodhimi bruto vendor për banor, i shprehur në euro, e i paraqitur si pikë, sipas të dhënave të fundit të Entit Shtetëror të Statistikës;

Pt - është koeficienti , ku për program televiziv është $Pt=1$, ndërsa për program të radios është $Pt=1/4$;

Kp - është koeficienti i cili varësisht nga formati i servisit radiodifuziv është:

- për program të shoqërisë tregtare radiodifuzive që përfshin programe informative, artistike, dokumentare, arsimore, programe nga sfera e kulturës, artit dhe shkencave humanitare, sportive, muzikore dhe programe argëtuese është prej 0,75 deri 1,

- për programe të specializuara të shoqërisë tregtare radiodifuzive përmbajtjet e të cilave janë nga lloji i njëjtë (sportive, muzikore, kulturore, arsimore etj.) është prej 1,15 deri 1,5,

- për programe të shoqërisë tregtare radiodifuzive të dedikuara për teleshopping është 2,5 dhe

- për program të institucionit joprofitabil radiodifuziv është 0,25 dhe

A - është konstanta e cila është 100 pikë për radio dhe 200 pikë për televizion.

(3) Vlera e një pike është 1 euro llogaritur në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të euros sipas Bankës Botërore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagimit.

(4) Mënyrën e përlllogaritjes, faturimit dhe arkëtimit të kompensimit për lejen për emetim televiziv dhe të radios i përcakton Agjencia në bazë të formulës së lartpërmendur me akt nënligjor. Lartësinë e kompensimit për lejen për emetim televiziv ose të radios Agjencia e kumton në fillim të vitit kalendarik pas marrjes së të dhënave nga Enti Shtetëror i Statistikës.

(5) Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit rrjedhës duke filluar nga data e ndarjes së lejes për emetim televiziv ose të radios në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së lëshuar nga Agjencia.

(6) Kompensimet që janë paguar për vitin në të cilin radiodifuzerëve u është hequr leja për emetim televiziv ose të radios përkatësisht për vitin në të cilin është ndërprerë vlefshmëria e saj nuk kthehen.

Neni 81

Kompensimi për shfrytëzim të radiofrekuencave

Për shfrytëzim të radiofrekuencave paguhet kompensim vjetor në llogari të Agjencisë për Komunikime Elektronike në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike.

Neni 82

Heqja e lejes për emetim televiziv ose të radios

Agjencia do t'ia marrë lejen për emetim televiziv ose të radios para skadimit të afatit për të cilin është lëshuar dhe do ta shlyejë radiodifuzerin nga regjistri i radiodifuzerëve në rastet në vijim, pas njoftimit të dorëzuar paraprakisht me shkrim, nëse:

- poseduesi i lejes nuk fillon me kryerjen e veprimtarisë në afat të përcaktuar me lejen,
- poseduesi i lejes e ka ndërprerë emetimin e servisit programor më shumë se 30 ditë për shkaqe teknike, financiare ose shkaqe tjera,
- nëse poseduesi i lejes më gjatë se 30 ditë nga dita e fillimit të kryerjes së veprimtarisë, të përcaktuar në leje, nuk i ka plotësuar kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike që i ka ofruar në procedurën për ndarjen e lejes, e në bazë të mbikëqyrjes profesionale të kryer në pajtim me nenin 30 të këtij ligji,
- poseduesi i lejes ka dhënë të dhëna të pasakta të cilat kanë qenë të rëndësishme për miratimin e vendimit për ndarje të lejes,
- pas dhënies së lejes krijohen rrethana që paraqesin pengesa ligjore për poseduesin e lejes që ta kryejë veprimtarinë,
- poseduesi i lejes nuk e paguan kompensimin në afatin e përcaktuar ligjor,
- nëse nuk mënjanohet koncentrimi i palejuar mediatik në pajtim me këtë ligj dhe
- nëse radiodifuzerit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor i është ndaluar kryerja e veprimtarisë.

Neni 83

Procedura për heqjen e lejes

(1) Këshilli ngrit procedurë për heqjen e lejes për emetim televiziv ose të radios me propozim të drejtorit të Agjencisë.

(2) Propozimi nga paragrafi (1) i këtij neni, dorëzohet te të gjithë anëtarët e Këshillit në formë me shkrim me arsyetim të hollësishëm për shkaqet për heqje të lejes, e në pajtim me rastet nga neni 82 i këtij ligji.

(3) Këshilli detyrohet që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit nga paragrafi (1) i këtij neni, të miratojë vendim me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

(4) Nëse Këshilli miraton vendim për heqjen e lejes, ai doemos duhet të jetë i arsyetuar dhe i shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", në ueb faqen e Agjencisë dhe në së paku dy gazeta ditore prej të cilave njëra gazetë ditore është në gjuhën e bashkësive që nuk është shumicë, e që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

Neni 84

E drejta e mbrojtjes gjyqësore kundër vendimit për heqjen e lejes

(1) Vendimi për heqjen e lejes për emetim televiziv ose të radios është përfundimtar, e kundër tij, poseduesi i lejes ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të tij.

(2) Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Neni 85

Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes me fuqi të ligjit

(1) Leja për emetim televiziv ose të radios pushon të vlejë me fuqi të ligjit në rastet në vijim:

- me skadimin e afatit për të cilin është ndarë,
- me deklaratë me shkrim të poseduesit me të cilën njoftohet Agjencia se e ndërpret emetimin e programit televizionit dhe të radios,
- nëse poseduesi i lejes ka pushuar të ekzistojë,
- me heqjen e lejes nga Agjencia,
- nëse ndodh falimentim i poseduesit të lejes ose
- nëse ndodh likuidim i poseduesit të lejes.

(2) Për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes për emetim televiziv ose të radios me fuqi të ligjit, Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do ta shlyejë radiodifuzerin nga regjistri i radiodifuzerëve, nëse leja i ka pushuar të vlejë në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 86

Falimentimi ose likuidimi i shoqërisë radiodifuzive tregtare

(1) Mbi shoqërinë tregtare radiodifuzive mund të zbatohet procedurë për likuidim ose të hapet procedurë falimentuese në pajtim me ligj.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk ka të bëjë me servisin radiodifuziv.

V.3.3. Parimet programore, të drejtat dhe obligimet

Neni 87

Ngjarjet me të drejta ekskluzive për emetim

(1) Radiodifuzeri në bazë të të drejtave të marra ekskluzive detyrohet që të emetojë ngjarje për cilat konsiderohet se janë me rëndësi të madhe për shoqërinë, në mënyrë me të cilën së paku 80% të publikut në Republikën e Maqedonisë do t'u mundësojë ndjekje të ngjarjeve të tilla përmes emetimit të drejtpërdrejt ose të prolonguar të televizionit me qasje të lirë (televizion falas) të përcaktuar në vendimin nga neni 88 i këtij ligji.

(2) Radiodifuzerët nuk guxojnë që t'i shfrytëzojnë të drejtat ekskluzive për emetim të ngjarjeve me rëndësi të madhe për shoqërinë në mënyrë me të cilën publiku në shtetet tjera do të pamundësohet që ta ndjek ngjarjen që ai vend e ka paraqitur si ngjarje me rëndësi të madhe.

Neni 88

Përcaktimi i listës së ngjarjeve me rëndësi të madhe

(1) Këshilli miraton vendim me të cilin përcaktohet lista e ngjarjeve (nacionale ose ndërkombëtare) për të cilat konsideron se janë me rëndësi të madhe për shoqërinë dhe me këtë rast përcakton nëse ato ngjarje duhet të jenë plotësisht ose pjesërisht të arritshme për transmetim të drejtpërdrejtë ose aty ku kjo është e domosdoshme ose e përshtatshme për interesin publik, e për shkaqe objektive, në tërësi ose pjesërisht të arritshme përmes transmetimit të prolonguar. Vendimi duhet të përmbajë edhe të dhëna plotësuese për atë që duhet të bëjnë radiodifuzerët e interesuar që të respektohet lista e ngjarjeve me rëndësi të madhe e përcaktuar në shtete tjera.

(2) Agjencia detyrohet për vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, ta njoftojë Komisionin Evropian dhe Komitetin për Televizion Tejkufitar të Këshillit të Evropës.

(3) Vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, Këshilli detyrohet që ta miratojë me kohë dhe në mënyrë të qartë dhe transparente në pajtim me nenin 10 të këtij ligji.

Neni 89

E drejta e njoftimit të shkurtër

(1) Çdo radiodifuzer, në kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, ka të drejtë për njoftim të shkurtër për ngjarje për të cilat ekziston interes i madh tek publiku për të cilat të drejtat ekskluzive i ka radiodifuzeri nga Republika e Maqedonisë.

(2) Nëse radiodifuzeri nga Republika e Maqedonisë nuk ka të drejta ekskluzive për emetim të ngjarjes për të cilat ekziston rrezik i lartë tek publiku, qasja në informatat për ngjarjen sigurohet nga radiodifuzeri tjetër nga Republika e Maqedonisë i cili i ka të drejtat ekskluzive. Kushtet duhet të kumtohen me kohë para ndodhjes së ngjarjes për të cilën ekziston interes i madh tek publiku që t'u jepet kohë e mjaftueshme radiodifuzerëve të tjerë për shfrytëzimin e të drejtës së tillë.

(3) Agjencia e garanton qasjen në ngjarjet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni në atë mënyrë që radiodifuzerit i mundëson zgjidhje të lirë për inserte të shkurtra nga sinjali transmetues i radiodifuzerit tjetër me së paku shënim të burimit të tyre. Mënyrën për qasje në sinjalin transmetues e përcakton Agjencia, në bazë të mendimit të marrë paraprakisht nga Agjencia për Komunikime Elektronike.

(4) Radiodifuzeri mundet, në vend të qasjes në sinjalin transmetues nga paragrafi (3) i këtij neni, të realizojë qasje në ngjarjet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni dhe me praninë në vendin e ngjarjeve të tilla për incizim të insertit të shkurtër ose me shfrytëzimin e materialit të incizuar nga radiodifuzeri i cili ka të drejta ekskluzive për transmetimin e ngjarjes për të cilën ekziston interes i lartë tek publiku.

(5) Njoftim i shkurtër sipas këtij neni, konsiderohet njoftimi në kohëzgjatje prej më së shumti një minutë e gjysmë. Njoftimet e shkurtra shfrytëzohen vetëm në lajme dhe në magazina sportive, të cilat nuk mund të përbëhen vetëm nga njoftimet e shkurtra të radiodifuzerit, e në shërbimet mediatike audiovizuale me kërkesë mund të shfrytëzohen vetëm nëse radiodifuzeri është dhënësi i shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë dhe nëse ato i ofron me periudhë të prolonguar kohore.

(6) Radiodifuzeri i cili emeton ngjarje për të cilën ka interes të lartë tek publiku, mundet, nga radiodifuzeri i cili kërkon qasje, t'i kërkojë vetëm pagim të shpenzimeve reale të cilat i ka pasur për sigurimin e obligimit për qasje. Kompensimi i paraparë nuk guxon t'i tejkalojë shpenzimet plotësuese të shkaktuara drejtpërdrejt me mundësimin e qasjes.

(7) E drejta e njoftimit të shkurtër doemos duhet të realizohet në mënyrë që nuk do të ndikojë në rrjedhën e ngjarjeve.

(8) Kur ngjarja për të cilën ekziston interes i lartë tek publiku përbëhet nga më shumë ngjarje të pavarura organizative, çdo ngjarje e veçantë në aspekt të realizimit të së drejtës për njoftim të shkurtër do të llogaritet ngjarje për të cilën ekziston interes i lartë tek publiku.

(9) Kur ngjarja për të cilën ekziston interes i lartë tek publiku zgjatë dy ose më shumë ditë, radiodifuzeri ka të drejtë që çdo ditë të sigurojë një njoftim të shkurtër për atë ngjarje.

(10) Radiodifuzeri i cili e ka shfrytëzuar të drejtën e njoftimit të shkurtër doemos duhet t'i mundësojë shfrytëzim të njëhershëm të incizimit radiodifuzerit tjetër i cili ngjarjen nuk ka mundur ta incizojë, dhe ka të drejtë të kërkojë kompensim për pjesë në përpjesëtim, përkatësisht proporcionale të shpenzimeve reale, si dhe theksimin e emrit të tij në shpallje.

V. 3.4. Standarde programore

Neni 90

Kohëzgjatja e emetimit ditor te radiodifuzerët

(1) Radiodifuzerët që kryejnë veprimtari në nivel shtetëror, janë të obliguar që të emetojnë së paku 18 orë në ditë program të radios dhe së paku 12 orë në ditë program të televizionit.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, serviset programore plotësuese të Servisit publik radiodifuziv, të përcaktuara në nenin 107 paragrafi (5) të këtij ligji mund të emetojnë edhe numër më të vogël të orëve program në ditë.

(3) Radiodifuzerët që kryejnë veprimtari në nivel rajonal, janë të obliguar që të emetojnë së paku 12 orë në ditë program në radio dhe së paku 8 orë në ditë program televiziv.

(4) Radiodifuzerët që kryejnë veprimtari në nivel lokal, janë të obliguar që të emetojnë së paku 10 orë në ditë programit në radio dhe së paku 6 orë në ditë program televiziv.

(5) Institucionet radiodifuzive joprofitabile janë të obliguar që të emetojnë së paku 4 orë në ditë program në radio.

(6) Në programin ditor nuk llogaritet emetimi i fotografive të palëvizshme, test-sinjaleve dhe llojeve tjera të materialit audio dhe audiovizuel, që nuk janë përfshirë me definicionet për program audio dhe për programin audiovizuel nga neni 3 i këtij ligji.

Neni 91

Obligimet e radiodifuzerëve për emetim të veprave evropiane dhe veprave nga producentë të pavarur

(1) Radiodifuzerët televizivë të cilët emetojnë servise televizive programore në nivel shtetëror, atëherë kur kjo është e realizueshme dhe me mjete përkatëse duhet të sigurojnë së paku 51% nga programet e përgjithshme të emituara gjatë vitit të jenë vepra audiovizuele evropiane, me ç'rast nuk llogaritet koha e përcaktuar për lajme, ngjarje sportive, lojra, reklamim, teletekst dhe shërbime teleshoping.

(2) Radiodifuzerët të cilët emetojnë servise programore televizive të nivelit shtetëror janë të obliguar që nga buxheti i dedikuar për programe të ndajnë së paku 10% për Vepra evropiane audiovizuele nga producentë të pavarur, me ç'rast së paku gjysma e tyre duhet të jenë të prodhuara në pesë vitet e fundit.

(3) Obligimin nga paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij neni, radiodifuzerët duhet ta përmbushin në mënyrë progresive, në bazë të kriterëve përkatëse, në pajtim me realizimin e funksioneve mediatike (informativ, arsimor dhe argëtues).

(4) Rregullat për realizimin e obligimeve të këtij neni rregullohen me akt nënligjor që e miraton Agjencia.

(5) Si shmangie nga paragrafi (1) i këtij neni, Servisi publik radiodifuziv detyrohet që së paku në një servis televiziv programor në gjuhën maqedonase të sigurojë jo më pak se 60% nga programet e përgjithshme të emituara të jenë vepra audiovizuele evropiane.

(6) Në pjesën e veprave evropiane bëjnë pjesë edhe veprat audiovizuele me prodhimtari personale dhe veprat audiovizuele maqedonase.

(7) Përmbushja e obligimeve nga paragrafët (2) dhe (5) të këtij neni, nga Servisi publik radiodifuziv janë pjesë përbërëse e Raportit vjetor për punën e servisit publik radiodifuziv për vitin paraprak.

(8) Sigurimin e veprave audio dhe audiovizuele nga producentë të pavarur në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, servisi publik radiodifuziv e kryen në pajtim me Programin vjetor për punë të servisit publik radiodifuziv për vitin e ardhshëm.

Neni 92

Obligimet e radiodifuzerëve për emetim të muzikës dhe për programe burimore të krijuara në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën e bashkësive në Republikën e Maqedonisë

(1) Radiodifuzerët janë të obliguar që në ditë të emetojnë së paku 30% program burimor të krijuar në Republikën e Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë duke filluar nga viti 2014. Prej vitit 2015, obligimi prej 30% rritet në 40%. Prej vitit 2016, obligimi prej 40% rritet në 50%.

(2) Si shmangie nga paragrafi (1) i këtij neni, Servisi publik radiodifuziv detyrohet që në ditë të emetojnë së paku 40% program burimor të krijuar në Republikën e Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Prej vitit 2015, obligimi prej 40% rritet në 50%. Prej vitit 2016, obligimi prej 50% rritet në 60%. Sigurimi i servisit programor të Kanalit të Kuvendit përjashtohet nga këto obligime.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk kanë të bëjnë me serviset programore të formatit të specializuar.

(4) Radiodifuzerët televizivë të formatit të përgjithshëm janë të obliguar që gjatë javës të emetojnë së paku katër orë, e Servisi publik radiodifuziv së paku 14 orë muzikë vokale dhe/ose vokale instrumentale burimore në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, e cila 50% duhet të jetë argëtuese muzikë vokale dhe/ose vokale instrumentale, e 50% muzikë popullore vokale dhe/ose vokale instrumentale. Kjo dispozitë nuk ka të bëjë me Servisin publik radiodifuziv.

(5) Servisi publik radiodifuziv detyrohet që së paku në një servis programor televiziv dhe një të radios në gjuhën maqedonase dhe në servisin programor televiziv dhe të radios në gjuhët e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, në ditë të sigurojë së paku 45% nga muzika e emetuar vokale dhe vokale instrumentale burimore e krijuar në Republikën e Maqedonisë të jetë në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë. Prej vitit 2014, obligimi prej 45% rritet në 50%.

(6) Radiodifuzerët janë të obliguar që së paku gjysmën e obligimit për muzikë të përcaktuar në paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni ta realizojnë në periudhën prej orës 7,00 deri në orën 19,00.

(7) Rregullat për realizimin e obligimeve të këtij neni më hollësisht i përcakton Agjencia.

(8) Radiodifuzerët nacionalë televizivë me format të përgjithshëm janë të obliguar që në vit të prodhojnë dhe emetojnë së paku 10 orë, e Servisi publik radiodifuziv së paku 30 orë program dokumentar vendas në periudhën prej orës 7 deri në orën 19.

(9) Radiodifuzerët nacionalë televizivë me format të përgjithshëm janë të obliguar që në vit të prodhojnë dhe emetojnë së paku 20 orë, e Servisi publik radiodifuziv së paku 30 orë program artistik vendas prej orës 7 deri në orën 19.

(10) Për plotësimin e obligimeve të përcaktuara në paragrafët (8) dhe (9) të këtij neni, radiodifuzerët nacionalë televizivë kanë të drejtë kompensimi për mbulimin e shpenzimeve në lartësi prej 50% nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Mënyra e pagesës së mjeteve dhe lartësia e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve përcaktohen me akt nënligjor që e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(11) Programi dokumentar vendor nga paragrafi (8) i këtij neni dhe programi artistik vendor nga paragrafi (9) i këtij neni, konsiderohen se janë programe me interes publik për Republikën e Maqedonisë.

(12) Radiodifuzerët janë të obliguar që së paku gjysmën e përqindjes nga obligimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, ta realizojnë në periudhën prej orës 7 deri në orën 19.

(13) Radiodifuzerët e radios janë të obliguar që në ditë, të sigurojnë së paku 30% nga muzika e emetuar vokale ose vokale instrumentale, të jetë në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Prej vitit 2014, obligimi prej 30% rritet në 40%. Kjo dispozitë nuk ka të bëjë me Servisin publik radiodifuziv.

Neni 93

Shfrytëzimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik

(1) Radiodifuzerët mund të shfrytëzojnë shërbime telefonike me vlerë të shtuar, duke përfshirë edhe votimin telefonik, përveç në lajme, në program informativ dhe program arsimor, në shërbime fetare dhe predikime dhe në programe për fëmijë.

(2) Në programet e institucioneve radiodifuzive joprofitabile nuk lejohet shfrytëzimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar.

(3) Rregullat për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar në lloje të tjera të programeve, i përcakton Agjencia.

Neni 94

Emetimi i lojërave të fatit

(1) Radiodifuzerët mund të emetojnë lojra të fatit të organizuara vetëm nga subjektet me licencë nga organi kompetent shtetëror për organizimin e lojërave të fatit.

(2) Servisi publik radiodifuziv në programet e veta nuk mund të organizojë dhe të emetojë lojëra të fatit me vënie bast në gara sportive.

Neni 95

Lidhja në sistemin unik

(1) Radiodifuzerët që kryejnë veprimtari në nivel lokal mund të lidhen në sistem unik për emetim të programit të përbashkët, vetëm pas njoftimit të dorëzuar paraprakisht në Agjenci, por jo më gjatë se 4 orë gjatë 24 orëve.

(2) Radiodifuzerët që lidhen në sistem unik për emetim të programit të përbashkët janë të obliguar që ta njoftojnë Agjencinë për konceptin programor për program të përbashkët dhe të emërojnë redaktor përgjegjës të programit.

Neni 96

Ndjekja e fushatës zgjedhore

(1) Gjatë fushatës zgjedhore radiodifuzerët janë të obliguar që t'i respektojnë rregullat me të cilat rregullohen zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë.

(2) Agjencia kryen aktivitete të lidhura me zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë në pajtim me rregullat me të cilat rregullohen zgjedhjet në Republikën e Maqedonisë.

Neni 97

Identifikimi i radiodifuzerit

(1) Radiodifuzeri duhet të ketë shenjën e vet për identifikim.

(2) Shenja për identifikim të radiodifuzerit, doemos duhet të jetë në kontinuitet e shfaqur gjatë emetimit të programit televiziv, përkatësisht të emetohen së paku njëherë gjatë një ore reale në program të radios.

(3) Në rastet kur radiodifuzeri emeton program në sistemin unik, gjatë kohëzgjatjes së atij programi ata, gjithashtu, janë të obliguar që t'i shfaqin shenjat e identifikimit.

(4) Radiodifuzeri nuk mund të përdor shenjë për identifikim të ndryshme nga ajo që është e përcaktuar në lejen për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive.

(5) Radiodifuzeri për çdo ndryshim të shenjës për identifikim, detyrohet të dorëzojë ekzemplar nga ajo në Agjenci.

V 3.5. Reklamimi dhe teleshopingu

Neni 98

Kushtet për reklamim dhe teleshopingu

(1) Reklamimi dhe teleshopingu duhet të jenë qartësisht të identifikueshme dhe të veçuara nga pjesët tjera të programit. Që të mos pengohet përdorimi i teknikave të reja reklamuese, përveç se me mjete optike dhe/ose akustike, reklamimi dhe teleshopingu mund të veçohen nga pjesët tjera të programit edhe me mjete hapësinore.

(2) Rregullat për teknikat e reja reklamuese, i përcakton Agjencia.

Neni 99

Mënyra e reklamimit dhe teleshopingu

(1) Reklamimi dhe spote teleshopingu sipas rregullës emetohen në blloqe të futura ndërmjet programeve. Spote të izoluara reklamuese dhe spote teleshopingu përveç atyre në transmetime të ngjarjeve sportive duhet të jetë përjashtim.

(2) Dritare teleshopingu doemos duhet të jenë të shënuara qartë me mjete optike dhe akustike dhe të kenë kohëzgjatje të pandërprerë prej minimum 15 minutave.

(3) Nuk lejohet teleshopingu i produkteve mjekësore të cilat janë lëndë e autorizimit për marketing, si dhe e trajtimeve mjekësore.

(4) Reklamimi dhe teleshopingu nuk mund të emetohet as në programe për fëmijë kohëzgjatja e të cilave është e njëjtë apo më e shkurtër se 30 minuta.

(5) Në programet për fëmijë të cilat kanë më shumë se 30 minuta (pa kohën e ndarë për reklamim dhe teleshopingu) mund të emetohen spote reklamuese dhe/ose spote teleshopingu një herë për çdo periudhë prej 30 minutash.

(6) Nuk lejohet që të emetohet reklamim dhe teleshopingu në shërbime fetare ose në predikime.

(7) Nuk lejohet që të emetohet reklamim në programet e institucioneve radiodifuzive joprofitabile.

(8) Reklamimi dhe teleshopingu duhet të inkorporohen në programet e radiodifuzerëve ashtu që nuk do të rrezikohet integriteti dhe vlera e programit dhe të drejtat e poseduesve të së drejtave, e me këtë rast duke mbajtur llogari për pauzat e natyrshme, për kohëzgjatjen dhe për llojin e programit.

(9) Filmata televizivë dhe kinematografikë përveç filmave serikë dhe dokumentarë, si dhe lajmeve, mund të ndërpriten për emetim të spoteve reklamuese dhe/ose spoteve teleshopingu një herë për çdo periudhë të paraparë prej së paku 30 minutave.

Neni 100

Kohëzgjatja e reklamimit dhe spoteve të teleshopingu

(1) Kohëzgjatja e reklamimit dhe spoteve të teleshopingu në programet e radiodifuzerëve, përpos për servis publik të radiodifuzionit, nuk guxon të jetë më shumë se 12 minuta për një orë reale.

(2) Paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet në:

- shpallje të radiodifuzerit lidhur me programet e tij personale dhe prodhimet ndihmëse të realizuara drejtpërdrejt nga ato programe, shpallje për sponsorim dhe plasimin e prodhimeve dhe
- kumtesa me interes publik dhe apele për qëllime vullnetare që radiodifuzerët do t'i emitojnë falas dhe do t'i shënojnë si "emitime falas".

Neni 101

Ndalim për pjesëmarrje në reklama dhe teleshoping për persona të caktuar

Në reklama dhe në teleshoping nuk mund të shfaqen në mënyrë vizuale ose me zë personat të cilët rregullisht prezantojnë lajme dhe emisione informative aktuale.

Neni 102

Aktivitete informative të trupave shtetërorë

Organet shtetërore, organet e administratës shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet publike, si dhe personat juridikë me autorizime publike, nëse në buxhetin vjetor kanë paraparë mjete për informim dhe njoftim të publikut me shërbimet ose aktivitetet e veta janë të obliguar që të njëjtat t'i realizojnë në mënyrë jodiskriminuese, objektive dhe transparente në procedurën e përcaktuar me Ligin për furnizime publike.

Neni 103

Kohëzgjatja e reklamimit tek servisi publik radiodifuziv

(1) Kohëzgjatja e reklamimit të servisi radiodifuziv publik nuk mund të zgjatë më tepër se tetë minuta nga koha e transmetimit gjatë një ore reale.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) të këtij neni nuk vlejnë për:

- njoftime të radiodifuzerit në lidhje me programacionin e tij dhe prodhime ndihmëse drejtpërdrejtë të realizuara nga ato programe, njoftime për sponzorime dhe plasim të prodhimeve dhe

- njoftime me interes publik dhe apelet për qëllime humanitare që radiodifuzeri do ti transmetojë pa pagesë dhe do ti shënojnë si "transmetim pa pagesë".

(3) Servisi radiodifuziv publik për transmetimin e reklamave, mund ta ndërpresë vetëm programin e filmave, sportiv dhe argëtues.

(4) Servisit radiodifuziv publik nuk i lejohet reklamimi në periudhë prej ora 17,00 deri në ora 21,00 të serviseve programore televizive dhe nga ora 9,00 deri në ora 14,00 të serviseve programore të radios, përveç gjatë transmetimeve dhe incizimeve integrale të ndeshjeve sportive, programeve të produksionit të vet, programit tjetër të prodhuar në Republikën e Maqedonisë, manifestimeve dhe ngjarjeve kulturore me rëndësi të madhe të përcaktuara në pajtim me këtë ligj.

VI. SERVISI RADIODIFUZIV PUBLIK

Neni 104

Radiotelevizioni Maqedonas

(1) Funkcionet e servisit radiodifuziv publik në Republikën e Maqedonisë i kryen Radiotelevizioni Maqedonas (në tekstin e mëtejme RTM).

(2) Republika e Maqedonisë është themeluese e RTM-së dhe i njëjti e ka statusin e ndërmarrjes publike dhe punon në mënyrën dhe nën kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet e miratuara në bazë të tij.

(3) RTM si servis radiodifuziv publik në Republikën e Maqedonisë është i pavarur nga cilido organ shtetëror, person tjetër publik juridik ose shoqëri tregtare dhe duhet në politikën redaktuese dhe afariste të jetë i paanshëm ndaj tyre.

(4) RTM kryen veprimtari me interes publikë në fushën e radiodifuzionit në Republikën e Maqedonisë që përfshin prodhimin dhe sigurimin e programit radioteleviziv dhe servise

programore në pajtim me nenin 107 të këtij ligji nëpërmjet plotësimit të obligimeve, standardeve dhe parimeve programore në pajtim me nenet 91, 92, 110 dhe 111 të këtij ligji.

(5) RTM e ka selinë në Shkup.

(6) RTM themelon qendra rajonale të produksionit.

(7) Emri i shkurtër i Radiotelevizionit Maqedonas është RTM.

(8) Pronën dhe mjetet për punë të RTM-së, i përdor dhe me to menaxhon RTM, në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(9) Gazetarët dhe redaktorët e RTM-së, si dhe personat të cilët drejtpërdrejt janë të involvuar në prodhimin dhe produksionin e programeve në RTM nuk e kanë statusin e nëpunësve publikë.

Neni 105

Financimi i RTM-së

(1) RTM financohet nga taksa radiodifuzive, nga transmetimi i komunikimeve komerciale audio dhe audiovizuale, donacione, shitja e programit dhe shërbimeve dhe nga mjete të siguruar në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë për vitin rrjedhës, në pajtim me këtë ligj dhe Ligjin për kontroll të ndihmës shtetërore.

(2) Donacionet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxojnë të ndikojnë ose ta cenojnë pavarësinë redaktuese të RTM-së.

(3) RTM është e obliguar që për furnizimin me vepra audio dhe audiovizuale, respektivisht të përmbajtjeve programore, të lidhë marrëveshje të veçantë me siguresin e veprave audio ose audiovizuale, respektivisht të përmbajtjeve programore.

(4) Mënyra dhe procedura e realizimit të konkurseve publike, mënyra dhe procedura e furnizimit të veprave audio ose audiovizuale, respektivisht të përmbajtjeve programore dhe lidhja e marrëveshjeve rregullohen me akt të miratuar nga drejtori i RTM-së i cili duhet të sigurojë transparencë, ekonomizim, efikasitet dhe efektivitet gjatë menaxhimit me mjetet financiare të RTM-së, në pajtim me Programin vjetor për punën e RTM-së për vitin e ardhshëm, këtë ligj dhe aktet që dalin prej tij.

(5) Për arritjen dhe mbajtjen e shkallës së lartë të zhvillimit programor teknik teknologjik të servisit radiodifuziv publik mund të ndahen mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për këtë dedikim.

Neni 106

Raporti vjetor dhe programi vjetor për punën e RTM-së

(1) RTM është e obliguar që të miratojë Raport vjetor për punën e vitit të kaluar dhe Program vjetor për punën e vitit të ardhshëm.

(2) Programin vjetor për punën e vitit të ardhshëm RTM është e obliguar që ta paraqesë të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 30 tetor të vitit rrjedhës dhe i njëjti në veçanti duhet të përmbajë:

- program për punën e vitit të ardhshëm me aktivitete të planifikuara në veçanti për plotësimin e obligimeve programore të RTM-së në pajtim me këtë ligj dhe

- plan financiar për vitin e ardhshëm i cili i përmban të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara të RTM-së për vitin e ardhshëm të grupuara sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të RTM-së, si dhe investimet kapitale të parashikuara të RTM-së për vitin e ardhshëm.

(3) Në shtojcë të programit vjetor për punën e RTM-së për vitin e ardhshëm paraqitet dhe miratohet Programi vjetor për punën e RTM-së për vitin rrjedhës.

(4) Planin financiar nga paragrafi (2) alineja 2 të këtij neni e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës.

(5) Raportin vjetor për punën e vitit paraprak RTM është e obliguar që ta paraqesë te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës dhe i njëjti në veçanti duhet të përmbajë:

- raport për realizimin e programit për punën e vitit paraprak,
- raport financiar për realizimin e Planit financiar të vitit paraprak dhe Llogari vjetore me të dhëna për të ardhura, shpenzime, detyrime dhe obligime të realizuara të vitit të kaluar të grupuara sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të RTM-së dhe
- raport të revizionit nga revizori i autorizuar ndërkombëtar i pavarur dhe raport të revizorit të Entit Shtetëror për Revizion, nëse është kryer revizion prej tij, si dhe qëndrimi i RTM-së në lidhje me rezultatet e revizionit të kryer.

(6) Në shtojcë të programit vjetor për punën e RTM-së për vitin e kaluar paraqitet edhe programi vjetor i miratuar për punën e RTM-së për vitin e kaluar.

(7) Raporti vjetor për punën e vitit të kaluar dhe Programi vjetor për punën e vitit të ardhshëm publikohen në ueb faqen e RTM-së.

Neni 107

Programi dhe servise programore me interes publik që i siguron RTM-ja

(1) RTM në Republikën e Maqedonisë siguron të paktën një servis programor televiziv në gjuhën maqedonase dhe servis programor televiziv në gjuhën të cilën e flasin të paktën 20% e qytetarëve e cila është e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të bashkësive tjera joshumicë.

(2) RTM në Republikën e Maqedonisë siguron të paktën dy servise programore të radios në gjuhën maqedonase dhe një servis programore të radios në gjuhën të cilën e flasin të paktën 20% e qytetarëve e cila është e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të bashkësive tjera joshumicë.

(3) RTM siguron radioprograme të veçanta të dedikuara për vendet fqinje dhe Evropë në gjuhë të huaja.

(4) RTM-ja siguron radioprograme të veçanta të dedikuara për informimin e mërgimtarëve dhe qytetarëve të Republikës së Maqedonisë të cilët jetojnë në vendet fqinje, në Evropë dhe në kontinente tjera në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve e cila është ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të bashkësive tjera joshumicë.

(5) RTM-ja siguron të paktën një radioprogram dhe një servis programor televiziv nëpërmjet satelitit dhe/ose internetit të dedikuar për informimin e mërgimtarëve dhe qytetarëve të Republikës së Maqedonisë të cilët jetojnë në vendet fqinje, në Evropë dhe në kontinente tjera në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin të paktën 20% e qytetarëve e cila është e ndryshme nga gjuha maqedonase dhe të bashkësive tjera joshumicë.

(6) RTM siguron servis programor të Kanalit të Kuvendit, të përcaktuar me Ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(7) Përgjegjësinë programore për Kanalën e Kuvendit nga paragrafi (6) të këtij neni e ka Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

(8) RTM siguron programe të veçanta të radios dhe televizive të serviseve programore nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni në të cilat respektohen veçoritë rajonale dhe lokale të Republikës së Maqedonisë.

(9) Për numrin e serviseve programore nga paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij neni vendos Këshilli Programor i RTM-së me propozim të drejtorit të RTM-së.

Neni 108

Emetimi i servisit programor

(1) Serviset programore dhe programet e RTM-së nga neni 107 paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (6) të këtij ligji i emeton NP Radiodifuzioni Maqedonas, si operator i rrjetit komunikues publik.

(2) Serviset programore të RTM-së nga neni 107 paragrafi (5) të këtij ligji i emeton NP Radiodifuzioni Maqedonas. Nëse për shkaqe teknike ose për shkaqe tjera NP Radiodifuzioni Maqedonas nuk ka mundësi t'i emetojë këto servise programore të RTM-së, të njëjtat mund t'i emetojë operatori tjetër i rrjetit komunikues publik në bazë të marrëveshjes paraprakisht të lidhur me RTM-në pas procedurës së realizuar të furnizimit publik në pajtim me ligjin.

(3) Në mënyrë përkatëse me mjetet në disponim dhe Programin për zhvillim të RTM-së, RTM ka të drejtë t'i shfrytëzojë dhe aplikojë teknologjitë e reja në lidhje me programet dhe serviset programore të tij.

Neni 109

Shpenzime për transmetim, emetim dhe sigurimin e serviseve programore

(1) Shpenzimet të cilat i ka NP Radiodifuzioni Maqedonas për transmetim dhe emetim të serviseve programore dhe programeve të RTM-së, përveç për transmetim të serviseve programore dhe programeve nga neni 107 paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij ligji, sigurohen nga taksa radiodifuzive në pajtim me këtë ligj.

(2) Shpenzimet të cilat i ka NP Radiodifuzioni Maqedonas për transmetim dhe emetim të serviseve programore dhe programeve nga neni 107 paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(3) Shpenzimet të cilat i ka RTM për sigurimin e serviseve programore nga neni 107 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, sigurohen nga mjetet e taksës radiodifuzive, nga emetimi i komunikimeve komerciale audio dhe audiovizuele, donacione, shitje të programit dhe shërbimeve në pajtim me këtë ligj. Nëse këto mjete nuk mjaftojnë për mbulimin e plotë të shpenzimeve të përcaktuara me këtë paragraf, të njëjtat mund të sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(4) Shpenzimet të cilat i ka RTM për sigurimin e radioprogrameve nga neni 107 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(5) Shpenzimet të cilat i ka RTM për sigurimin e servisit programor nga neni 107 paragrafi (5) të këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(6) Shpenzimet të cilat i ka RTM për sigurimin e servisit programor respektivisht Kanalit të Kuvendit nga neni 107 paragrafi (6) të këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 110

Obligime të RTM-së në lidhje me programet dhe serviset programore të cilat i transmeton

RTM është e obliguar që gjatë prodhimit dhe sigurimit të serviseve të programeve të radios dhe televizive nga neni 107 të këtij ligji:

- të krijojë dhe transmetojë programe të qasshme për gjithë publikun në vend me qëllim në mënyrë aktive të kontribuojë për krijimin dhe zhvillimin e mendimit të lirë dhe informimin e publikut dhe të jetë lëvizës i proceseve demokratike në vend,

- të zhvillojë dhe planifikojë skemë programore në interes të gjithë publikut, ndërsa programet të dedikohen për të gjithë segmentet e shoqërisë pa diskriminim, duke mbajtur llogari gjatë kësaj për grupet shoqërore specifike,

- të sigurojë informim të vazhdueshëm, të vërtetë, të plotë, të pa anshëm, të drejtë dhe në kohë duke krijuar dhe transmetuar programe me cilësi të lartë për të gjitha ngjarjet me rëndësi politike, ekonomike, sociale, shëndetësore, kulturore, arsimore, shkencore, fetare, ekologjike, sportive dhe ngjarje tjera në Republikën e Maqedonisë, vendet e Evropës dhe botës,

- të promovojë dhe avancojë kulturën e dialogut publik dhe të mundësojë arenë për debat të gjerë publik lidhur me çështje me interes publik,

- të mos përfaqësojë dhe të mos mbrojë qëndrime ose interesa të partisë së caktuar politike, gupe politike, fetare dhe grupe tjera, ndërsa programet të cilat i krijon dhe transmeton të jenë të mbrojtura nga ndikimi i pushtetit, organizatave politike ose qendra tjera të fuqisë ekonomike dhe politike,

- të kontribuojë për respektimin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dinjitetin, autoritetin dhe nderin e individit, tolerancën, mirëkuptimin dhe respektimin e dallimeve, ndjenjën për paqe, drejtësi, vlera demokratike dhe institucionet, mbrojtjen e të miturve, barazi ndërmjet gjinive, zhdukjen e diskriminimit dhe përfitimet nga shoqëria civile,

- të krijojë programe të cilat kontribuojnë për kultivimin dhe avancimin e njohurive dhe kuptimin për identitetin kulturor, t'i respektojë dallimet kulturore dhe fetare dhe të nxisë kulturën e dialogut publik me qëllim të përforcohet mirëkuptimi i ndërsjellë dhe toleranca për avancimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive të ndryshme në mjedis multietnik dhe multikulturore,

- të informojë publikun në lidhje me veçoritë fetare dhe lokale dhe ngjarje në Republikën e Maqedonisë dhe të sigurojë diskutim të hapur dhe të lirë në lidhje me të gjitha çështjet me interes publik,

- të informojë, edukojë dhe transmetojë emisione për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shëndetin e njerëzve dhe mbrojtjen e konsumatorëve,

- të informojë dhe edukojë për kultura tjera, në veçanti për ato Evropiane,

- të informojë dhe të transmetojë për ngjarje që kanë të bëjnë me funksionimin e organizatave ndërkombëtare dhe institucionet e tyre, në veçanti ato anëtare e së cilave është Republika e Maqedonisë ose planifikon të jetë,

- t'i kultivojë dhe zhvillojë standardet gojore dhe gjuhësore të , të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë, si dhe të dialekteve të cilat fliten,

- t'i kultivojë, nxisë dhe zhvillojë të gjitha format e krijimtarisë vendase audio dhe audiovizuale të cilat kontribuojnë për zhvillimin e kulturës maqedonase dhe kulturës së bashkësive të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë, dhe të kontribuojë për afirmimin e tyre ndërkombëtar,

- të sigurojë prodhimin dhe emetimin e veprave maqedonase audio dhe audio vizuale të producentëve të pa varur,

- të krijojë dhe transmetojë program me cilësi të lartë me përmbajtje argëtuese të dedikuara për çdo grup moshë,

- të promovojë shkencë dhe të krijojë dhe të transmetojë emisione arsimore me cilësi të lartë në suazat e të cilave do të diseminohet e gjithë gama e përmbajtjeve me tematika nga ato fetare dhe sociale deri në shkencore dhe teknike/informatike,

- të mbështesë krijimin dhe zhvillimin e projekteve tej kufitare radio dhe televizive me marrëveshje ndërkombëtare me kompani radio dhe televizive radiodifuzive nga vendet fqinje dhe vende tjera,

- të transmetojë përmbajtje teatrale,

- të promovojë sport dhe aktivitete rekreative dhe të transmetojë ngjarje sportive nga vendi dhe jashtë në të cilat marrin pjesë ekipe kombëtare maqedonase ose sportistë si dhe sporte më pak të përfaqësuara respektivisht ngjarje sportive,

- të krijojë dhe transmetojë programe me interes kombëtar të dedikuara për parandalimin e krimit, sjelljes së papranueshme për shoqërinë dhe promovimin e sigurisë në komunitet,

- të krijojë dhe transmetojë programe të cilat kanë të bëjnë me nxitjen e sipërmarrjes dhe ekonomisë,
- të krijojë dhe transmetojë programe të cilat kanë të bëjnë me nxitjen e edukimit media,
- të transmetojë filma kinematografik, dokumentarë dhe filma tjerë,
- të planifikojë, zhvillojë, përshtatë, krijojë dhe transmetojë programe të dedikuara për persona me pengesa, persona me dëgjim dhe shikim të dëmtuar,
- të krijojë dhe transmetojë programe të dedikuara për informimin e mërgimtarëve dhe qytetarëve të Republikës së Maqedonisë të cilët nuk jetojnë në vend dhe
- të sigurojë kushte për shfrytëzim dhe zhvillim të standardeve moderne teknike - teknologjike në prodhimin e programit dhe të përpilojë plan për kalim në teknologji digjitale dhe në veçanti për kalim në televizion me përkufizim të lartë.

Neni 111 Standarde dhe parime

Gjatë produksionit ose prezantimit të programeve, gazetarët dhe redaktorët në RTM, si dhe persona të cilët drejtpërdrejtë janë të involvuar në prodhimin dhe produksionin e programeve në RTM, përveç tjerash janë të obliguar:

- t'i përmbahen parimit të së vërtetës, paanshmërisë dhe gjithëpërfshirjes së informatave,
- t'i përmbahen parimit të balancimit politik dhe pluralizmit të këndvështrimeve,
- të sigurojnë informata të paanshme, gjithëpërfshirëse dhe të rëndësishme dhe të njëjtat t'i prezantojnë qartë, pa mëdyshje dhe në mënyrën me të cilën qytetarët do të kenë mundësi lirisht të formojnë mendimin e tyre,
- të mos përfaqësojnë ose favorizojnë qëndrime ose interesa të partisë politike të caktuar, shoqatës, interes politik, religjion ose ideologji dhe në programet në mënyrë të barabartë t'i pranojnë mendimet dhe bindjet e tjerëve,
- të respektojnë privatësinë, dinjitetin, autoritetin dhe nderin e individit,
- të respektojnë parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë gjatë formulimit të informacioneve dhe programeve, përfshirë ndalimin për nxitjen e jotolerancës kulturore, etnike, religjioze, gjinore, racore, nacionale dhe forma tjera,
- t'i përmbahen parimit të pavarësisë politike dhe autonomisë së gazetarëve;
- të bëjnë dallim të qartë ndërmjet informatës, respektivisht ngjarjes dhe qëndrimit dhe
- t'i respektojnë kriteret për cilësi, profesionalizëm, vlera kulturore e kompetenca profesionale në kuptimin e standardeve profesionale më të larta të njohura të arritura nacionale dhe evropiane dhe parimeve etike për gazetari të pavarur dhe program cilësor.

Neni 112 Arkivimi i veprave audio dhe audiovizuele të RTM-së

(1) RTM është e obliguar të sigurojë arkivim afatgjatë të veprave audio dhe audiovizuele të cilat krijohen ose janë krijuar gjatë kryerjes së veprimtarisë, si pjesë e pasurisë audiovizuele të Republikës së Maqedonisë dhe të sigurojë shfrytëzimin e tyre të përhershëm me cilësi përkatëse.

(2) Veprat audio dhe audiovizuele nga paragrafi (1) i këtij neni janë të kapshme për publikun nëpërmjet pagesës së kompensimit përkatës për sigurimin e kopjes dhe dërgesës së tyre, sipas çmimit të bazuar mbi shpenzimet reale.

(3) Mënyrën e arkivimit të veprave audio dhe audiovizuele nga paragrafi (1) i këtij neni, mënyrën e qasjes te publiku dhe lartësinë e kompensimit nga paragrafi (2) të këtij neni i përcakton RTM-ja, në pajtim me Programin për zhvillimin e RTM-së.

(4) Incizimet e punës së Kuvendit, komisioneve dhe trupave të kuvendit, debateve publike dhe ngjarjeve tjera me rëndësi paraqesin lëndë të përhershme arkivore. Kopje e të njëjtave ruhet

në bibliotekën e Kuvendit dhe Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë, në gjuhën që e flet deputeti në origjinal pa përkthim. Biblioteka e Kuvendit doemos duhet të sigurojë që çdo qytetar me kërkesë me shkrim dhe kompensim të shpenzimeve të mund të shikojë dhe shfrytëzojë kopje të incizimeve.

Neni 113

Sigurimi i ndikimit të publikut

(1) RTM-ja është e obliguar që Propozim-programin për punën e vitit të ardhshëm me aktivitetet e planifikuara në veçanti për plotësimin e obligimeve programore të RTM-së në pajtim me këtë ligj dhe me Propozim - programin për zhvillimin e RTM-së, t'i publikojë në ueb faqen e saj, me qëllim që të sigurojë debat publik, respektivisht t'u mundësojë të gjitha palëve të interesuara të mund t'i shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre në lidhje me të njëjtat.

(2) Afati i kohëzgjatjes së debatit publik nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxon të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e publikimit të propozim - programeve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Komentet, vërejtjet dhe propozimet e publikut për punën e RTM-së publikohen në ueb faqen e RTM-së bashkë me përgjigjet e Këshilli Programor.

Neni 114

Statuti i RTM-së

(1) Puna, organizimi, menaxhimi dhe udhëheqja në RTM, aktet dhe procedura e miratimit të tyre, si dhe çështje tjera me rëndësi për punën e RTM-së, më afërsisht përcaktohen me Statutin e RTM-së.

(2) Statuti i RTM-së në veçanti përmban dispozita për:

- shenjën mbrojtëse të RTM-së,
- përpunimin dhe përdorimin e vulës,
- përfaqësimin e RTM-së,
- organe të RTM-së dhe kompetenca të tyre,
- strukturën organizative të RTM-së,
- mënyrën dhe kushtet e sigurimit të përgjegjësive programore,
- procedurën dhe mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së dhe të drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të RTM-së,
- aktet e përgjithshme dhe aktet tjera të RTM-së dhe procedurën e miratimit të tyre,
- sigurimin e transparencës gjatë punës së RTM-së,
- procedurën për zbatimin e konkurseve publike dhe lidhjen e marrëveshjeve të përcaktuara me këtë ligj dhe
- çështje tjera me rëndësi për aktivitetet dhe punën e RTM-së.

(3) Statuti i RTM-së shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në ueb faqen e RTM-së.

Neni 115

Organet e RTM-së

Organe të RTM-së janë:

- Këshilli Programor i RTM-së,
- Këshilli Mbikëqyrës i RTM-së dhe
- drejtori dhe zëvendësdrejtori i RTM-së

Neni 116

Këshilli Programor i RTM-së

(1) Këshilli Programor i RTM-së i mbron interesat e publikut në aspekt të përmbajtjeve programore që i emeton dhe kujdeset për realizimin e interesave, qëllimeve dhe kompetencave të RTM-së.

(2) Me qëllim që të sigurohet pavarësi redaktuese dhe gazetareske, Këshilli Programor i RTM-së nuk guxon t'i kontrollojë emisionet e caktuara ose pjesët tjera të programeve para se të njëjtat të emetohen, përkatësisht nuk mund të miratojë vendime dhe qëndrime për emetimin e tyre.

(3) Këshilli Programor i RTM-së përbëhet nga 13 anëtarë.

(4) Anëtarët e Këshillit Programor të RTM-së duhet ta paraqesin shumëllojshmërinë e shoqërisë maqedonase me përfaqësim përkatës të të dy gjinive.

(5) Këshilli Programor i RTM-së miraton Rregullore për punën e vet në pajtim me këtë ligj dhe me Statusin e RTM-së.

Neni 117

Propozues të autorizuar të anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së

(1) Anëtarët e Këshillit Programor të RTM-së i emëron dhe shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të propozuesve të autorizuar si vijon:

- Konferenca Interuniversitare propozon kandidat për një anëtar,
- Institucioni Nacional Tetari Shqiptar propozon kandidat për një anëtar,
- Institucioni Nacional Tetari Turk propozon kandidat për një anëtar,
- Shoqata shumicë e gazetarëve propozon kandidatë për dy anëtarë,
- Shoqata e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale propozon kandidatë për tre anëtarë dhe
- Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë propozon kandidatë për pesë anëtarë.

(2) Kandidatët për anëtarë të Këshillit Programor të RTM-së duhet të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë me arsim të lartë dhe duhet të jenë persona të shquar të cilët në jetën private janë të njohur për angazhimin e tyre për respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike, sundimit të së drejtës, ndërtimin dhe ngritjen e vlerave më të larta të rregullimit kushtetues në Republikën e Maqedonisë, zhvillimin e shoqërisë qytetare, mbrojtjen e të drejtave dhe lirisë së njeriut, si dhe lirisë së të shprehurit.

(3) Propozuesit e autorizuar nga paragrafi (1) alinetë 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni, i përcaktojnë propozimet nga radhët e tyre pas konkursit intern të shpallur paraprakisht.

(4) Gjatë përcaktimit të propozimeve, propozuesit e autorizuar nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet ta kenë parasysh dispozitën e nenit 116 paragrafi (4) të këtij ligji dhe duhet të mbajnë llogari për kushtet e emërimit në pajtim me nenin 119 të këtij ligji.

Neni 118

Emërimi i anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së

(1) Gjatë përcaktimit të propozimit të kandidatëve për anëtar të Këshillit Programor të RTM-së, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, mban llogari për përfaqësim të drejtë dhe adekuat të qytetarëve të të gjitha bashkësive që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

(2) Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTM-së është pesë vite me të drejtë edhe për një mandat vijues.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, së paku 60 ditë para skadimit të mandatit të Këshillit Programor të RTM-së drejton thirrje publike te propozuesit e autorizuar nga neni 128 i këtij ligji, për dorëzimin e propozimit të kandidatëve për anëtar të Këshillit Programor të RTM-së.

(4) Propozuesit e autorizuar nga neni 117 të këtij ligji janë të obliguar që propozimet t'i dorëzojnë te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e drejtimit të thirrjes publike. Në bazë të propozimeve të dorëzuara nga propozuesit e autorizuar, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, në afat prej 15 ditësh përpilon propozim për kandidatët e Këshillit Programor të RTM-së.

(5) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni 15 ditë para skadimit të mandatit të Këshillit Programor të RTM-së, do t'i emërojë anëtarët e rinj të Këshillit Programor të RTM-së.

(6) Këshilli Programor i RTM-së mund të punojë nëse janë emëruar së paku nëntë anëtarë.

Neni 119

Papajtueshmëria e dy funksioneve

(1) Anëtarët e Këshillit Programor të RTM-së nuk mund të jenë:

- deputetë, anëtarë të Qeverisë, funksionarë të zgjedhur ose të emëruar, persona udhëheqës në organin shtetëror, organin e administratës shtetërore, njësinë e vetëqeverisjes lokale ose trupa rregullatorë, drejtorë ose anëtarë të këshillave drejtues të ndërmarrjeve publike,

- persona të cilët në pesë vitet e fundit kanë qenë bartës të funksioneve publike ose kanë qenë persona udhëheqës në organin e partisë politike ose të bashkësisë fetare,

- persona të punësuar në RTM dhe persona tjerë me të cilët RTM-ja ka lidhur marrëveshje për kryerjen e punëve të caktuara;

- persona të cilët kryejnë detyrë në organet e partisë politike dhe

- personat si pronarë të pjesëmarrjeve ose aksioneve, si anëtarë të organeve të menaxhimit, ose si të punësuar, kanë interes te radiodifuzerë të tjerë, agjenci të lajmeve, shoqëri për reklama dhe propagandë, shoqëri për hulumtim të tregut dhe mendimit publik, shoqëri për distribucion filmik, shoqëri për produksion të filmit ose shoqëri që sigurojnë rrjete dhe shërbime komunikuese elektronike publike.

(2) Nëse gjatë kohës së mandatit të anëtarit të Këshillit Programor të RTM-së plotësohet ndonjë nga kushtet e paragrafit (1) të këtij neni, i njëjti është i obliguar ta njoftojë kryetarin, respektivisht zëvendëskryetarin e Këshillit Programor të RTM-së.

Neni 120

Shkarkimi i anëtarit të Këshillit Programor të RTM-së

(1) Anëtari i Këshillit Programor të RTM-së mund të shkarkohet para skadimit të afatit për të cilin është emëruar në rastet vijuese:

- krijimi i shkaqeve për të cilat një person nuk mund të emërohet si anëtar i Këshillit Programor të RTM-së, të paraparë në këtë ligj,

- nëse pa arsye mungon në tri mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit Programor të RTM-së,

- me dhënie të dorëheqjes, ose

- nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me dënim me burg më shumë se gjashtë muaj ose nëse i është shqiptuar masa e sigurisë ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

(2) Pushimin e mandatit e përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozim të Këshillit Programor të RTM-së.

(3) Për plotësimin e kushteve për pushim të mandatit të anëtarit të Këshillit Programor të RTM-së para skadimit të kohës për të cilën është emëruar të paraparë në paragrafin (1) të këtij

neni, kryetari respektivisht zëvendëskryetari i Këshillit Programor të RTM-së është i obliguar që ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat prej pesë ditësh nga dita e plotësimit të kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni. Në këtë rast zbatohet procedura e përcaktuar në nenet 117 dhe 118 të këtij ligji.

(4) Në rastet kur anëtari i Këshilli Programor i RTM-së do të shkarkohet para skadimit të afatit për të cilin është emëruar, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do të emërojë anëtar të ri të Këshillit Programor të RTM-së për pjesën tjetër të mandatit me propozim të propozuesit përkatës të autorizuar.

Neni 121

Mbledhjet e Këshillit Programor të RTM-së

(1) Këshilli Programor i RTM-së punon dhe vendos në mbledhjet të cilat mbahen së paku një herë në tre muaj dhe nëse janë prezent së paku nëntë anëtarë të tij.

(2) Mbledhjet e Këshillit Programor të RTM-së konvokohen me propozim të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit Programor të RTM-së, me kërkesë me shkrim prej së paku pesë anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së, me kërkesë të Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së ose me kërkesë të drejtorit të RTM-së.

(3) Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Programor të RTM-së e konvokon mbledhjen e Këshillit Programor të RTM-së në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se dhjetë ditë nga dita e pranimit të kërkesës për konvokimin e mbledhjes.

(4) Këshilli Programor i RTM-së me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve i zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Këshillit Programor të RTM-së. Procedura për emërimin dhe shkarkimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit rregullohet me Rregullore për punë të Këshillit Programor të RTM-së.

(5) Këshilli Programor i RTM-së vendimet i miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve prezent në mbledhje.

(6) Këshilli Programor i RTM-së për punët e përcaktuara në nenin 124 paragrafi (1) alinetë 4, 6, 7 dhe 8 të këtij ligji, vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së ku duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së që i takojnë bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 122

Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Programor të RTM-së

(1) Mbledhjet e Këshillit Programor të RTM-së janë publike.

(2) Në mbledhjet e Këshillit Programor të RTM-së, pa të drejtë për vendosje, merr pjesë kryetari ose zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së, dhe drejtori ose zëvendësdrejtori i RTM-së edhe në mbledhje, e në pajtim me rregulloren e punës së Këshillit Programor, mund të prezantojnë dhe të marrin pjesë personat e punësuar në RTM, si dhe personat e jashtëm.

(3) Rendi i ditës, procesverbalet nga mbledhjet e Këshillit Programor të RTM-së, vendimet e miratuara si dhe sqarimet e anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së gjatë procedurës së votimit për çështje të caktuara, shpallen në ueb faqen e RTM-së në afat prej shtatë ditësh nga dita e mbledhjes së mbajtur.

Neni 123

Kompensimi i anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së

(1) Për punën e vet anëtarët e Këshillit Programor të RTM-së marrin kompensim në lartësi prej një të tretës së pagës mesatare të paguar në Republikën e Maqedonisë, pas mbledhjes së përfunduar, respektivisht pas përfundimit të rendit të ditës për atë mbledhje.

(2) Anëtarët e Këshillit Programor të RTM-së të cilët jetojnë jashtë Shkupit, kanë të drejtë për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit kur marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Programor të RTM-së, në pajtim me Rregulloren për rroga dhe kompensime tjera.

(3) Kompensimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni sigurohen nga mjetet e RTM-së të përcaktuara me Planin financiar vjetor.

Neni 124

Kompetencat e Këshillit Programor të RTM-së

(1) Këshilli Programor i RTM-së i ka kompetencat si vijojnë:

- t'i përcjellë plotësimin e obligimeve programore, parimet dhe standardet e përcaktuara në këtë ligj e në rast të mosrespektimit të tyre është i obliguar me shkrim ta paralajmërojë drejtorin e RTM-së dhe mund të kërkojë nga ai ta ndërpresë emetimin e programit,

- t'i përcjellë komentet dhe sugjerimet e publikut lidhur me programin e emetuar në RTM dhe duke i pasur parasysh të njëjtat mundet në formë të shkruar të kërkojë nga drejtori i RTM-së ta përshtatë vëllimin, strukturën ose kualitetin e përgjithshëm të përmbajtjes së programit,

- të miratojë Rregulloren për punën e vet,

- t'i zgjedhë dhe shkarkojë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së,

- ta zgjedhë dhe shkarkojë drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e RTM-së,

- ta miratojë Statutin e RTM-së,

- ta miratojë Raportin vjetor të punës për vitin paraprak dhe Programin vjetor për punën e vitit të ardhshëm të RTM-së,

- ta miratojë Programin për zhvillimin e RTM-së,

- t'i miratojë Rregullat e përgjithshme për standardet profesionale dhe të programit në RTM-së dhe

- t'i miratojë aktet e përgjithshme për punën e RTM-së të përcaktuara në Statutin e RTM-së.

(2) Këshilli Programor i RTM-së jep pëlqim për emërimet ose shkarkimet e redaktorëve përgjegjës në RTM. Para se ta miratojë vendimin për emërimin ose shkarkimin e redaktorëve përgjegjës të RTM-së, drejtori i RTM-së është i obliguar që të kërkojë pëlqim nga Këshilli Programor i RTM-së. Me kërkesë për marrjen e pëlqimit, drejtori i RTM-së e parashtron edhe mendimin e redaksisë. Nëse Këshilli Programor i RTM-së nuk jep pëlqim për emërimet ose shkarkimet e redaktorëve përgjegjës në RTM, për këtë me shkrim do ta njoftojë drejtorin e RTM-së me arsyetim të hollësishëm për shkaqet për të cilat nuk është dhënë pëlqim.

Neni 125

Këshilli Mbikëqyrës i RTM-së

(1) Mbikëqyrja mbi punën financiare materiale të RTM-së e kryen Këshilli Mbikëqyrës i RTM-së i cili përbëhet prej shtatë anëtarëve.

(2) Anëtarët e Këshillin Mbikëqyrës i zgjedh Këshilli Programor i RTM-së në bazë të procedurës së zbatuar paraprakisht me konkurs publik.

(3) Kushtet dhe procedurën për zgjedhje dhe shkarkim të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së përcaktohen me Status të RTM-së.

(4) Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTM-së zgjat pesë vite, me të drejtë edhe për një mandat të radhës.

(5) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së duhet të jenë persona me arsim të lartë, të cilët posedojnë njohuri dhe së paku pesë vite përvojë nga sfera e punës financiare dhe të kontabilitetit.

(6) Këshilli Mbikëqyrës i RTM-së punon dhe vendos në mbledhjet të cilat mbahen së paku një herë muaj dhe nëse janë prezent së paku pesë anëtar të tij.

(7) Këshilli Mbikëqyrës i RTM-së nga radhët e veta i zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Këshillit Mbikëqyrës në mënyrë dhe me procedurë të përcaktuar në Rregulloren për punën e Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së.

(8) Mbledhja konvokohet me propozim të kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së, me kërkesë me shkrim prej së paku dy anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ose me kërkesë të drejtorit të RTM-së. Kryetari është i obliguar që mbledhjet t'i konvokojë në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se pesë ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës për konvokimin e mbledhjes.

(9) Këshilli Mbikëqyrës i RTM-së miraton vendime me shumicë votash nga anëtarët prezent. Nëse numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimmarrëse.

(10) Në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së, pa të drejtë për të vendosur, merr pjesë kryetari ose zëvendëskryetari i Këshillit Programor të RTM-së, dhe drejtori ose zëvendësdrejtori i RTM-së. Me ftesë të Këshillit Mbikëqyrës e në pajtim me Rregulloren për punë të Këshillit Drejtues në mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së mund të marrin pjesë edhe persona tjerë të punësuar në RTM.

Neni 126

Kompensim për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së për punën e vet marrin kompensim mujor në lartësi deri në një rrogë e gjysmë mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave të shpallura nga Enti Shtetëror për Statistikë, në pajtim me Statutin e RTM-së.

Neni 127

Papajtueshmëria e funksioneve

Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së nuk mund të jenë:

- deputetët, anëtarët e Qeverisë, funksionarë të zgjedhur ose të emëruar, personat udhëheqës në organin shtetërorë, organin e administratës shtetërore, organin e vetëqeverisjes lokale, njësinë e vetëqeverisjes lokale ose trupa rregullatorë, drejtorë ose anëtarë të këshillave drejtues të ndërmarrjeve publike,

- personat të cilët kryejnë detyrë në organet e partisë politike,

- personat të cilët, si pronarë të pjesëve ose aksioneve, si anëtarë të organeve të menaxhimit, ose si të punësuar, kanë interes të radiodifuzerë të tjerë, agjenci të lajmeve, shoqëri për reklama dhe propagandë, shoqëri për hulumtim të tregut dhe mendimit publik, shoqëri për distribuim filmik, ose të shoqërive që sigurojnë rrjete dhe shërbime komunikuese elektronike publike,

- anëtarët të Këshillit Drejtues të RTM-së, ose

- të punësuarit në RTM dhe persona të jashtëm me të cilët RTM-ja ka lidhur marrëveshje për kryerjen e punëve të caktuara.

Neni 128

Pushimi i mandatit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së

(1) Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së mund të pushojë para skadimit të afatit në rastet si vijon:

- shkaktimi i shkaqeve për shkak të të cilave një person nuk mund të zgjidhet si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së, i parapare në nenin 127 të këtij ligji;

- mungesë pa arsye në tri mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së ose në pesë mbledhje gjatë gjashtë muajve;

- me parashtrimin e dorëheqjes, ose

- nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me dënim me burg më gjatë se gjashtë muaj ose nëse i është shqiptuar masa e sigurisë ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtari ose detyrës.

(2) Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës është i obliguar me shkrim ta njoftojë Këshillin Programor të RTM-së për pushimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së, në afat prej 15 ditësh nga dita e shkaktimit të rasteve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Këshilli Programor i RTM-së do të zgjedhë anëtar të ri të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së në pajtim me nenin 125 të këtij ligji, për mandatin e mbetur të anëtarit të shkarkuar të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së.

(4) Procedurën për zgjedhjen e anëtarit të ri të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së, Këshilli Programor i RTM-së e fillon në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e shkarkimit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së.

Neni 129

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së

(1) Këshilli Mbikëqyrës i RTM-së i ka kompetencat si vijon:

- kryen mbikëqyrje mbi punën materiale financiare të RTM-së, dhe në raste të parregullsive i urdhëron drejtorit të RTM-së të njëjtën ta mënjanojë;

- i jep rekomandime, propozime ose mendime drejtorit të RTM-së për çështjet të cilat janë të natyrës financiare;

- e miraton Llogarinë Vjetore të RTM-së;

- jep pëlqim për Propozim-Statusin e RTM-s[;

- jep pëlqim për Propozim Planin Financiar të RTM-së për vitin e ardhshëm në bazë të Propozim-Programit për punën e RTM-së për vitin e ardhshëm;

- jep pëlqim për lidhjen e marrëveshjeve për hua ose kredi bankare të cilat tejkalojnë vlerë të përcaktuar me statusin e RTM-së;

- jep pëlqim për tjetërsim dhe dispozicion me pronën e RTM-së të cilat tejkalojnë vlerë të përcaktuar në Statusin e RTM-së dhe

- miraton rregullore për punën e vet.

(2) Këshilli Mbikëqyrës të RTM-së është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për pëlqim nga paragrafi (1) i këtij neni, të prononcohet lidhur me të njëjtin. Nëse Këshilli Mbikëqyrës i RTM-së nuk jep pëlqim për kërkesën e parashtruar, për këtë me shkrim do ta njoftojë drejtorin e RTM-së me arsyetim të hollësishëm për arsyet për të cilat nuk është dhënë pëlqimi.

Neni 130

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i RTM-së

(1) Drejtori i RTM-së udhëheq me punën e RTM-së dhe e përfaqëson dhe e prezanton RTM-në.

(2) Drejtori i RTM-së ka zëvendës.

(3) Si drejtor dhe zëvendësdrejtor i RTM-së mund të zgjidhet person i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe i cili do të ofrojë program më kualitativ për punën e RTM-së.

(4) Drejtori dhe zëvendës drejtori i RTM-së, përveç kushteve nga paragrafi (3) i këtij neni duhet të kenë edhe arsim të lartë edhe përvojë pune mbi pesë vite në sferën e komunikologjisë, gazetarisë, komunikimeve elektronike, informatikës, kulturës, ekonomisë dhe së drejtës.

(5) Si drejtor dhe zëvendës drejtor i RTM nuk mund të zgjidhet anëtar i Këshillit Programor të RTM-së dhe i Këshillit mbikëqyrës të RTM-së.

(6) Drejtorin dhe zëvendës drejtorin e RTM-së i zgjedh Këshilli Programor i RTM-së në bazë të procedurës së zbatuar paraprakisht në konkurs publik dhe programit të parashtruar për punën e RTM për periudhën prej tre vitesh me mundësi për zgjedhje të sërishme vijuese.

(7) Procedura për zgjedhje dhe shkarkim të drejtorit ose zëvendës drejtorit të RTM-së përcaktohet me Statutin e RTM-së.

Neni 131

Shkarkimi i drejtorit ose zëvendës drejtorit të RTM-së

(1) Drejtori ose zëvendës drejtori i RTM-së mund të shkarkohet para kalimit të mandatit të tij në këto raste:

- me kërkesë të tij,
- nëse nuk ka mundësi ta kryejë detyrën më shumë se gjashtë muaj në vazhdimësi dhe
- nuk i respekton obligimet, parimet dhe standardet programore të përcaktuara në këtë ligj dhe në Programin vjetor për punën e RTM-së dhe pas marrjes së paralajmërimit me shkrim nga Këshilli programor i RTM-së.

(2) Drejtori ose zëvendës drejtori i RTM-së kundër të cilit ka filluar procedura për shkarkim, paraprakisht njoftohet për dyshimet e mundshme dhe i mundësohet mbrojtje para Këshillit Programor të RTM-së.

(3) Vendimi për shkarkim të drejtorit ose zëvendës drejtorit të RTM-së përveç tjerave duhet t'i përmbajë arsyet për shkarkimin e tij, të arsyetuara në mënyrë të hollësishme dhe i njëjti shpallet në ueb faqen e RTM-së në afat prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të tij.

Neni 132

Kompetenca të drejtorit të RTM-së

(1) Drejtori i RTM-së i ka këto kompetenca:

- e paraqet dhe përfaqëson RTM, përgjegjës është punën e ligjshme të RTM dhe për plotësimin e obligimeve të RTM të parapara me këtë ligj;

- E propozon Statutin e RTM;

- i propozon aktet e përgjithshme për punën e RTM të përcaktuara në Statutin e RTM i propozon Rregullat e përgjithshme për standardet programore dhe profesionale në RTM, ndërsa sipas mendimit të marrë paraprakisht nga redaksitë e RTM;

- e propozon Raportin vjetor për punë për vitin paraprak dhe Programin vjetor për punë për vitin e ardhshëm të RTM dhe pas miratimit të tyre i dorëzon te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë;

- e propozon Llogarinë vjetore të RTM;

- e propozon Programin për zhvillimin e RTM;

- jep autorizime në kuadër të kompetencave të veta;

- i emëron dhe shkarkon redaktorët përgjegjës të serviseve programore, pas mendimit të marrë paraprakisht nga redaksitë e RTM-së dhe pëlqimit të marrë nga Këshilli Programor i RTM-së;

- vendos për punësime dhe sistemim të të punësuarve në RTM dhe

- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe Statutin e RTM-së.

(2) Në rast të mungesës ose pengesës nga puna të drejtorit të RTM-së punët nga paragrafi (1) të këtij neni i kryen zëvendës drejtori i RTM-së.

Neni 133

Bashkëpunimi i RTM-së

RTM mund të bashkëpunojë me servise radiodifuze publike nga shtete tjera dhe me institucione dhe trupa ndërkombëtarë nga fushëveprimi i vet i punës.

Neni 134

Harmonizimi me Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimi tjetër ndërkombëtar

RTM në punën e vet duhet t'i ketë parasysh direktivat e Bashkimit Evropian, aktet e Këshillit të Evropës, konventat ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë si dhe përvojën e serviseve radiodifuze publike nga shtete tjera e veçanërisht nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

VII. TAKSA RADIODIFUZIVE

Neni 135

Taksa radiodifuzive

(1) Mjetet për mbulimin e shpenzimeve për krijimin dhe emetimin e programeve dhe për zhvillim tekniko-teknologjik të servisit radiodifuziv publik, për qëndrueshmërinë, përdorimin dhe zhvillimin e rrjetit radiodifuziv publik dhe për punën e Agjencisë, sigurohen edhe nga taksa radiodifuzive.

(2) Taksa radiodifuzive është detyrim publik.

(3) Nga mjetet e taksës radiodifuzive në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni financohen këta shfrytëzues:

- NP Radiotelevizioni i Maqedonisë,
- NP Radiodifuzioni i Maqedonisë dhe
- Agjencia.

Neni 136

Pagesa e taksës radiodifuzive

(1) Taksë radiodifuzive paguan:

- çdo ekonomi familjare në Republikën e Maqedonisë,
- hotele dhe motele, nga një taksë radiodifuzive për çdo pesë dhoma,
- tregtarë individualë të regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare si dhe kryerës të veprimtarisë të regjistruar në pajtim me ligjin, deri në 20 të punësuar, nga një taksë radiodifuzive,

- persona juridikë dhe pronarë të lokaleve afariste, për çdo 20 të punësuar ose persona tjerë të cilët e shfrytëzojnë lokalin afarist nga një taksë radiodifuzive. Personat juridikë të cilët nuk janë të regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare, përkatësisht të cilët e marrin statusin e personit juridik në pajtim me ligje tjera, nuk kanë obligim të paguajnë taksë radiodifuzive në pajtim me këtë ligj dhe

- pronar të objekteve hoteliere dhe objekteve tjera publike të pajisura me radiomarrës ose marrës televiziv, për secilin marrës nga një taksë radiodifuzive.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Agjencisë do të caktojë se cilët obligues nga paragrafi (1) i këtij neni, në vendbanimet që nuk janë mbuluar me sinjale radiodifuzive të NP RDM-së me të cilat i transmetojnë serviset programore të RTM-së nuk do të paguajnë taksë radiodifuzive.

(3) Familja e cila ka person të verbër me shikim të dëmtuar mbi 90%, person të shurdhër me dëmtim të dëgjimit me mbi 60 decibelë ose person i cili është invalid trupor me mbi 90% invaliditet të përcaktuar në pajtim me dispozitat për sigurim invalidor, është e liruar nga pagimi i taksës radiodifuzive për banesën në të cilën jeton familja e tij.

Neni 137

Regjistri i obliguesve për pagim të taksës radiodifuzive

(1) RTM është i obliguar të mbajë Regjistër të obliguesve për pagim të taksës radiodifuzive.

(2) RTM është i obliguar që në vazhdimësi gjatë vitit ta azhurnojë Regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për azhurnim ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në Raportin Vjetor për punën e RTM-së për vitin paraprak.

(3) RTM për azhurnim efikas të Regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar që të bashkëpunojë dhe shkëmbejë informacioneve dhe të dhëna me organet dhe trupat shtetërore në Republikën e Maqedonisë të cilat disponojnë me të dhënat nga neni 136 i këtij ligji.

(4) Formën dhe përmbajtjen e regjistrin nga paragrafi (1) të këtij neni me akt i përcakton RTM, në pajtim me nenin 136 të këtij ligji.

Neni 138

Llogaritja, përcaktimi dhe pagimi i taksës radiodifuzive

(1) Puna në lidhje me llogaritjen, përcaktimin dhe pagimin e mjeteve nga taksa radiodifuzive të shfrytëzuesve nga neni 135 të këtij ligji, në emër dhe për llogari të RTM-së, i kryen Drejtoria për të Hyra Publike.

(2) Në procedurën për përcaktim dhe pagim të mjeteve nga taksa radiodifuzive zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore.

(3) Drejtoria për të Hyra Publike në bazë të të dhënave nga regjistri i obliguesve të taksës radiodifuzive e përcakton shumën mujore të taksës radiodifuzive, të cilën obliguesi është i obliguar që ta paguajë më së voni deri më 15-in në muajin e ardhshëm, në të kundërtën për çdo vonesë është i obliguar ta paguajë kamatën e përcaktuar me ligj.

(4) Arkëtimi kryhet në llogari të RTM-së e cila mjetet e paguara i drejton te shfrytëzuesit e theksuar në nenin 135 të këtij ligji, në shuma përcaktuar në nenin 140 të këtij ligji.

Neni 139

Shuma dhe mënyra e pagimit të taksës radiodifuzive

Taksa radiodifuzive paguhet çdo muaj në shumë prej 190 denarësh. Shuma ndryshohet një herë në vit varësisht nga shuma e shpenzimeve për jetë për vitin paraprak të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës.

Neni 140

Ndarja e taksës radiodifuzive

(1) Mjetet e paguara nga taksa radiodifuzive ndahen në mënyrën në vijim:

- 74,5% për RTM për mbulimin e shpenzimeve për krijim dhe transmetim të programeve dhe për zhvillim tekniko-teknologjik,

- 19,5% për NP RDM për mirëmbajtje, përdorim dhe zhvillim të rrjetit radiodifuziv publik dhe

- 6% për Agjencinë për rregullim dhe zhvillim të mediave dhe shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale.

(2) Nga mjetet e përgjithshme të paguara nga taksa radiodifuzive Drejtoria për të Hyra Publike e mban shumën në lartësi prej 3% për mbulimin e shpenzimeve për përcaktim dhe arkëtim të mjeteve nga taksa radiodifuzive.

(3) Në aspekt të arkëtimit të detyrueshëm të taksës radiodifuzive zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore.

(4) Shfrytëzuesit e mjeteve nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar që mjetet t'i shfrytëzojnë në bazë të planit financiar i cili shpallet publikisht.

VIII. RITRANSMETIMI I SERVISIT PROGRAMOR PËRMES RRJETEVE KOMUNIKUESE ELEKTRONIKE PUBLIKE

Neni 141

Ritransmetimi i servisit programor

(1) Operatori i rrjetit komunikues elektronik publik para se të fillojë me ritransmetim të servisit programor, në Agjenci dorëzon fletëparaqitje për evidentim të tij në regjistrin e operatorit që ritransmetojnë pako programore dhe regjistrim të serviseve programore të cilat do t'i ritransmetojnë si tërësi në formë të pakos programore.

(2) Fletëparaqitja nga paragrafi (1) i këtij neni në veçanti i përmban:

- firmën dhe selinë, respektivisht emrin dhe adresën e operatorit,
- emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës të operatorit,
- pakon programore, respektivisht listën e servisit programor nga radiodifuzerët të cilët operatori planifikon t'i ritransmetojë,

- mënyrën në të cilën operatori do ta sigurojë pakon programore,

- rajonin në të cilin operatori do të sigurojë pako programore (zona e servisit), dhe

- datën e fillimit me sigurimin e pakos programore.

(3) Agjencia me akte nënligjore do ta përcaktojë përmbajtjen dhe formën e fletëparaqitjes dhe vërtetimit për regjistrim. Formulari për fletëparaqitje publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

(4) Me fletëparaqitje, personi përgjegjës i operatorit dorëzon edhe deklaratë me të cilën nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale se për ritransmetim të servisit programor nga paragrafi (2) i këtij neni i ka rregulluar të drejtat autoriale dhe të ngjashme, në pajtim me ligjin për të drejta autoriale dhe të drejta të ngjashme.

(5) Nëse fletëparaqitja është jo e plotë, respektivisht nuk i përmban të dhënat e përcaktuara në paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni, Agjencia në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të fletëparaqitjes, për këtë me shkrim do ta njoftojë operatorin dhe do ta ngarkojë që në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit ta kompletojë fletëparaqitjen.

(6) Nëse operatori nuk vepron sipas njoftimit me shkrim nga paragrafi (5) i këtij neni do të llogaritet se fletëparaqitja nuk është dorëzuar.

(7) Agjencia në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të fletëparaqitjes së plotë do t'i lëshojë vërtetim për regjistrim të pakos programore operatorit.

(8) Agjencia është e obliguar që në afat prej pesë ditësh pune nga dita e lëshimit të vërtetimit nga paragrafi (7) të këtij neni, të njëjtin ta dorëzojë te Agjencia për Komunikime Elektronike.

(9) Agjencia mban regjistër të operatorëve të cilët ritransmetojnë pako programore dhe i njëjti në veçanti i përmban:

- emrin dhe adresën e operatorit,

- emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës të operatorit,

- pakon programore, respektivisht listën e serviseve programore për të cilat operatori i ka rregulluar të drejtat autoriale dhe të drejtat e ngjashme për ritransmetimin e tyre dhe

- rajonin në të cilin operatori do ta ritransmetojë servisin programor (zonën e servisit).

(10) Agjencia i publikon në ueb faqen e saj të dhënat e regjistrimit nga paragrafi (9) të këtij neni.

(11) Për ndryshimin e të dhënave të cekura në paragrafin (2) të këtij neni, operatori është i obliguar që ta njoftojë Agjencinë në afat prej 30 ditësh nga dita e shkaktimit të ndryshimit. Nëse bëhet ndryshimi i pakos programore, me iniciativë të vet ose në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor, operatori është i obliguar që të paraqesë edhe deklaratë të re nga paragrafi (4) të këtij neni. Agjencia është e obliguar që në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit të njoftimit për ndryshimin e pakos programore, për të njëjtin ta njoftojë Agjencinë për Komunikime Elektronike.

(12) Agjencia është e obliguar që në afat prej shtatë ditësh pune nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (11) i këtij neni, për ndryshimin e kryer ta evidentojë ndryshimin në regjistrin nga paragrafi (9) të këtij neni.

(13) Nëse Agjencia në bazë të mbikëqyrjes programore të kryer në pajtim me këtë ligj, konstaton se operatori ri transmeton servis që nuk është regjistruar në pajtim me këtë nen, Agjencia në afat prej shtatë ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes programore të kryer, do të marrë vendim me të cilin do t'i urdhërojë operatorit që menjëherë ta shkyçë ritransmetimin e servisit programor. Për aktvendimin e miratuar Agjencia e njofton Agjencinë për Komunikime Elektronike dhe poseduesin e të drejtave autoriale dhe të drejtave të ngjashme. Aktvendimi për shkyçje të servisit programor me arsyetim detajor, publikohet në ueb faqen e Agjencisë në afat prej tri ditësh nga dita e miratimit të tij.

(14) Agjencia do të shlyej operatorin i cili ritransmeton servise programore të regjistrit nga paragrafi (9) të këtij neni nëse:

- me shkrim e njofton Agjencinë se ka pushuar me kryerjen veprimtarinë,
- pushon të kryejë veprimtarinë gjatë periudhës më të gjatë se një vit,
- nuk fillon të kryejë veprimtarinë nga data e shënuar në fletëparaqitje, e nuk e njofton Agjencinë për ndryshimin e të njëjtës,
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor i është ndaluar kryerja e veprimtarisë dhe
- ka pushuar të ekzistojë.

(15) Formën dhe përmbajtjen e regjistrit nga paragrafi (9) të këtij neni i përcakton Agjencia.

(16) Paraqitja dhe evidentimi në regjistrin e operatorëve që rriemetojnë paketave programore dhe regjistrimi i servileve programore në formë të paketave programore mund të kryhet edhe në formë elektronike duke i përfshirë edhe tërë veprimet e mëtejme rreth ndryshimit të të njëjtave në mënyrë që do ta përcaktojë Agjencia.

Neni 142

Kompensimi për mbikëqyrje

(1) Operatori i cili ritransmeton servis programor dhe dhënësi i shërbimeve audiovizuele mediatike me kërkesë paguajnë kompensim për mbikëqyrjen të cilën e kryen Agjencia.

(2) Kompensimi vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni është 0,5% nga të hyrat e përgjithshme vjetore të operatorit i cili ritransmeton servise programore ose të transmetuesit të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, e realizuar me ritransmetimin e servisit programor ose me sigurimin e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë gjatë vitit të kaluar kalendarik, ose pjesës më të shkurtër të vitit kur operatori i cili ritransmeton servis programor ose ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë ka filluar ta sigurojë shërbimin.

(3) Operatori i cili ritransmeton servis programor dhe ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, janë të obliguar që më së voni deri më 15 mars të vitit rrjedhës të Agjencia të paraqesin raport në lidhje me shumën e të hyrave të përgjithshme nga paragrafi (2) të këtij neni.

(4) Operatori i cili ritransmeton servis programor dhe ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, janë të obliguar që më së voni seri më 15 prill gjatë vitit rrjedhës në llogari të Agjencisë të paguajnë kompensim vjetor për mbikëqyrje në bazë të raportit

paraprakisht të paraqitur për shumën e të hyrave të përgjithshme nga paragrafi (2) të këtij neni, me aktvendim dhe faturë paraprakisht të paraqitur nga ana e Agjencisë.

(5) Nëse te Agjencia ekziston dyshim i bazuar për vërtetësinë e të hyrave të përgjithshme vjetore të realizuara, ka të drejtë me shpenzime të operatorit i cili ritransmeton servis programor ose të ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, të bëjë vlerësimin e të njëjtës nga ana e revizorit të jashtëm të pavarur.

(6) Nëse të hyrat e përgjithshme të vlerësuara nuk janë në përputhje me të hyrat e përgjithshme, gjatë pagesës së kompensimit vjetor nga paragrafi (2) të këtij neni, Agjencia do ta obligojë operatorin i cili ritransmeton servis programor ose ofruesin e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, ta paguajë dallimin e përlogaritur.

Neni 143

Obligime të operatorit i cili ritransmeton servis programor

(1) Operatori mund të ritransmetojë servise programore të radiodifuzerëve vendas vetëm në zonën e servisit për të cilën radiodifuzerët kanë marrë leje për sigurimin e emetimit të radios dhe televizionit dhe në bazë të të drejtave autoriale dhe të drejtave të përafërta të rregulluara, në pajtim me Ligjin për të drejtat autoriale dhe të drejta të përafërta.

(2) Operatori mund të ritransmetojë servis programor të radiodifuzerëve nga vende tjera në pajtim me nenin 44 të këtij ligji dhe në bazë të të drejtave autoriale dhe të drejtave të përafërta të rregulluara në pajtim me Ligjin për të drejta autoriale dhe të drejta të përafërta.

(3) Operatori që rriemeton servise programore, duhet të sigurojë që pakoja programore detyrimisht dhe falas t'i përmbajë serviset programore të servisit radiodifuziv publik që financohen nga taksa radiodifuzive, përveç operatprorit që rriemeton servise programore përmes multipleksit digjital terestrijal.

(4) Operatori që rriemeton servise programore është i detyruar që në marrëveshjet me parapagesë që i lidh me parapaguesit e vet ta cekë pakon programore, përkatësisht listën e serviseve programore që i rriemetojnë për momentin, e për të cilat është lëshuar vërtetim për regjistrim nga Agjencia.

(5) Operatori i cili rriemeton servise programore është i detyruar që të mbajë kontabilitet të veçantë për aktivitetet e lidhura me rriemtimin e serviseve programore.

Neni 144

Obligimet plotësuese të operatorit që rriemeton servise programore

(1) Operatori që rriemeton servise programore mund të themelojë kanal intern të televizionit ku do të publikojë vetëm informata për funksionimin dhe shërbimet që i siguron i njëjti. Siguruesi i pakos programore është i detyruar që sinjalin për dalje të kanalit intern televiziv ta incizojë plotësisht dhe pa ndërprerje, ndërsa incizimet t'i ruajë më së paku 30 ditë pas emetimit.

(2) Operatori që rriemeton servise programore nuk guxon ta pengojë kalimin e lirë të serviseve të radios dhe televizive që emetohen përmes transmetuesit terestrijal.

(3) Operatorët që rriemetojnë servise programore ose dhënësit e shërbimeve audiovizuele të medias me kërkesë, janë të detyruar që sinjalin e vet për dalje me përmbajtjen e njëjtë të asaj që është e kapshme për parapaguesit, në mënyrë të vazhdueshme ta dërgojnë në lokacionin për grumbullimin e sinjaleve të lokalizuara në çdo zonë në nivel rajonal në pajtim me nenin 62 paragrafi (4) të këtij ligji, për distribuimin e tij të mëtejme në sistemin për mbikëqyrje programore të Agjencisë në Shkup.

(4) Lokacionet për mbledhjen e sinjaleve nga paragrafi (3) të këtij neni i përcakton Agjencia dhe të njëjtat i publikon në ueb faqen e vet.

Neni 145

(1) Gjobë në shumë prej 100 000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse nuk i respekton obligimet nga neni 92 paragrafët (8) dhe (9).

(2) Për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni gjobë në shumë prej 3 000 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës të programit në personin juridik.

Neni 146

(1) Gjobë në shumë prej 20 000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse nuk i respekton obligimet nga neni 92 paragrafët (4), (5), (6) dhe (13) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet personit përgjegjës të programit në personin juridik për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni.

IX. DISPOZITA NDËSHKUESE

Neni 147

(1) Gjobë në shumë prej 10 000 deri në 20 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- 1) nuk mundëson kryerjen e mbikëqyrjes profesionale në pajtim me nenin 32 të këtij ligji;
- 2) ka bashkëpronar në pajtim me nenin 34 të këtij ligji;
- 3) në mënyrë plotësuese përcaktohet se njëri nga themeluesit e radiodifuzerëve është person juridik nga neni 35 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 4) fiton pronësi në kundërshtim me nenet 37 dhe 38 të këtij ligji;
- 5) realizon përqendrim të palejuar mediatik në kundërshtim me dispozitat e nenit 39;
- 6) nuk e njofton Agjencinë për ndryshimin e strukturës pronësore (neni 41 paragrafi (1));
- 7) zbaton ndryshimin e strukturës pronësore para se e njëjta të miratohen nga Agjencia (neni 41 paragrafi (2));
- 8) Agjencisë me kërkesë të saj nuk i dorëzohen të dhëna me rëndësi për vendimmarrje (neni 41 paragrafi (5));
- 9) nuk dorëzon të dhëna me rëndësi për vendimmarrje të Agjencisë në procedurë për përcaktimin e përqendrimit të palejuar mediatik me detyrë zyrtare (neni 43 paragrafi (2));
- 10) nuk i respekton rregullat për mbrojtjen e publikut të mitur (neni 50);
- 11) siguron emetim televiziv ose të radios pa leje për emetim televiziv ose të radios (neni 62 paragrafi (2));
- 12) siguron emetim televiziv ose të radios në zonën që nuk i është caktuar në lejen për emetim televiziv ose të radios (neni 62 paragrafi (3));
- 13) siguron përdorimin e gjuhës në kundërshtim me nenin 64;
- 14) nuk siguron më së paku 80% të konceptit programor për të cilin i është lëshuar leje gjatë një jave (neni 67 paragrafi (6));
- 15) e ndryshon ose plotëson konceptin programor të radiodifuzerit në bazë të cilës radiodifuzeri e ka fituar lejen për emetim televiziv ose të radios më shumë se 10%, pa pëlqim paraprak nga Agjencia (neni 67 paragrafi (7));
- 16) nuk vepron në pajtim me dispozitat nga neni 77 paragrafët (5) ose (6) të këtij ligji;
- 17) lejen për emetim televiziv ose të radios ia bart personit tjetër (neni 79 paragrafi (4)) dhe
- 18) nuk i respekton obligimet për emetimin e veprave evropiane dhe veprave nga producent të pavarur të përcaktuara në nenin 91 të këtij ligji.

(2) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni gjobë në shumë prej 1 000 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik dhe tregtarit individ.

(3) Gjore në shumë prej 1 000 deri në 3 000 euro në kundërvlere me denarë do t'i shqiptohet edhe personit fizik për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) pika 11 të këtij neni.

Neni 148

(1) Gjobë në shumë prej 5 000 deri në 10 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk mban evidencë të programit të emetuar ose nuk e incizon sinjalin për dalje të programit të vet ose incizimet nga programi i tërësishëm nuk i ruan së paku 60 ditë pas emetimit (neni 47 paragrafi (1));

2) programet që janë pjesë përbërëse e katalogut të pandryshuara nuk i ruan së paku 30 ditë pas datës kur kanë pushuar të jenë të arritshëm për shfrytëzuesit (neni 47 paragrafi (2));

3) në rast të ngritjes së kontestit gjyqësor, nuk i ruan materialet e incizuara deri në përfundimin e kontestit (neni 47 paragrafi (4));

4) nuk mban evidencë ditore apo nuk siguron cilësi të incizimeve nga tërë programi në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia (neni 47 paragrafi (5));

5) nuk siguron informata të kapshme për shfrytëzuesit në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) të këtij ligji;

6) gjatë kuizeve apo formave të ndryshme të pjesëmarrjes në çmim të dëgjuesve dhe shikuesve të programit audio dhe audiovizuel nuk siguron publikim të padyshimtë të rregullave për këto përmbajtje dhe për çmimin e premtuar publikisht (neni 52);

7) komunikimi komercial audiovizuel nuk është në pajtim me nenin 53 të këtij ligji;

8) sponzorimi nuk është në pajtim me nenin 54 të këtij ligji;

9) plasimi i prodhimeve nuk është në pajtim me nenin 55 të këtij ligji;

10) shërbimet audiovizuele të medias me kërkesë sigurohen pa vërtetim për regjistrim (neni 56 paragrafi (1));

11) nuk e njofton Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave në afatin e përcaktuar (neni 56 paragrafi (9));

12) në bazë të të drejtave të marra ekskluzive emeton ngjarje me rëndësi të madhe për shoqërinë në kundërshtim me nenin 87 të këtij ligji;

13) nuk e siguron të drejtën e njoftimit të shkurtër për ngjarjet për të cilat ekziston interes i lartë të opinionit në pajtim me nenin 89 të këtij ligji;

14) nuk i respekton obligimet nga neni 92 paragrafët (1), (2) dhe (12) të këtij ligji;

15) shfrytëzon shërbime telefonike me vlerën e shtuar, duke e përfshirë edhe votimin telefonik në lajme, në programin informativ dhe arsimor, në shërbime dhe predikime fetare dhe në programe për fëmijë (neni 93 paragrafi (1));

16) shfrytëzon shërbime telefonike me vlerën e shtuar në kundërshtim me nenin 93 paragrafi (2) të këtij ligji;

17) emeton lojëra të fatit të organizuara nga subjekte që nuk kanë licencë nga organi kompetent për organizimin e lojërave të fatit (neni 94 paragrafi (1));

18) organizon dhe emeton lojëra të fatit me vënien bast të ndeshjeve sportive (neni 94 paragrafi (2));

19) lidhet me sistemin unik për emetim të programit të përbashkët, pa njoftim të dorëzuar paraprakisht në Agjenci (neni 95 paragrafi (1));

20) nuk e njofton Agjencinë për konceptin e programit për programin e përbashkët apo nuk emëron redaktor përgjegjës të programit (neni 95 paragrafi (2));

21) identifikimin nuk e siguron në pajtim me nenin 97 të këtij ligji;

22) emeton reklamim dhe teleshoping në mënyrë në kundërshtim me nenin 99 të këtij ligji;

23) nuk e publikon Raportin vjetor për punë për vitin paraprak dhe Programin vjetor për punë për vitin e ardhshëm në ueb faqen e tij (neni 106 paragrafi (7));

24) nuk e publikon në ueb faqen e tij Propozim-programin për punë për vitin e ardhshëm para se të dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë (neni 113 paragrafi (1));

25) riemeton servise të programit në kundërshtim me nenin 141 të këtij ligji;

26) më së voni deri më 15 mars në vitin rrjedhës në Agjenci nuk dorëzon raport për shumën e të hyrave të përgjithshme (neni 142 paragrafi (3));

27) nuk i respekton obligimet nga neni 143 të këtij ligji dhe

28) nuk i respekton obligimet nga neni 144 të këtij ligji.

(2) Për kundërvajtjen e bërë nga paragrafi (1) të këtij neni, gjobë në shumë prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës të programit në personin juridik dhe tregtarit individ.

Neni 149

Gjobë në shumë prej 3 000 deri më 5 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) me kërkesë të Agjencisë nuk i dorëzon incizim nga programet më së voni në afat prej tre ditësh (neni 47 paragrafi (3));

2) transmeton vepra kinematografike jashtë periudhës së përcaktuar në marrëveshjet me pronarët e të drejtave (neni 49);

3) shenjat për identifikim nuk i thekson vazhdimisht në të gjitha programet, përkatësisht nuk i emeton së paku një herë gjatë një ore reale në programet e radios (neni 51 paragrafi (2));

4) përdor shenja për identifikim në kundërshtim me nenin 51 paragrafi (3) të këtij ligji;

5) për çdo ndryshim të shenjave për identifikim nuk dorëzon ekzemplar te Agjencia (neni 51 paragrafi (4));

6) me kërkesë të Agjencisë nuk dorëzon dokumente lidhur me promovimin e prodhimit dhe qasjen te veprat evropiane (neni 60 paragrafi (2));

7) nuk e respekton kohëzgjatjen e emetimit ditor të përcaktuar në nenin 90 të këtij ligji;

8) reklamimi dhe teleshopingu nuk janë qartësisht të njohura dhe të ndara nga pjesët tjera (neni 98 paragrafi (1));

9) kohëzgjatja e reklamimit dhe spoteve të teleshopingut arrijnë më tepër se 12 minuta në një orë reale (neni 100 paragrafi (1));

10) në reklama dhe teleshoping, vizuale apo me zë, tregon persona që rregullisht prezantojnë lajme dhe emisione informative aktuale (neni 101);

11) kohëzgjatja e reklamimit te servisi radiodifuziv publik është në kundërshtim me nenin 103 të këtij ligji;

12) nuk lidh marrëveshje të posaçme për furnizim të veprave audio apo audiovizuele në kundërshtim me nenin 105 paragrafi (3) të këtij ligji;

13) mënyrën dhe procedurën e zbatimit të konkurseve publike, mënyrën dhe procedurën për furnizim të veprave audio apo audiovizuele, përkatësisht përmbajtjeve të programeve dhe lidhjen e marrëveshjeve kryhet në kundërshtim me aktin nga neni 105 paragrafi (4) të këtij ligji;

14) nuk e publikon statutin e RTM-së në faqen e RTM-së (neni 114 paragrafi (3)) dhe

15) nuk e publikon rendin e ditës, procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Programor të RTM-së, vendimet e miratuara si dhe prononcimin e anëtarëve të Këshillit Programor të RTM-së gjatë procedurës së votimit për çështjeve të caktuar vendimi i ueb faqes së RTM-së në afat prej shtatë ditësh nga dita e mbledhjes së mbajtur (neni 122 paragrafi (3)).

(2) Për kundërvajtjen e kryer nga paragrafi (1) të këtij neni gjobë në shumë prej 1 000 deri më 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës të programit në personin juridik dhe tregtarit individ.

Neni 150

Sanksionet e kundërvajtjes

(1) Personit juridik për kundërvajtjen e bërë nga nenet 145, 146, 147, 148 dhe 149 të këtij ligji krahas gjobës mund të t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim i kryerjes së veprimtarisë së caktuar në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh deri në tre vjet.

(2) Personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje të kryer nga nenet 145, 146, 147, 148 dhe 149 të këtij ligji, përveç gjobës mund t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej tre muajsh deri në një vit.

(3) Tregtarit individ për kundërvajtje të kryer nga nenet 145, 146, 147, 148 dhe 149 të këtij ligji, përveç gjobës mund t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej tre muajsh deri në një vit.

X. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 151

Dispozitat e nenit 46 paragrafët (3) dhe (4) të këtij Ligji do të zbatohen pas pranimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Neni 152

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do t'u dërgojë thirrje publike për dorëzimin e propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Agjencisë, propozuesve të autorizuar nga neni 14 i këtij ligji në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Propozuesit e autorizuar nga paragrafi (1) i këtij neni i përcaktojnë dhe dorëzojnë propozimet për anëtarë të Këshillit të Agjencisë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me procedurë dhe në afatin e përcaktuar me këtë ligj.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej një muajsh nga pranimi i të gjitha propozimeve nga paragrafi (2) i këtij neni duhet t'i emërojë anëtarët e Këshillit të Agjencisë në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

(4) Me emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë nga paragrafi (3) i këtij neni u ndërpritet mandati anëtarëve ekzistues të Këshillit për Radiodifuzion, përveç kryetarit ekzistues të Këshillit për Radiodifuzion.

(5) Kryetari ekzistues i Këshillit për Radiodifuzion e ushtron funksionin Drejtor të Agjencisë deri në zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë në pajtim me paragrafin (8) të këtij neni, pa të drejtë vote gjatë miratimit të vendimeve të Këshillit. Me zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë, i ndërpritet mandati kryetarit ekzistues të Këshillit për Radiodifuzion.

(6) Anëtarët ekzistues të Këshillit për Radiodifuzion kanë të drejtë të emërohen për anëtarë të Këshillit të Agjencisë.

(7) Këshilli i Agjencisë i emëruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji do ta miratojë Rregulloren për punën e Agjencisë në afat prej 60 ditësh nga dita e miratimit të vendimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit.

(8) Këshilli i Agjencisë nga paragrafi (3) i këtij neni do të miratojë vendim për shpalljen e konkursit publik për zgjedhje të drejtorit të Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Rregullores për punën e Agjencisë. Zgjedhja e drejtorit do të bëhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me Rregulloren për punën e Agjencisë.

(9) Në afat prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të vendimit për zgjedhje të drejtorit të Agjencisë, Agjencia do t'i miratojë aktet që dalin nga ky ligj.

(10) Mjetet, të drejtat, obligimet dhe arkivi i Këshillit për Radiodifuzion, si dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Këshillit për Radiodifuzion i merr Agjencia.

Neni 153

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do t'u dërgojë thirrje publike për dorëzimin e propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Programor të RTM-së propozuesve të autorizuar nga neni 117 i këtij ligji në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Propozuesit e autorizuar nga paragrafi (1) i këtij neni i përcaktojnë dhe dorëzojnë propozimet për anëtarë të Këshillit të Programit të RTM-së në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me procedurë dhe në afatin e përcaktuar me këtë ligj.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej një muaji nga pranimi i të gjithë propozimeve nga paragrafi (2) i këtij neni duhet t'i emërojë anëtarët e Këshillit të Programit të RTM-së në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj.

(4) Me emërimin e anëtarëve të Këshillit të Programit të RTM-së nga paragrafi (3) i këtij neni u ndërpritet mandati anëtarëve ekzistues të Këshillit të RTM-së.

(5) Këshilli Programor i RTM-së i emëruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji do ta miratojë Statutin e RTM-së në afat prej 60 ditësh nga dita e miratimit të vendimit për zgjedhje të anëtarëve në Këshillin Programor të RTM-së.

(6) Këshilli Programor i RTM-së nga paragrafi (3) i këtij neni do të miratojë vendim për shpalljen e konkursit publik për zgjedhje të anëtarëve në Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Statutit të RTM-së. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së do të bëhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me Statutin e RTM-së.

(7) Me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të RTM-së u ndërpritet mandati anëtarëve ekzistues të Këshillit Drejtues të RTM-së.

(8) Këshilli Programor i RTM-së do të miratojë vendim për shpalljen e konkursit publik për zgjedhje të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të RTM-së në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Statutit të RTM-së. Zgjedhja e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të RTM-së do të bëhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe me Statutin e RTM-së.

(9) Në afat prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të vendimit për zgjedhje të drejtorit dhe zëvendës drejtorit të RTM-së, RTM-ja do t'i miratojë aktet që dalin nga ky ligj.

Neni 154

(1) Operatorët ekzistues që riemetojnë servise të programit përmes rrjeteve të komunikimit elektronik, janë të detyruar që në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji në Agjenci të dorëzojnë fletëparaqitje për regjistrim në pajtim me këtë ligj.

(2) Agjencia me detyrë zyrtare do të kryejë zëvendësim të lejeve ekzistuese për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive me leje të reja për emetim televiziv apo të radios në pajtim me këtë ligj, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë, me afat të vlefshmërisë prej nëntë vitesh duke llogaritur nga dita e lëshimit të lejes së re.

(3) Obligimet e përcaktuara në nenin 92 paragrafët (4), (8) dhe (9) do të zbatohen nga 1 janari 2014.

Neni 155

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për veprimtari radiodifuzive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 100/2005, 19/2007, 103/2008, 152/2008, 6/10, 145/10, 97/11, 13/12 dhe 72/13), me përjashtim të dispozitës nga neni 10 paragrafi (11) të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari radiodifuzive ("Gazeta Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numër 72/13).

Neni 156

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".